



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Marketing
Digjital”**

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.As. Elena KOKTHI

Dr. Ana BUHALJOTI

Dhjetor / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në "Marketing Digjital"**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë Informacionit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave "Marketing Digjital"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 345, datë 17.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	11 PAE / 2 PAK
18	Numri i studentëve:	11 Studentë për vitin akademik 2021-2022 9 Studentë për vitin akademik 2022-2023
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" (CIT) është një Institucion privat i Arsimit të Lartë (IAL), i cili vepron në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, Nr. 80, datë 22/07/2015. Programi i studimit Marketing Digjital ofrohet nga Departamenti i "Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit (BA&IT) në Fakultetin e Ekonomisë. Ky i fundit është i organizuar në tre njësi bazë:

1. Departamenti i Administrim Biznesit;
2. Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologji Informacioni;
3. Njësia e Kërkimit Shkencor "CIRD Ekonomi";

Diplomat Bachelor dhe Master të ofruara nga Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" bazohen në Sistemin e Bolonjës dhe u përkasin dy fakulteteve, përkatësisht Fakultetit të Inxhinierisë dhe Fakultetit të Ekonomisë.

Programi i Studimit Master i Shkencave në Marketing Digjital është hapur në përputhje me Studimin e Tregut të bërë në tetor të vitit 2020. Programi është licensuar në vitin 2021, me urdhër të Ministrisë të Arsimit Nr. 345, datë 17/09/2021 me 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike në përputhje me qëllimet e institucionit dhe nevojat e tregut të punës. Programi i studimit mbështet zhvillimet e funksionit të Marketingut në vendin tonë me interesat e industrisë dhe shoqërisë. Organizmat private e shtetërore kanë nxitur procese të tilla si zhvillimi i teknologjive të reja të informimit dhe komunikimit që po e ndryshojnë në mënyrë radikale strukturën e marketingut. Sfidat e reja kërkojnë përgatitjen e specialistëve të aftë në fushën e marketingut digjital. Programi Master i Shkencave në "Marketing Digjital" kombinon zhvillimet teorike me praktikën e aplikuar me qëllim zhvillimin dhe pajisjen e studentëve me kompetencat për zgjidhjen e sfidave të reja. Departamenti i "Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit pranë KU IKT siguron një mjedis kërkimor bashkëpunues dhe stimulues intelektual për zbulimin dhe shpërndarjen e njohurive shkencore të zbatueshme për ekonominë dhe komunitetin e biznesit.

Studenti i "Masterit të Shkencave në Marketing Digjital" fiton njohuri të thelluara për të kuptuar metodat e avancuara si dhe për të realizuar modelimin, analizën dhe projektimin e zbatimeve të ndryshme në fushën e marketingut digjital. Bashkëpunimi i rregullt me bizneset në projekte të ndryshme studimore, plotëson nevojat e tregut me aftësitë të avancuara që lidhen me ndërveprimin e teknologjive informatike me zhvillimin e strategjive marketing. Në këtë drejtim, GVJ vlerëson marrëveshjet institucionale me aktorë vendas e të huaj të cilat sigurojnë trajnimin e vazhduar të studentëve, integrimin në tregun e punës, përmirësimin e programit dhe rritje e kapaciteteve.

Analiza e tregut të punës e zhvilluar nga IAL paraqet një punim shterues të epokës së digjitalizimit në të cilin bizneset dhe individët operojnë sot. GVJ e vlerëson si aspekt pozitiv dhe pse do të vlerësonim që në kërkim tregu të integroheshin edhe instrumenta të kërkimit primar në bizneset vendase. Me këtë nënkuptojmë një identifikim të kompetencave që aktorët e biznesit kanë nevojë

si në afatin e shkurtër edhe atë të mesëm. GVJ vlerëson si pozitive ekzistencën e CIT HUB e cila shërben si një qendër inovacioni për promovimin e kreativitetit dhe sipërmarrjes. CIT HUB është konceptuar si një hapësirë ku njerëzit mund të takohen dhe ndërveprojnë, krijojnë, ndërmarrin, punojnë dhe inovojnë së bashku. Mbështetur në Rregulloren e Programit MSH në Marketing Digjital dhe syllabuset e lëndëve, GVJ vlerëson se lëndët dhe përmbajtja e tyre thellojnë njohuritë dhe aftësitë e studentëve në fushën e Marketingut Digjital, dhe u krijon mundësi që të përsosin të menduarin kritik dhe instrumenta të analizës në funksion të nevojave të tregut lokal dhe ndërkombëtar të punës.

GVJ rekomandon që lëndë si Advanced Research Methods and communication skills bashkë me lëndën Economic and Legal Environment do të ishin më të përshtatshme të klasifikoheshin si lëndë të formimit bazë për këtë program studimi duke pasur parasysh që dy lëndët e përmendura më sipër përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme. Ndërsa lënda Financial Reporting Standarts mund të kalojë në kategorinë C, si lëndë ndërdisiplinore.

Gjithashtu, GVJ rekomandon analiza periodike të tregut me të dhëna primare nga biznesi për kompetenca e nevojshme duke pasur parasysh zhvillimin teknologjik sidomos në drejtim të AI; si dhe zhvillimin e analizave periodike për përfitimet konkrete të marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit mësimor.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të një procesi vlerësimi. Raport i vlerësimit të jashtëm përmban informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesë sa më reale, figurën në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht. (ascal.al, standardet)

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Dr. Ana Buhaljoti dhe Prof Asoc Elena Kokthi. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Erjon Xhako dhe Arbri Ndreka përfaqësues të ASCAL.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të jashtëm. Ky dokumentacion ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetjeve, të cilat u realizuan gjatë vizitës në vend. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në institucion të zhvilluar në datat **23 dhe 24 Qershor 2023** me përfaqësues të Fakultetit, departamentit përgjegjës për programin e studimit, stafin e angazhuar, studentët si dhe zyrat mbështetëse si NJSBC, Alumnit dhe Karrierës etj.

Grupi i vlerësimit në këtë raport është kujdesur të pasqyrojnë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep një vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga institucioni në ofrimin e një programi të mirë Master i Shkencave në “Marketing Digjital”, si edhe ofron sugjerime/rekomandime, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të përmirësuar në vazhdimësi programin në funksion të nevojave gjithmonë e në ndryshim të tregut të punës.

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 30.11.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 176/9 Prot, datë 30.11.2023. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, përcjell në ASCAL më datë 05.12.2023, me anë të shkresës me Nr.176/10 Prot, datë 05.12.2023 “ Përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Shkencor në “Marketing Digjital”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Standardi I.1</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</p> <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Kolegji Universitar Instituti Kanadez i Teknologjise (CIT/KUIKT) zotëron kapacitetet e nevojshme për funksionimin dhe organizimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Marketing Digjital”, i hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Kjo është evidentuar në Statutin dhe Rregulloren Institucionale të CIT, dhe Strategjinë e zhvillimit të CIT/KUIKT. Në këto evidenca theksohet se institucioni ofron programe studimi që kanë për qëllim të përbashkët të mbështesin prioritetet strategjike të vendit përmes formimit e kualifikimit profesional e shkencor të specialistëve të lartë në fushën e inxhinierisë dhe ekonomisë. Programi i studimit “Master i shkencave në Marketing Digjital” është pjesë integrale e studimeve në Fakultetin e Ekonomisë, në KU IKT dhe është hapur me Urdhër Nr. 345, datë 17/09/2021 me 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike në përputhje me qëllimet e institucionit dhe nevojat e tregut të punës. Programi i studimit mbështet zhvillimet e funksionit të Marketingut në vendin tonë me interesat e industrisë dhe shoqërisë në tërësi. Në dekadën e fundit industria e marketingut po kalon një transformim strukturor si pasojë e automatizimit të funksionit të marketingut. Në vendin tonë janë ndërmarrë reforma drejt</p>

	<p>dixhitalizimit dhe organizmat private e shtetërore kanë nxitur zhvillimin e teknologjive të reja të informimit dhe komunikimit. Sfidat e reja kërkojnë përgatitjen e specialistëve të aftë në fushën e marketingut digjital. Programi “Master i Shkencave në Marketing Digjital” kombinon zhvillimet teorike me praktikën e aplikuar, dhe u siguron studentëve kompetencat e aplikimit digjital të Marketingut në zhvillimin ekonomik e social të vendit. Nga shqyrtimi i programit të studimit dhe diskutimet e zhvilluara me përfaqësues të KU IKT, GVJ konstaton se programi Master në Marketing Digjital përbën risi në ofertën akademike në vend dhe është në përputhje me kërkesat e tregut kombëtar e ndërkombëtar të punës.</p> <p><i>Ev.1 Statuti i KU IKT 2016 shqip</i></p> <p><i>Ev.1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar shqip</i></p> <p><i>Ev.2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2017 - 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017.</i></p> <p><i>Ev.3. Strategjia e CIT 2020 - 2025, miratuar me vendimin e Bordit të Administrimit nr.02, date 29.05.2020</i></p> <p><i>Ev.7. Studim i tregut për programin Msc. Marketing Digjital - JANAR 2023</i></p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT shqip</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore e programit MSc Marketing Digjital</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit “Master i shkencave në Marketing Digjital” është hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, politikat e brendshme të institucionit dhe nevojave të zhvillimit të vendit. KU IKT ka hartuar programin e studimit në koherencë me mënyrën e organizimit të institucionit, të njësive kryesore dhe integrimin ndërdisiplonor brenda një programi për të rritur efikasitetin institucionale.</p> <p>Programi i studimit “Master i shkencave në Marketing Digjital” është në përputhje me qëllimin dhe misionin e KU IKT, të shprehur në Statutin (Neni 4), dhe Rregulloren (Neni 7) të institucionit. Këtu gjejmë të përcaktuar se KU IKT synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike, përmes nxitjes së lirisë akademike, kërkimit shkencor, dhe ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave kulturore kombëtare, duke u bërë kontribues në formimin e profesionistëve të rinj në zhvillimin e ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare. GVJ konstaton se institucioni mbështet programin e studimit “Master i shkencave në Marketing Digjital” me procese</p>

	<p>cilësore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor me qëllim sigurimin e dijeve të qëndrueshme e bashkëkohore teorike e praktike, të cilat u evidentuan tek qëllimi i programit të studimit dhe bazuar në dokumenta strategjike të insitucionit të evidentuara më poshtë.</p> <p><i>Ev.1 Statuti i KU IKT 2016 shqip</i></p> <p><i>Ev.1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar shqip</i></p> <p><i>Ev.2. Strategjia e Zhvillimit te KU IKT 2017 - 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017.</i></p> <p><i>Ev.3. Strategjia e CIT 2020 - 2025, miratuar me vendimin e Bordit te Administrimit nr.02, date 29.05.2020</i></p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT shqip</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave në Marketing Digjital”, në emërtimin organizimin dhe strukturën është në përputhje të plotë me statutin dhe rregulloren e institucionit. Ai gjithashtu është hartuar dhe ofrohet në përshtatje të strategjisë për zhvillim të KU IKT, dhe rregullores së njësive përgjegjëse Fakultetit të Ekonomisë dhe rregullores së Departamentit të Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit.</p> <p>Cilësia akademike, kërkimi shkencor, bashkëpunimet brenda dhe jashtë vendit janë drejtimet kryesore të cilat krijojnë një mjedis që promovon të mësuarin interaktiv në përputhje me qëllimin e IAL-së. Pjesë e prioriteteve është dhe përshtatja e vazhdueshme e programeve me tregun e punës. Programi i studimit është i bazuar në kurrikula ndërkombëtare në fushën marketing digjital dhe synon të jetë në përmirësim të vazhdueshëm në përputhje me drejtimet prioritare të institucionit dhe kërkesat e tregut. GVJ gjithashtu konstaton se Programi “Master i shkencave në Marketing Digjital” është në koherencë të plotë me drejtimin dhe mënyrën e organizimit të institucionit, dhe siguron integrimin ndërdisiplonor brenda një programi për të rritur efincencën institucionale.</p> <p><i>Ev.1 Statuti i KU IKT 2016 shqip</i></p> <p><i>Ev.1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar shqip</i></p>

	<p>Ev.2. <i>Strategjia e Zhvillimit te KU IKT 2017 - 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017.</i></p> <p>Ev.3. <i>Strategjia e CIT 2020 - 2025, miratuar me vendimin e Bordit te Administrimit nr.02, date 29.05.2020</i></p> <p>Ev.9. <i>Rregullore Institucionale e KU IKT shqip</i></p> <p>Ev.11. <i>Rregullore e Fakultetit te Ekonomise</i></p> <p>Ev.12. <i>Rregullore e departamentit Admin Biznesi dhe Tek Informacioni</i></p> <p>Ev.13. <i>Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit “Master i shkencave në Makreting Digjital” hartohet e zhvillohet në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022), miratuar me VKM Nr. 710, datë 1.12.2017 (shih https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/AKTET_NENLIGJORE.pdf), <i>Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026</i>, https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026.pdf, <i>Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020</i>, (https://www.dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/278-strategjia-kombetare-per-zhvillim-dhe-integrim), <i>Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim</i> (https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/10/Publikim AL Strategjia-Komb%C3%ABtare-p%C3%ABr-Pun%C3%ABsim-dhe-Aft%C3%ABsi-2019-2022.pdf), <i>Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021 – 2030, miratuar me VKM Nr. 400, datë 30.6.2021, duke u përpjekur edhe të ndjekë trendet globale të zhvillimit, përmes përditësimit të njohurive dhe pasurimit të literaturës që ofrohen nga lëndët e programit.</i></p> <p>Program i studimit “Master i shkencave në Marketing Digjital” zhvillohet në përputhje me Strategjinë Kombëtare duke respektuar vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018. “Për Elementët e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Për më tepër, i është dhënë një hapësirë më e madhe në planin mësimor, veprimtarive praktike duke iu përgjigjur në këtë mënyrë standardeve ligjore të udhëzimit Nr. 41. Praktika mësimore dhe hartimi i mikrotezës u mundësi studentëve të hetojnë terrenin dhe të përfitojnë nga të dhënat konkrete për të</p>

	<p>hartuar punimin e tyre të diplomës, duke integruar teorinë, kërkimin shkencor dhe praktikën.</p> <p><i>Ev.1 Statuti i KU IKT 2016 shqip</i></p> <p><i>Ev.1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar shqip</i></p> <p><i>Ev.2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2017 - 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017.</i></p> <p><i>Ev.3. Strategjia e CIT 2020 - 2025, miratuar me vendimin e Bordit të Administrimit nr.02, date 29.05.2020</i></p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT shqip</i></p> <p><i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>Ev.12. Rregullore e departamentit Admin Biznesi dhe Tek Informacioni</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc në Marketing Digjital</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se programi i studimit "Master i shkencave në Marketing Digjital" është hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, politikat e brendshme të institucionit dhe nevojave të zhvillimit të vendit.</i></p> <p><i>Kolegji Universitar Instituti Kanadez i Teknologjise (CIT/KUIKT) zotëron kapacitetet e nevojshme për funksionimin dhe organizimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Marketing Digjital. Kjo është evidentuar në Statutin dhe Rregulloren Institucionale të CIT, dhe Strategjinë e zhvillimit të CIT/KUIKT. GVJ konstaton se institucioni mbështet programin e studimit "Master i shkencave në Marketing Digjital" me procese cilësore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor me qëllim sigurimin e dijeve të qëndrueshme e bashkëkohore teorike e praktike, të cilat u evidentuan në dokumenta strategjike të institucionit. GVJ gjithashtu konstaton se Programi "Master i shkencave në Marketing Digjital" është në koherencë të plotë me drejtimin dhe mënyrën e organizimit të institucionit, dhe siguron integrimin ndërdisiplonor brenda një programi për të rritur efikasitetin institucionale.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi I.2**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>KU IKT ka përvojën dhe kapacitetet në fushën akademike për përmbushjen e qëllimit të programit të studimit “Master i shkencave në Marketing Digjital”. Departamenti i Administrimit Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit, si njësi bazë e Fakultetit të Ekonomisë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore të programit të studimit duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik si edhe shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të tij. Programi i studimit “Master i shkencave në Marketing Digjital” vë në efikasitet burimet njerëzore të KU IKT pasi integron stafin e departamenteve të tjera me qëllim marrjen e njohurive dhe kompetencave në plotësimin e profilizimit në marketing digjital.</p> <p>GVJ konstaton se Statuti i KU IKT, të dhënat Tabelore në <i>Aneksin 1 të RVB</i> për personelin akademik, të dhënat tabelore për numrin e programeve në ciklet e ndryshme të studimeve që ofrohen në KU IKT si dhe tabela për ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik në të gjitha programet e studimit dëshmojnë për kapacitetet e duhura në ofrimin e programit të studimit. Gjithashtu, personeli akademik dhe administrativ është i informuar për objektivat e dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit, përmes një dokumentacioni të gjerë rregullator dhe vërehet angazhim serioz i personelit për përmbushjen e tyre.</p> <p><i>Ev.1 Statuti i KU IKT 2016 shqip</i> <i>Ev.1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar shqip</i> <i>Ev.2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2017 - 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017.</i> <i>Ev.3. Strategjia e CIT 2020 - 2025, miratuar me vendimin e Bordit të Administrimit nr.02, date 29.05.2020</i> <i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT shqip</i> <i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p>



	<p><i>Ev.12. Rregullore e departamentit Admin Biznesi dhe Tek Informati</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit “Master i shkencave në Marketing Digjital” ofrohet nga departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informatit, i cili është pjesë e Fakultetit të Ekonomisë. Fusha akademike që përfshin ky departament ka të bëjë me shkencën e administrimit të biznesit dhe shkencave kompjuterike, në një gamë të gjerë disiplinash të këtyre shkencave. Programi i studimit “Master i shkencave në Marketing Digjital” përfshin këto disiplina dhe është i integruar më së miri në njësinë kryesore. Të gjitha elementët përbërëse të programit të studimit janë konform orientimeve kombëtare dhe evropiane. Rregullorja e Programit të studimit përcakton ndër të tjera dhe fushat didaktike dhe të kërkimit të tij nën njësinë kryesore Fakulteti i Ekonomisë dhe njësinë bazë Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informatit. Veprimtaria akademike e KU IKT zhvillohet në përputhje me parimet dhe standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL), duke reflektuar parimet dhe objektivat e Procesit të Bolonjës, si dhe kornizën ligore në fuqi.</p> <p><i>Ev.8 Vleresim i programit te studimit MSc ne Marketing Digjital prej Fakultetit dhe Departamentit.</i></p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT shqip</i></p> <p><i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise</i></p> <p><i>Ev.12. Rregullore e departamentit Admin Biznesi dhe Tek Informati</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev.19. Plani mesimor i programit MSC. Marketing Digjital</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e</p>	<p>Njësia bazë Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informatit që ofron këtë program studimi është në koherencë me vizionin dhe strategjinë afatgjatë të institucionit për sa i përket përputhjes me fushën akademike dhe kërkimit shkencor, si dhe është në përputhje me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e evropiane. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën</p>




<p>studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>akademike e kërkimore të njësisë bazë, sipas Standardeve Ndërkombëtare të Klasifikimit e Edukimit (ISCED-F 2013)</p> <p>Klasifikimi/ kodifikimi i programit të studimit “Master i Shkencave në Marketing Digjital” bëhet në bazë të Udhëzimit nr.45 datë 19.12.2011 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.</p> <p>Gjithashtu, profili Marketing i ofruar nga Fakulteti i Ekonomisë është në harmoni dhe në përputhje me rregulloren e tij e hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</p> <p><i>Ev.1 Statuti i KU IKT 2016 shqip</i></p> <p><i>Ev.1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar shqip</i></p> <p><i>Ev.2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2017 - 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017.</i></p> <p><i>Ev.3. Strategjia e CIT 2020 - 2025, miratuar me vendimin e Bordit të Administrimit nr.02, date 29.05.2020</i></p> <p><i>Ev.4. Strategjia e RDC (Kerkimit, Zhvillimit dhe Kretivitetit) 2014-2024.pdf.</i></p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT shqip</i></p> <p><i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>Ev.12. Rregullore e departamentit Admin Biznesi dhe Tek Informacioni</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc në Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev.19. Plani mesimor i programit MSC. Marketing Digjital</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron</p>	<p>KU IKT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me shumë struktura shtetërore dhe private. Në çdo marrëveshje bëhen të</p>

<p>trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>qarta të gjitha format e bashkëpunimit dhe përgjegjësitë e secilës pale si dhe të zhvillimit të trajnimit dhe praktikës profesionale për studentët. Praktikrat janë të rëndësishme jo vetëm për zhvillimin e shprehive praktike, por edhe për të rritur bashkëpunimin në fushën e kërkimit shkencor. <i>Evidenca 28</i> përmban një listë të Institucioneve/kompanive me të cilat institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi si dhe Ankesi 2 i RVB Tabela 2/1-7 jep një përmbledhje të trajnimeve profesionale të ofruara në bashkëpunim me punëdhënësin për studentët.</p> <p><i>GVJ konstaton se mungojnë analiza për përfitimet konkrete të marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit mësimor Marketing Digjital.</i></p> <p><i>Ev.28. Marrëveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione te tjera 2016 – 2022</i></p> <p><i>Ev.30. Raporti Institucional Vjetor i KU IKT per vitin akademik 2021-2022 shqip</i></p> <p><i>Ankesi 2 i RVB</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se KU IKT ka përvojën dhe kapacitet në fushën akademike për përmbushjen e qëllimit të programit të studimit “Master i shkencave në Marketing Digjital”. Program studimi është në koherencë me vizionin dhe strategjinë afatgjatë të institucionit për sa i përket përputhjes me fushën akademike dhe kërkimit shkencor, si dhe është në përputhje me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e evropiane.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>KU IKT ka një hierarki të strukturuar të cilat monitorojnë mbarëvajtjen e punës në drejtim të realizimit të detyrave nga ana e personelit akademik dhe atij ndihmës akademik. Mbikqyrja dhe mbarëvajtja e programit të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave në Marketing Digjital” bazohet tek Statuti i KU IKT, Rregullorja KU IKT si dhe tek Rregullorja e e Programit të studimit, ku përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve të përfshirë. Fakulteti i Ekonomisë ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi midis departamenteve për të siguruar ecuri efektive të programit të studimit nëpërmjet ndarjes së detyrave, përgjegjësiwe respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p> <p>Rregulloret e përligjin bashkëpunimin brenda institucionit përmes ndarjes së detyrave mes njësive e personelit. Kjo vërehet duke iu referuar dhe rregullores së programit të studimit “Master i shkencave në Marketing Digjital”. Në Departamentin e Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit bëhet shqyrtimi dhe miratimi i planeve mësimore, hartimi dhe rishikimi i programeve të lëndëve (syllabuseve) bazuar në propozimet e bëra që gjykohen të nevojshme; shqyrtimin dhe miratimin i propozimeve të bëra për tekstet mësimore që do të përdoren në lëndët e programit të studimit; ndjekjen e realizimit të programit të studimit sipas planit të miratuar dhe mbikëqyrjen e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Përgjegjësi i departamentit përgjigjet për vlerësimin e performancës së personelit akademik të Departamentit Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit gjatë vitit akademik. Kjo performancë përfshin korrektesën në respektimin e orarit të punës, cilësinë e mësimdhënies në auditor dhe veprimtarinë e tij shkencore. I gjithë procesi për përmbushjen e disiplinave të formimit dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor mbikqyret nga instancat drejtuese të KU IKT duke filluar nga Rektori, Dekani, Pergjegjësi i Departamentit, NJSBC etj. Çdo vit akademik realizohet dhe analizë e punës së njësive në përputhje me Rregulloren dhe Statutin e KU IKT -së.</p> <p><i>Ev.1 Statuti i KU IKT 2016 shqip</i></p>

	<p><i>Ev.1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar shqip</i></p> <p><i>Ev.2. Strategjia e Zhvillimit te KU IKT 2017 - 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017.</i></p> <p><i>Ev.3. Strategjia e CIT 2020 - 2025, miratuar me vendimin e Bordit te Administrimit nr.02, date 29.05.2020</i></p> <p><i>Ev.4. Strategjia e RDC (Kerkimit, Zhvillimit dhe Kretivitetit) 2014-2024.pdf.</i></p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT shqip</i></p> <p><i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise</i></p> <p><i>Ev.12. Rregullore e departamentit Admin Biznesi dhe Tek Informacioni</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev.19. Plani mesimor i programit MSC. Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev.30. Raporti Institucional Vjetor i KU IKT per vitin akademik 2021-2022 shqip</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>KU IKT ka krijuar disa marrëveshje dhe marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, me objekt ndërtimin e kapaciteteve, shkëmbimin e burimeve njerëzore, ndërtimin e programeve të reja të studimit. Pjesë e bashkëpunimeve janë dhe përmes programit Erasmus+. Lista e detajuar e bashkëpunimeve gjendet e integruar në Aneksin 2 të RVB si dhe në evidencat 26,27,28. Këto marrëveshje bashkëpunimi të KU IKT janë evidentuar në organizmin e konferencave, workshopeve, leksione të hapura në auditor dhe online. Gjatë viteve te fundit KU IKT ka nënshkruar shumë marrëveshje institucionale dhe marrëveshje me bizneset e organizata. Qëllimi i tyre është trajnimi i vazhduar i studentëve, integrimi në tregun e punës, përmirësimi i programeve dhe rritje e kapaciteteve. Marrëveshjet e praktikave janë ngritur në nivel Universiteti. Studentët kryejnë praktika profesionale të mbikëqyrura nga profesionistë të fushës në institucionet publike e private të paraqitura në evidencën 28.</p> <p><i>Ev. 26. Marreveshjet ne kuader te Erasmus+ 2016-2022</i></p> <p><i>Ev. 27. Marreveshjet me universitetet 2016 – 2022</i></p> <p><i>Ev. 28. Marreveshjeve me biznesin, siper marrjet dhe institucione te tjera 2016 – 2022</i></p>

	<p><i>Ev.30. Raporti Institucional Vjetor i KU IKT per vitin akademik 2021-2022 shqip</i></p> <p><i>Ev. Aneksi 1 RVB</i></p> <p><i>Ev. Aneksi 2 RVB</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e njësisë kryesore lidhur me zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione homologe dhe institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve janë zhvilluar një sërë aktivitete, si leksione të hapura me profesorë të ftuar vendas dhe të huaj, workshop-e, konferenca, projekte të zbatuara në shkallë fakulteti, aktivitete shkencore të organizuara nga fakulteti e departamenti që janë me përfitim për stafin dhe studentët e programit të studimit. Referuar Ankesi 2 RVB.</p> <p>Gjatë vizitës GVJ u informua dhe për bashkëpunimin Erasmus me institucionin homolog portugez Porto Polytechnic nga i cili kanë përfituar studentët e stafi i programit “Master i shkencave në Marketing Digjital”. KU IKT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me shumë struktura shtetërore dhe private. Në çdo marrëveshje bëhen të qarta format e bashkëpunimit dhe përgjegjësitë e secilës pale si dhe përcaktohen përgjegjësitë e punëdhënësve për mbikëqyrjen e zhvillimit të praktikës profesionale nga studentët. Çdo punëdhënës bën vlerësimin e tij për studentin në çështje të caktuara të praktikës, vlerësim i cili dorëzohet para mbrojtjes së saj dhe merret në konsideratë në vlerësimin e studentit. Praktikrat janë të rëndësishme jo vetëm për zhvillimin e shprehive praktike, por edhe për të rritur bashkëpunimin në fushën e kërkimit shkencor.</p> <p><i>Ev. 26. Marrëveshjet ne kuader te Erasmus+ 2016-2022</i></p> <p><i>Ev. 27. Marrëveshjet me universitetet 2016 – 2022</i></p> <p><i>Ev. 28. Marrëveshjeve me biznesin, siper marrjet dhe institucione te tjera 2016 – 2022</i></p> <p><i>Ev.30. Raporti Institucional Vjetor i KU IKT per vitin akademik 2021-2022 shqip</i></p> <p><i>Ev. Aneksi 1 RVB</i></p> <p><i>Ev. Aneksi 2 RVB</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia</p>	<p>Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit përmes strukturave të tij monitoron në vijimësi</p>

<p>përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>ecurinë e përgjithshme të punës dhe e integron në Raportin Institucional vjetor të KU IKT. GVJ konstaton se mungojnë analiza për përfitimet konkrete të marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit mësimor.</p> <p><i>GVJ sugjeron se analizat për vlerësimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit për këtë program studimi të bazohen në treguesit si: realizimi i praktikave mësimore të studentëve pranë kompanive të ndryshme, realizimi i mobiliteteve të studentëve drejt universiteteve europiane, punësimi studentëve, realizimi studimeve shkencore nga stafi akademik, etj.</i></p> <p>Ev. 26. Marrëveshjet në kuadër të Erasmus+ 2016-2022</p> <p>Ev. 27. Marrëveshjet me universitetet 2016 – 2022</p> <p>Ev. 28. Marrëveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione të tjera 2016 – 2022</p> <p>Ev.30. Raporti Institucional Vjetor i KU IKT për vitin akademik 2021-2022 shqip</p> <p>Ev. Aneksi 1 RVB</p> <p>Ev. Aneksi 2 RVB</p>
--	--

<p>Konkluzione</p>	<p>KU IKT ka krijuar marrëveshje dhe marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, dhe me shumë struktura shtetërore dhe private me objekt ndërtimin e kapaciteteve, shkëmbimin e burimeve njerëzore, ndërtimin e programeve të reja të studimit dhe aftësimin e studentëve për tregun e punës. Pjesë e bashkëpunimeve janë dhe përmes programit Erasmus+ me përfitim për stafin dhe studentët e programit të studimit. <i>GVJ sugjeron zhvillimin e analizave periodike për përfitimet konkrete të marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit mësimor.</i></p>
---------------------------	--

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Marketing Digjital” e përmbush kriterin 1 pasi është program i ciklit të dytë i organizuar në module/lëndë të cilat kanë kreditet përkatëse ECTS, në përfundim të të cilit lëshohet diploma master i shkencave. Si jemi shprehur dhe më sipër, programi ka 120 ECTS, zhvillohet në dy vite akademike të ndarë në 4 semestra dhe zbaton përcaktimet ligjore që burojnë nga legjislacioni i arsimit të lartë. Ndarja në kategoritë përkatëse, ndarjet e orëve për çdo lëndë me kreditet përkatëse për çdo semestër, përcaktohen në rregulloren e programit dhe planin mësimor të tij dhe reflektojnë kërkesat e akteve nënligjore në fuqi të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p><i>Evidenca 9. Rregullore Institucionale e KU IKT</i> <i>Evidenca 11. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidenca 13 Rregullore Mesimore e Programit MSc në Marketing Digjital shqip</i></p>
<p>Kriteri 2.Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose</p>	<p>Programi synon të formojë studentë me njohuri në fushën Marketingut Digjital. Studentët që ndjekin këtë program studimi kanë mundësi të punësohen apo të vijojnë karrierën e tyre profesionale (pasi shumica janë të punësuar kur regjistrohen në IKT) kryesisht në institucione private. Studentët që përfundojnë këtë program studimi mund të punësohen si :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Specialist marketingu digjital • Analist marketingu ose Menaxher marketingu • Analist i përpunimit të të dhënave digjitale • Konsulent për strategjinë e marketingut digjital • Specialist marketingu në mediat digjitale • Sipërmarrës në mediat digjitale dhe menaxhues në rrjetet sociale

<p>profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • E-Commerce <p>Gjithashtu programi i mundëson studentëve të cilët kanë interes të vijojnë studimet e ciklit të tretë. Lëndët dhe veprimtaritë mësimore të programit lidhen harmonikisht me objektivat formuese të programit të studimit. Në vlerësimin që vet stafi i angazhuar në programin e studimit Marketing Digjital paraqet fushat e specializimit të studentëve që ndjekin këtë program studimi. Në përfundim të studimeve studenti :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të jetë pajisur me njohuri të përgjithshme mbi marketingun digjital; • Të specializohet në planifikimin e marketingut digjital; • Të ketë mjeshtëruar krijimin e strategjisë së marketingut digjital; • Te specializohet në studim të sjelljes konsumatore; <p>Si edhe të jetë i pajisur me njohuri në fushat e:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Metodave të kërkimit në marketing; • Kërkimit dhe strategjisë së marketingut; • Kanaleve të shpërndarjes dhe menaxhimit të shitjes; • Menaxhimit të markës dhe marrëdhënieve me klientët; • Marketingut ndërkombëtar dhe të shërbimeve; • Marketingut të institucioneve dhe marketingut social; • Marketingut të sipërmarrjes dhe marketingut në internet, <p><i>Evidencë 8. Vleresim i programit te studimit MSc ne Marketing Digjital prej Fakultetit dhe Departamentit</i> <i>Evidencë 21. Programet e lendeve 2021 - 2022.</i> <i>Evidence 21. Programet e lendeve 2022 - 2023</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>IAL i ka të përcaktuara në programin e studimit ngarkesën në kredite të praktikës mësimore, konkretisht me 12 kredite dhe</p> <p><i>Evidencë 8. Vleresim i programit te studimit MSc ne Marketing Digjital prej Fakultetit dhe Departamentit</i></p>

	<p><i>Evidencë 21. Programet e lendeve 2021 - 2022.</i></p> <p><i>Evidence 21. Programet e lendeve 2022 - 2023 diplomën me 18 kredite.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	N/A
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	N/A
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në</p>	<p>Në Rregulloren e Programit të studimit Marketing Digjital përcaktohet qartë, forma e organizimit të studimeve, si dhe pranimi i studentëve. Rregullorja mësimore e programit të ciklit të dytë të studimit në “Marketing Digjital” mbështetet në ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe VKM, Nr. 781, Datë 10.11.2011 “Për Licencimin e Shkollës së lartë universitare private “Instituti Kanadez i Teknologjisë”,</p>

<p>kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Urdhërat dhe Udhëzimet e MASR, në Statutin dhe Rregulloren Mësimore të Institutit Kanadez të Teknologjisë (CIT).</p> <p><i>Evidencë 13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital shqip.(Pika 1 dhe 2)</i></p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë,</p>	<p>Departamenti i Administrim Biznesit dhe i Teknologjisë së Informacionit në Fakultetin Ekonomik të KU-IKT nuk ofron programe të ngjashme në të njëjtën fushë studimi.</p> <p><i>Evidenca RVB Master Shkencor në Marketing Digjital</i></p>
<p>Kriteri 8.Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, mbështetur në sipas klasifikimin/kodifikimin e programeve të studimit sipas VKM 310, datë 11.05.2022, "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe ka kodin: 72MS0414A.</p> <p>Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. Programi i studimit Master i Shkencave në Marketing Digjital, është një program i cili ka të kodifikuar lëndët që ofron sipas standardeve ndërkombëtare për kodifikimin. IAL është e pajisur me rregulloren e kodifikimeve.</p> <p><i><u>GVJ sugjeron</u> që kjo rregullore të përditësohet edhe me programin e studimit MSH Marketing Digjital. Në syllabuset e lëndëve pasqyrohen kodet përkatëse.</i></p> <p><i>Evidenca 25. Rregullorja per Kodifikimin e Lendeve eng.</i> <i>Evidenca 21. Programet e lendeve 2021 – 2022</i> <i>Evidenca . 21. Programet e lendeve 2022 - 2023</i></p>
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>KU "IKT" dhe Fakulteti i Ekonomisë nuk ofrojnë programe të përbashkëta me institucione të tjera dhe pse IAL është duke bërë përpjekje për njohje kreditesh me disa IAL të huaja.</p> <p><i>Evidenca RVB Master Shkencor në Marketing Digjital</i></p>

Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që KU-IKT e organizon Programin e studimit në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2																																	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.																																	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Departamenti «Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni» funksionon bazuar në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet nënligjore në fuqi, statutin e institucionit si dhe rregulloret e tjera institucionale të «Institutit Kanadez të Teknologjisë.</p> <p>Departamenti është njësia bazë që përgjigjet për cilësinë e programit MSH Marketing Digjital. Po kështu ky departament është përgjegjës edhe për programet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bachelor në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni - Master i Shkencave në Teknologji Informacioni në Biznes <p>Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas dy viteve akademike që paraqiten si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="593 1532 1399 1924"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/ grada</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2022-2023</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr.</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD.</td> <td>5</td> <td>-</td> <td>6</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> </tbody> </table>				Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	-	-	-	-	Prof. Asoc.	2	-	1	1	Dr./PhD.	5	-	6	1	Msc.	1	-	2	-
Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023																														
	PAE	PAK	PAE	PAK																													
Prof.Dr.	-	-	-	-																													
Prof. Asoc.	2	-	1	1																													
Dr./PhD.	5	-	6	1																													
Msc.	1	-	2	-																													

	Totali	8	0	9	2
	<p><i>Dokument 12 Rregullore e Departamentit të Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni.</i></p> <p><i>Evidenca RVB Master Shkencor në Marketing Digjital(tabelat përmbledhëse tab 2</i></p>				
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Njësia bazë, Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit përbëhet nga një staf me kohë të plotë prej 9 anëtarësh PAE për vitin akademik 2022-2023, dhe 2 pedagogë PAK. Si u përmend edhe më sipër pedagogët e angazhuar në këtë program studimi disponojnë gradën doktor që është kusht për të dhënë mësim në nivelin e ciklit të dytë. Stafi PAE mbulon 90% të ngarkesës së programit të studimit MSH Marketing Digjital, ndërsa 10% mbulohet nga stafi PAK.</p> <p><i>Evidenca RVB Master Shkencor në Marketing Digjital(tabelat përmbledhëse (Tabela 4)</i></p> <p><i>Evidenca 19. Plani mesimor i programit MSC. Marketing Digjital.pdf</i></p>				
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Me vendim të këshillit të Fakultetit Ekonomik Nr 1, datë 29.09.2022, Departamenti i Administrimit të Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit ka caktuar, përgjegjës aktual të departamentit, si koordinatort të programit MSH Marketing Digjital. Koordinatori i programit Master i Shkencave në Marketing Digjital raporton në mënyrë periodike dhe mban lidhje të drejtpërdrejta me aktorët që lidhen direkt dhe indirekt me programin e studimit. Ai dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit ashtu siç dhe kontribuon në detyra të tjera që kanë të bëjnë me këshillimin e studentëve, ndjekjen e procesit të përzgjedhjes së temave të diplomave, supervizon procese si ai i praktikave mësimore.</p> <p><i>Evidenca RVB Master Shkencor në Marketing Digjital</i></p>				
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njësia kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit MSH Marketing Digjital përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi, si në terma të numrit por edhe cilësisë së stafit të angazhuar.</i></p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	

				X
--	--	--	--	----------

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Duke analizuar dokumentacionin e dërguar, bazuar edhe në vizitën në institucion, GVJ vëren se njësia bazë ka informacionet në lidhje me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit MSH Marketing Digjital. Programi i studimit, bazuar në VKM nr. 41, datë 24.01.2018, përmban elementët e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) kreditet ECTS; b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit; c) objektivat formues dhe kompetencat profesionale; ç) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit; d) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi; dh) planin mësimor; e) kuotat e pranimit; ë) programin lëndor; f) profilin e programit; g) diplomën dhe suplementin <p><i>Evidenca 21. Programet e lendeve 2021 – 2022</i> <i>Evidenca . 21. Programet e lendeve 2022 – 2023</i> <i>Evidenca 19. Plani mesimor i programit MSC. Marketing Digjital.pdf</i> <i>Evidencë 13. Rregullore Mesimore e Programit MSC ne Marketing Digjital shqip</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin</p>	<p>Siç jemi shprehur disa herë edhe më sipër, programi i studimit i përket ciklit të dytë organizohet në lëndë me ECTS. Veprimtaria</p>




<p>mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: provimet+ detyra kursi/projekte individuale + pjesëmarrja aktive në procesin mësimor, përgatitje e tezës së diplomës, praktika profesionale.</p> <p><i>Evidenca 21. Programet e lendeve 2021 – 2022</i> <i>Evidenca . 21. Programet e lendeve 2022 – 2023</i> <i>Evidenca 19. Plani mesimor i programit MSC. Marketing Digjital.pdf</i> <i>Evidencë 13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital shqip</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Ky program ka detajuar në rregulloren e tij - bazuar në kriteret ligjore - dhe i ka publike, elementet që kanë të bëjnë me kriteret e pranimit dhe transferimit. Në varësi të kuotave të akorduara nga ministria e arsimit, KU-IKT pranon transferime nga IAL të tjera vendase ose të huaja. Procesi i vlerësimit të kurrikulës dhe njohjes së lëndëve bëhet nga Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit (të Kurrikulës) të Departamentit. Studenti regjistrohet në vitin e dytë nëse i janë njohur jo më pak se 30 kredite.</p> <p><i>Evidencë 13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital shqip (Pika 9 Transferimet)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminar apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit dhe vizitën në IAL evidentoi që, programi ka syllabuset për secilën lëndë. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Syllabus përcakton mënyrën e vlerësimit që ndjek çdo pedagog. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të mëposhtëm: Provimet + detyra kursi/projekte individuale + pjesëmarrja aktive në procesin mësimor. Çdo pedagog, në përputhje me natyrën e lëndës dhe rëndësinë që ka aspekti aplikativ, përcakton ndarjen/peshën e secilit komponent në vlerësimin përfundimtar dhe i prezantohen studentit me prazantimin e syllabusit të çdo kursi.</p> <p><i>Megjithatë GVJ, evidentoi se hartimi i syllabuseve nuk ka respektuar formatin e miratuar nga VKM nr. 41 datë 24.01.2018.</i></p>

	<p><i>Evidenca 21. Programet e lendeve 2021 – 2022</i></p> <p><i>Evidenca . 21. Programet e lendeve 2022 – 2023</i></p> <p><i>Evidenca 19. Plani mesimor i programit MSC. Marketing Digjital.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital shqip</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Institucionit i lejohej që deri në masën 20 % të përmbajtjes së programit, të shprehur në kredite ECTS, me miratim të Senatit të ndërmarrë ndryshime. Bazuar në dokumentacionin e dërguar por edhe nga vizita në IAL nuk ka ndryshime pasi është viti i parë që ky program studimi aplikohet. Vlen për t'u përmendur që vet natyra e programit paraqet sfida të mëdha për vet fushën që mbulon. Kujdes i veçantë është treguar në lidhje me literaturën e cila mbulohet në pjesën më të madhe me botimet të shtëpisë botuese të njohur McGraw Hill, literatura e përdorur është e pesë viteve të fundit.</p> <p><i>Evidenca 21. Programet e lendeve 2021 – 2022</i></p> <p><i>Evidenca . 21. Programet e lendeve 2022 – 2023</i></p> <p><i>Evidenca 19. Plani mesimor i programit MSC. Marketing Digjital.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital shqip</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që IAL e përmbush këtë kriter sepse programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin, orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit. Po kështu literatura është e pesë viteve të fundit. GVJ rekomandon përshtatjen e syllabuseve në formatin e kërkuar nga VKM nr 41.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësi për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ vëren se emërtimi i programit MSH në Marketing Digjital është i përshtatshëm me përmbajtjen dhe shpërndarjen e lëndëve dhe praktika mundëson përmbushjen e objektivave të programit dhe aftësimin e studentëve në Marketing Digjital. Por si është thënë dhe më sipër dinamika e ndryshimeve teknologjike të kohëve të fundit sidomos përdorimi i Inteligjencës Artificiale (AI) e bën të nevojshme përditësimin të tematikave me tematikat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strategjitë e Marketingut dhe Zbatimi i AI: Eksplorimi se si bizneset mund të zhvillojnë dhe ekzekutojnë strategji të AI për të fituar një avantazh konkurrues; • Etika në marketing dhe AI: Diskutimi i konsideratave etike që rrethojnë IA; • Analiza parashikuese dhe Përdorimi i Machine learning deep learning në Biznes dhe marketing: që trajtojnë se si të shfrytëzohen algoritmet e AI për analiza parashikuese dhe vendimmarrje ; • AI në Marketing dhe Shitje: Studimi se si AI përdoret në segmentimin e klientëve, marketingun e personalizuar dhe parashikimin e shitjeve; • Inovacioni i drejtuar nga AI: Kuptimi se si AI mund të nxisë inovacionin në zhvillimin e produktit dhe proceset e biznesit; • AI dhe Modelet e reja të Biznesit, se si AI mund të çojë në modele të reja biznesi; • Sipërmarrja e drejtuar nga AI: Eksplorimi sesi startup-et përdorin AI për ide inovative biznesi; • AI dhe Përvoja e Klientit: Studimi se si AI përmirëson ndërveprimet me klientët, nga chatbot-et deri të rekomandimet e personalizuara. Etj; <p>Megjithatë në momentin e vlerësimit lëndët e programit janë të krahasueshme me programe të ngjashme në Poloni, Gjermani etj, dhe i ofrojnë studentëve mundësinë të fitojnë aftësi përmbajtësore dhe profesionale që t'i bëjnë ato të përshtatshëm me tregun e punës.</p>




	<p><i>Evidenca 21. Programet e lendeve 2021 – 2022</i></p> <p><i>Evidenca . 21. Programet e lendeve 2022 – 2023</i></p> <p><i>Evidenca 19. Plani mesimor i programit MSC. Marketing Digjital.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital shqip</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Programi MSH në Marketing Digjital, bazuar në rregulloren dhe dosjen e plotë të tij, është organizuar si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 vite akademike/4 semestra; - Kredite për semestër 30 ETC/ për vit akademik 60; në total 120 ETC; - Numri i moduleve 15, 10 module në vitin e parë dhe 5 module në vitin e dytë; - Në vitin e dytë zhvillohet praktika (12 ETC) dhe mikroteza për mbrojtjen e diplomës (18ETC); - ngarkesa mësimore sipas planit mesimor është 3000 orë në total, 1794 orë jashtë auditori dhe 1206 orë në auditor; -orët në auditor janë të ndara si vijon: 462 orë leksione, 208 orë seminare, 176 orë ushtrime, laboratorë 54 orë, projekte 6 orë dhe 300 orë praktikë profesionale; - Forma e mësimdhënies: Leksione / seminare / projekte / detyra kursi/provim i ndërmjetëm; - Forma e kontrollit, e vazhduar, dhe pjesa (në %) ndaj totalit të vlerësimit; - Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive 10%-15% - Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) 20%-30% - Testimet gjatë vitit 20%-30% - Provimi përfundimtar 40%
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Praktika mësimore zhvillohet në semestrin e dytë, përkatësisht nga 20 orë në javë e shtrirë në 15 javë. - Semestri zhvillohet në 15 javë mësimore
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve,</p>	<p>Lëndët janë të organizuara me 6 ETC, orët në auditor zakonisht ndjekin këtë rregull: 60 deri 62 orë në auditor nga të cilat: 30 orë</p>




<p>mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>leksione dhe pjesa tjetër ndahet midis seminareve 16 orë dhe 14 orë ushtrime.</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Mbështetur në VKM 41/2018, programi MSH në Marketing Digjital është strukturuar në:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Lëndë të formimit të përgjithshëm - 1 lëndë (6 ECTS ose 5%) standarti (5-10%) 2. Lëndë Karakterizuese – 11 lëndë (66 ECTS ose 55%), standarti (50-60%) 3. Lëndë ndërdisiplinore/integruese– 3 lëndë/6ETC (18 ECTS ose 15%), standarti (12-20%) 4. Lëndë plotësuese– 1 lëndë, Praktika profesionale (12 ECTS ose 10%), standarti (10%) 5. Detyrimet përmbyllëse, - Tema e diplomës (18 ECTS ose 15%), standarti (10-15%) <p><i>Si shihet edhe nga paraqitja më sipër IAL ka respektuar standartin shtetëror në strukturën e programit megjithatë, lëndë si Advanced Research Methods and communication skills bashkë me lëndën Economic and Legal Environment do të ishin më të përshtatshme të klasifikoheshin si lëndë të formimit bazë për këtë program studimi duke pasur parasysh që dy lëndët e përmendura më sipër janë të lidhura më shumë me formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme. Ndërsa lënda Financial Reporting Standarts mund të kalojë në kategorinë C, si lëndë ndërdisiplinore.</i></p> <p>Mbështetur në Rregulloren e Programit MSH në Marketing Digjital dhe syllabuset e lëndëve, mund të themi që lëndët dhe përmbajtja e tyre, shërben për të krijuar njohuritë dhe aftësuar studentët në fushat e Marketingut Digjital, u krijon mundësi që të përsosin të menduarin kritik dhe instrumenta të analizës, duke u përqasur si në funksion të nevojave që tregu lokal apo ndërkombëtar të punës. Studentët ndjekin 462 ore teorike dhe 444 orë praktike, pa përfshirë këtu praktikën mësimore. Pra shpërndarja e ngarkesës së këtij programi studimi mës teorisë dhe praktikës është e balancuar 50% me 50%.</p> <p>Analiza e tregut të punës e zhvilluar nga IAL paraqet një punim shterues të epokës së digjitalizimit në të cilin bizneset dhe individët operojnë sot. GVJ e vlerëson si aspekt pozitiv dhe pse do të vlerësonim që në kërkim tregu të integroheshin edhe instrumenta të kërkimit primar në bizneset vendase. Me këtë</p>

	<p>nënkuptojmë një identifikim të skills-eve dhe kompetencave që aktorët e biznesit kanë nevojë si në afatin e shkurtër edhe atë të mesëm.</p> <p><i>Dokument 7. Studim i tregut per programin Msc. Marketing Digjital - JANAR 2023</i></p> <p><i>Evidenca 21. Programet e lendeve 2021 – 2022</i></p> <p><i>Evidenca . 21. Programet e lendeve 2022 – 2023</i></p> <p><i>Evidenca 19. Plani mesimor i programit MSC. Marketing Digjital.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital shqip</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>GVJ mbështetur në lëndët e Programit të studimit MSH në Marketing Digjital dhe syllabuset e lëndëve, mund të themi që lëndët dhe përmbajtja e tyre, shërben për të krijuar njohuritë dhe aftësuar studentët në fushat e Marketingut Digjital, u krijon mundësi që të krijojnë të menduarin kritik dhe instrumenta të analizës, duke u përqasur si në funksion të nevojave që tregut lokal apo ndërkombëtar të punës.</p> <p><i>Evidenca 21. Programet e lendeve 2021 – 2022</i></p> <p><i>Evidenca . 21. Programet e lendeve 2022 – 2023</i></p> <p><i>Evidenca 19. Plani mesimor i programit MSC. Marketing Digjital.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimitin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Si e kemi përmendur edhe më sipër analiza e tregut të punës e zhvilluar nga IAL në Janar të vitit 2023, reflekton një pasqyrë të detajuar të qasjes së Shqipërisë ndaj digjitalizimit dhe nevojës së krijuar për programin e studimit. <i>Megjithatë, GVJ sugjeron një seksion analizë që lidhet me kompetenca direkte të këtij sektori në Shqipëri me të dhëna primare me biznesin që operon në fushën e marketingut digjital. Me këtë nënkuptojmë një identifikim të skills-eve dhe kompetencave konkrete që aktorët e biznesit kanë nevojë si në afatin e shkurtër edhe aty ku është e mundur edhe në atë të mesëm.</i></p> <p><i>Dokument 7. Studim i tregut per programin Msc. Marketing Digjital - JANAR 2023</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që ky standart plotësohet por rekomandon si më poshtë:</i></p>

	<ul style="list-style-type: none"> - formatimin e syllabuseve të lëndëve sipas VKM nr 41; - Riklasifikimin e lëndëve sipas kategorive të specifikuara më lart; - analizë e vazhdueshme me të dhëna primare nga biznesi për kompetenca të nevojitura duke pasur parasysh bumin teknologji sidomos në drejtim të AI; 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me zv dekanen e Fakultetit Ekonomik dhe përgjegjës të departamentit, Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, u pohua se ky program studimi është në vitin e parë të funksionimit të tij dhe për ta formuluar atë janë përdorur një sërë inputesh, së pari studentët të cilët kanë ndjekur programe studimi të ciklit të parë në CIT ofronin mendimet e para në lidhje me nevojat që kishin lindur, nevoja këto të lidhura me kompetenca dhe aftësi që lidhen me marketingun digjital. 70% e studentëve në këtë program studimi janë të punësuar kështu që ata përbëjnë aktorin e parë të përfshirë në ndërtimin e programit të studimit. Sipas përgjegjës të departamentit nga feedback i studentëve ky master përbën një risi për ta dhe tregun Shqiptar. Po kështu nga takimi me stafin u pohua se programi është hapur duke u bazuar në një studim të mirëfilltë tregu.</p> <p>Sipas Zv Dekanes së Fakultetit Ekonomik, të gjitha programet do të kenë një qasje të rëndësishme nga teknologjia. Në këto kushte të gjithë pedagogët po përditësojnë programet e lëndëve edhe me kurse që ofron institucioni në fushën e teknologjisë. Studentët e këtij programi studimi i zhvillonin praktikat mësimore në kompanitë ku ata janë të punësuar duke shërbyer gjithashtu edhe si një urë lidhëse me biznesin dhe nevojat e tij. Përveç, studentëve dhe feedback-ut të tyre, studimi i tregut, kontaktet me alumnin, trendet e kohës, nevojat e biznesit, konferenca të organizuara me</p>

	<p>GIZ dhe Kooperacioni Zviceran kanë qënë inpute të rëndësishme për të konfiguruar programin e studimit.</p> <p>Stafi gjithashtu përmendi Covid 19 si një nga shtytësit kryesorë të qasjes ndaj digjitalizimit dhe rritjes së kërkesës për shërbimet online. Gjithashtu orientimi apo qasja ndaj programeve të ngjashme në Evropë, Kanada e më gjerë sa i përket programeve të studimeve të ngjashme si School of Business and Innovation Gjermani, dhe Digital Marketing Communic Scientific Master Program në Kanada at St. Laërence College, etj. Nga takimi me stafin u përmend gjithashtu se për të ndërtuar programin e studimit janë referuar edhe në programe ndërkombëtare në Poloni, Hungari, Amerikë. Sipas dekanes së FE-KU-IKT, 70% e lëndëve në këtë program studimi ndjek të njëjtin emërtim të masterave të shkollave të përmendura më sipër. Po kështu dhe programe të ngjashme Msc Marketing në Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës. Marketingu tërheq një segment të gjerë studentësh, përfshirë edhe studentë të cilat kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve në fusha të tjera psh ato inxhinierike.</p> <p><i>Takimi me stafin drejtues dhe atë të angazhuar në programin e studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ nga takimi me zyrat e IAL vuri re një qasje të unifikuar sa i përket narrativës së ndërtimit të programit të studimit. Duke parë trendin e tregut botëror të punës por edhe qasjen e CIT ndaj teknologjisë u pa si e nevojshme hapja e MSH Marketing Digjital. Sipas stafit të angazhuar në këtë program studimi ishte i nevojshëm një qasje nga social science e ndërthurur me aspekte teknologjike. Pothuajse të gjitha organizatat si ato publike dhe ato private kërkojnë më shumë njohuri teknologjike nga këndvështrimi social dhe më konkretisht nga ai i marketingut. Pra vihet re që edhe stafi i angazhuar në këtë program studimi është një aktor i rëndësishëm në dizenjimin e programit të studimit. Sipas stafit të angazhuar në këtë program studimi, studentët që ndjekin këtë program vijnë nga bachelor inxhinierike por edhe nga gjuhët e huaja.</p> <p><i>Takimi me stafin drejtues dhe atë të angazhuar në programin e studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat</p>	<p>Po kështu Qendra e Inovacionit, Kërkimit dhe Zhvillimit (CIRD), panairët “Work & Study”, marrëveshjet e konsiderueshme me institucionet dhe bizneset, konferencat ndërkombëtare, strategjia</p>

<p>programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>e Alumni janë një mundësi e mirë për të marrë input të vazhdueshëm për përmirësimin e programit të studimit. Të gjithë elementët e sipërpërmendur, i japin mundësi njësisë kryesore dhe bazë për të përmirësuar, përditësuar dhe përshtatur në vazhdimësi programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca 75-76 Katalogu i veprimtarive 2020-2022</i></p> <p><i>Evidenca 81. Strategjia e Angazhimit të ALUMNI.</i></p> <p><i>68. Evidenca të organizimit të tryezave të rrumbullakta me kompanite, bizneset</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson së ky standart përmbushet plotësisht pasi IAL realizon disa aktivitete dhe përfshin një numër të rëndësishëm aktorësh në përditësimin dhe përshtatjen e programit të studimit si studentët, bizneset, qendrën e saj kërkimore, vet pedagogët, IAL të huaja dhe vendase etj.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.6</p>	
<p>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Në mbështetje të këtij kriteri, GVJ ka evidentuar Strategjinë e Kërkimit, Zhvillimit dhe Krijimtarisë në CIT. Në këtë strategji evidentohen objektivat dhe një action plan konkret për arritjen e tyre. Në këtë dokument strategjik parashtrohet se KU-IKT në procesin e përgatitjes së strategjisë së kërkimit konsideron katër faktorë kryesor (të brendshëm dhe të jashtëm) (i) kërkimi i aplikuar, (ii) studentët e diplomuar dhe ata pasuniversitar, stafi shumë i kualifikuar kërkimor, si nxitësit kryesor të aktivitetit kërkimor, (iii) cilësi e lartë kërkimi me rezultate pozitive për publikun dhe kërkuesin shkencor, (iv) kërkim me dobi për aktorë publike e privatë dhe së fundi por jo me më pak vlerë (v) kultura dhe ndërgjegjësimi për kërkimin dhe zhvillimin në IAL .</p> <p>Në këtë strategji janë vendosur objektiva si</p> <ol style="list-style-type: none"> Objektiv 1: Promovimi i një kulture/etike kërkimi mes stafit dhe studentëve (brenda);

	<p>2. Objektiv 2: Rritja e financimit dedikuar kërkimit duke përdorur mundësi të brendshme dhe të jashtme;</p> <p>3. Objektiv 3: Të kontribuojë në promovimin e një kulture kërkimi duke promovuar cilesi të lartë kërkimi shkencor në bashkëpunim me universitete të tjera, programe/rrjete kombëtare dhe ndërkombëtare;</p> <p>Si u përmend edhe më lart, themelimi dhe forcimi i Qendrës së Kërkimit Inovator dhe Zhvillimit, si një strukturë e veçantë që mbështet aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit është një element për t'u vlerësuar. Kjo qendër bashkërendon aktivitetet dhe stafet e njësive bazë për kërkim të aplikuar, për punë eksperimentale etj. Po kështu kjo qendër mbështet stafin e IKT-së në përgatitjen e aplikimeve për grante kërkimore dhe ka zhvilluar projekte aplikative për institucione publike (si psh aplikacioni i llogaritjes së pensionit). Nën veprimin e forcimit të kapaciteteve kërkimore, IKT ka reflektuar në politikat e saj se kërkimi shikohet si një shtyllë qendrore së ngarkesës së punës së stafit.</p> <p><i>Dokument RVB Master Shkencore në Marketing Digjital</i> <i>Evidenca 75-76 Katalogu I</i> <i>Evidenca 31 Raporti CIRD Ekonomi 2021-2022</i> <i>Evidenca 4 Strategjia e RDC (Kërkim, Zhvillim dhe Krijimtari)</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Po kështu në nivel IAL, sipas vendimit të Senatit Akadmik nr. 7, datë 24.09.2021, janë ngritur grupet kërkimore shkencore të ngritura me propozim të Fakultetit Ekonomik të cilat janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Grupi i Financë dhe Kontabilitetit/FinTech; 2. Grupi i Manaxhim dhe Marketing; 3. Grupi i Ekonomiks dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm; 4. Grupi i Studimeve Sociale dhe Ambientale; <p>Grupet zhvillojnë takime të herë pas hershme qoftë veç apo dhe të përbashkëta dhe përcaktojnë objektiva që lidhen me kërkimin shkencor ose me projektet. Të gjitha grupet shkencore të ngritura brenda fakultetit bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet me Qendrën e Kërkimit Shkencor CIRD ashtu si dhe me Zyrën për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Projektet. Stafit akademik dhe zyrat përkatëse kanë aplikuar për një numër të konsiderueshëm projektesh, të cilat përmenden dhe në raportin Vjetor të Institucionit për MASR. Në tre vitet e fundit KU IKT ka aplikuar për 15 projekte, prej të cilave janë fituar 5, ndërsa 4 janë në pritje.</p>

	<p>Në raportin vjetor të CIRD paraqiten gjithashtu informacione në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Grantet kërkimore shkencore; • Publikimet gjatë vitit akademik 2021-2022; • Kapitujt e librave ; • Peer-revieëed Journal papers ; • Peer-revieëed Conference papers; <p><i>Evidenca RVB Master Shkencore në Marketing Digjital</i> <i>Evidenca 75-76 Katalogu I</i> <i>Evidenca 31 Raporti CIRD Ekonomi 2021-2022</i> <i>Evidenca 4 Strategjia e RDC (Kërkim, Zhvillim dhe Krijimtari)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit që IAL ka dorëzuar për këtë vlerësim evidentohet që në këtë program studimi studentët nxiten të angazhohen në disa drejtime:</p> <p>Trajnime të realizuara nga stafi, nga studentët dhe përfaqësues të Alumni mbi tematika që lidhen programin e studimit si dhe të ftuar nga biznesi (<i>Evidencë 61 Certifikata Trajnimesh të studentëve</i>)(<i>Evidencë 75.76 Katalogu I veprimtarive 2019-2022</i>), Kompeticione të ndryshme, Mobilitete Erasmus (<i>Evidencë 77 MANUAL I MOBILITETIT TË STUDENTËVE DHE STAFIT TË CIT</i>), si dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore të organizuara nga IAL. Ndër konferencat studentore evidentohen: Konferenca Studentore: Mbi Ekonominë, Financën, Biznesin dhe Shkencat Sociale - SCE 2019, e organizuar prej Universitetit Epoka dhe në bashkëpunim me KU "IKT" (CIT) më 24 qershor 2019. Konferenca studentore "Sfidat e Biznesit në Epokën Digjitale", në bashkëpunim me: IETT, Rrjeti Rinor IETT, Albanian University, dhe Fakulteti i Ekonomisë i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, 09 qershor, 2021. Studentët kanë marrë pjesë edhe konferenca të organizuara nga IAL të tjera si ajo e organizuar nga Kolegjin Universitar Qiriazhi dhe Albanian University, me tematikën Inovacion në Inxhinieri, Shkencë dhe Teknologji". Pra, GVJ evidenton një sërë aktivitesh që kontribuojnë në plotësimi e këtij kriteri.</p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet</p>	<p>GVJ evidentoi që IAL ka mbështetur stafin akademik të Fakultetit së Ekonomisë në:</p>




<p>financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Publikimet e tyre falas në revistën shkencore të institucionit CIT Revieë, ku secili anëtar i stafit mund të publikojë pa pagesë në një revistë të indeksuar me faktor impakti.</p> <p>Pjesëmarrjen falas në konferencat e organizuara prej institucionit në bashkëpunim me insitucione të tjera. IAL gjithashtu ka sponsorizuar a. publikimit të literaturave studimore, përmbledhjeve post-doktorale b. artikujve shkencor si c. pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare etj. Për pjesëmarrjen në konferenca shkencore apo për publikimin artikujve studimor, stafi akademik aplikon sipas formateve të miratuara përmes të cilave kërkohet mbështetja financiare nga institucioni. Po kështu në Planin e Mbështetjes Financiare të Fakultetit të Ekonomisë për periudhën 2021- 2025 janë përfshirë edhe zërat a. kërkimi shkencor; b. konferenca, të cilët janë të dedikuar për stafin akademik të departamentit Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, përgjegjës për programin e studimit MSH Marketing Digjital.</p> <p><i>Evidencë 10 Libri i Rregulloreve Institucionale, Pjesa II (fq. 184-204),</i></p> <p><i>Evidencë 55. Plani i financimit të Fakultetit të Ekonomisë dhe departamenteve 2019-2025</i></p> <p><i>Evidencë 67. Evidenca mbi konferencat.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 88. Miratimi i sponsorizimit për publikimin e studimeve shkencore për Jona Puci, Ditila Ekmekçi</i></p> <p><i>Evidenca 89 Politika për Publikimin dhe Vizibilitetin e Kërkimit shqip.</i></p> <p><i>Evidenca 89. Politika për Publikimin dhe Vizibilitetin e Kërkimit eng..pdf</i></p> <p>https://cit.edu.al/research#conferences</p> <p>https://crj.cit.edu.al/</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që IAL për këtë program studimi, garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor nëpërmjet Strategjisë së Kërkimit, Qendrës për Kërkim dhe Zhvillim, CIRD, Grupeve kërkimore në FE, financimit të publikimeve, mbështetjes në përfshirjen me projekte, mobilitete etj.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Si është përmendur më sipër, në nivel IAL, sipas vendimit të Senatit Akadmik nr. 7, datë 24.09.2021, janë ngritur grupet kërkimore shkencore të ngritura me propozim të Fakultetit Ekonomik të cilat janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Grupi i Financë dhe Kontabilitetit/FinTech 2. Grupi i Manaxhim dhe Marketing 3. Grupi i Ekonomiks dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm 4. Grupi i Studimeve Sociale dhe Ambientale <p>Të gjitha grupet shkencore të ngritura brenda fakultetit bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet me Qendrën e Kërkimit Shkencor CIRD ashtu si dhe me Zyrën për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Projektet.</p> <p><i>Evidenca RVB Master Shkencore në Marketing Digital</i> <i>Evidenca 75-76 Katalogu i veprimtarive 2019-2022</i> <i>Evidenca 31 Raporti CIRD Ekonomi 2021-2022</i> <i>Evidenca 4 Strategjia e RDC (Kërkim, Zhvillim dhe Krijimtari)</i> <i>Evidenca 80. Revista Shkencore CIT Revieë Nentor 2021</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>GVJ vlerëson si pozitive ekzistencën e CIT HUB e cila shërben si një qendër inovacioni për promovimin e kreativitetit dhe sipërmarrjes. CIT HUB është konceptuar si një hapësirë ku njerëzit mund të takohen dhe ndërveprojnë, krijojnë, ndërmarrin, punojnë dhe inovojnë së bashku. Qëllimi i CIT-HUB është të inkurajojë studentët nëpër disiplina të shumta që të punojnë së bashku në një vend ku me ndihmën dhe mbështetjen e stafit të mund të krijojnë ide të reja te biznesi. Kjo qendër inovacioni përfshin një sërë inisiativash. Kjo qendër inovacioni zhvillon aktivitetin në drejtimet e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. CITI Incubator & CITI Accelerator 2. CITI MakerLab,

	<ol style="list-style-type: none"> 3. CITI Coworking spaces, 4. CITI Masterclass Trainings in technology. ICT, Finance, Business, 5. CITI Entrepreneurs Club. CITI Mentor & Trainers Club. CITI Investors Club, 6. CITi Coworking 7. CITi Networking <p>Kjo qëndër mund të krijojë një interface për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor.</p> <p><i>Evidenca RVB Master Shkencore në Marketing Digjital</i> <i>Evidenca 75-76 Katalogu i veprimtarive 2019-2022</i> <i>Evidenca 31 Raporti CIRD Ekonomi 2021-2022</i> <i>Evidenca 4 Strategjia e RDC (Kërkim, Zhvillim dhe Krijimtari)</i> https://cit-hub.al/</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit GVJ evidentoi një numër të rëndësishëm të konferencave shkencore të realizuara nga vet IAL në bashkëpunim me IAL vendase dhe të huaja. Gjithashtu, vlerësohet pozitivisht praktika e dokumentimit të tyre për 10 vitet e fundit si dhe informimi e rritja e vizibilitetit nëpërmjet faqes web. Në Cv-të e stafit të angazhuar në programin e studimit në shqyrtim paraqitet një numër i konsiderueshëm pjesëmarrjes në këto konferenca. Gjithashtu KU-IKT, ka dhe një revistë të vetën, CIT Revieë Journal, me ISSN, 2788-645X (Online), e cila publikohet dy herë në vit në gjuhën angleze. Revista përbën një tjetër mundësi për të ndihmuar stafin për arritjen e objektivave dhe promovimit akademik.</p> <p><i>Evidencë, 67. Evidenca mbi konferencat</i> <i>Evidencë 22. CV e stafit akademik te angazhuar ne programin e studimit</i> <i>Evidencë 23. CV e stafit akademik te Fakultetit te Ekonomise</i> https://crj.cit.edu.al/about-the-journal/ https://cit.edu.al/research#conferences</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues</p>	<p>GVJ vlerëson që programi i studimit Master i Shkencave në Marketing Digjital i jep mundësinë studentëve që e ndjekin të jenë konkurrues në tregun e punës jo vetëm atë kombëtar por edhe ndërkombëtar. Kjo mundësohet nga përbërja e programit</p>

për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	por edhe nga student tip që e ndjek këtë program studimi. Takimi me studentët që ndjekin këtë program studimi e konfirmoi këtë aspekt.			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	N/A			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	N/A			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që programi i studimit Master i Shkencave në Marketing Digjital i jep mundësinë studentëve që e ndjekin të jenë konkurrues në tregun e punës jo vetëm atë kombëtar por edhe ndërkombëtar. Po kështu GVJ vlerëson si pozitive ekzistencën e CIT HUB e cila ofron mundësi për krijimin e një ekosistemi që është shumë i rëndësishëm jo vetëm për këtë program studimi por shërben edhe si një praktikë e mirë për t'u ndjekur për programe të tjera në nivel Msc edhe Bsc.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
--	----------------	-----------------------	----------------------	-----------------------

				X
--	--	--	--	---

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																												
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transferimit të dijeve e njohurive të përfshira në Master i Shkencave Marketing Digjital janë leksionet, seminarët, detyra e kursit, projektet praktikat profesionale dhe diploma. Të detajuara janë shprehur në planin mësimor dhe programet e lëndëve në shqip dhe anglisht. Këto dokumente hartohen dhe miratohen duke u mbështetur në aktet nënligjore përkatëse (VKM Nr. 41, datë 24.1.2018) si dhe Statutin e Rregulloren KU IKT dhe Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave Marketing Digjital.</p> <p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Marketing Digjital realizohet me 120 kredite me kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Bazuar në disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese, që ofrohen në këto programe studimi, janë të organizuara në kategori të klasifikuara nga A në E. Kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit:</p>																												
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Kriteri për MSH (VKM 41,dt. 24.01.2018)</th> <th>Nr. i lëndëve</th> <th>Kreditet përkatëse për lëndë të programit</th> <th>Totali i krediteve për/ kategori të programit</th> <th>% e ECTS /kategori të programit</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>5%-10%</td> <td>1</td> <td>6</td> <td>6</td> <td>5%</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>50%-60%</td> <td>11</td> <td>6</td> <td>66</td> <td>55%</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>12%-20%</td> <td>3</td> <td>6</td> <td>18</td> <td>15%</td> </tr> </tbody> </table>	Kategoria	Kriteri për MSH (VKM 41,dt. 24.01.2018)	Nr. i lëndëve	Kreditet përkatëse për lëndë të programit	Totali i krediteve për/ kategori të programit	% e ECTS /kategori të programit	A	5%-10%	1	6	6	5%	B	50%-60%	11	6	66	55%	C	12%-20%	3	6	18	15%				
Kategoria	Kriteri për MSH (VKM 41,dt. 24.01.2018)	Nr. i lëndëve	Kreditet përkatëse për lëndë të programit	Totali i krediteve për/ kategori të programit	% e ECTS /kategori të programit																								
A	5%-10%	1	6	6	5%																								
B	50%-60%	11	6	66	55%																								
C	12%-20%	3	6	18	15%																								

D	10%	1	12	12	10%
E	10%-15%	1	18	18	15%
Σ				120	100%

Kreditet e çdo lënde mbajnë parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore pune të studentit, e përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit. Mësimdhënia/mësimnxënia rregullohet në Statut, Rregulloren e KU IKT dhe Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave në Marketing Digjital, që shërbejnë si referencë me nenet përkatëse.

Ev.1 Statuti i KU IKT 2016 shqip

Ev.1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar shqip

Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT shqip

Ev.11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise

Ev.12. Rregullore e departamentit Admin Biznesi dhe Tek Informacioni

Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital

Ev.19. Plani mesimor i programit MSC. Marketing Digjital

Ev 21. Programet e lendeve 2022 - 2023

Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.

Personeli akademik respekton dhe i përgjigjet në vijimësi diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit Marketing Digjital dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. Pjesa më e madhe e moduleve të programit përmbajnë detyrime për përgatitjen e detyrave të kursit në grup, të cilat i aftësojnë studentët për përthithjen dhe zbatimit e informacionit teorik si dhe aftësinë e të punuarit në grup.

Lëndët e programit të studimit kanë karakter aplikativ dhe realizohen përmes detyrave specifike me fokus zhvillimin e aftësive praktike, kryerjen e kërkimeve të tregut dhe aplikimin e tyre në situata reale të bizneseve shqiptare. Për më tepër metoda të tjera të përdorura nga personeli akademik në përputhje me nevojat e diversitetin e

	<p>studentëve përfshijnë diskutime dhe punë në grupe, krijimi i skenarëve të diskutimit të cilët nxisin të menduarit kritik, të pasqyruara në <i>Evidencën 21. Programet e lendeve 2022 – 2023.</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSC. ne Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev.19. Plani mesimor i programit MSC. Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev 21. Programet e lendeve 2022 - 2023</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>KU IKT mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet homologe. Objekti kryesor i këtyre marrëveshjeve përfshin: shkëmbimin e personelit akademik (pedagog, kërkues) për procesin mësimor dhe veprimtari kërkimore; nxitjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore shkencore; organizimin e konferencave, trajnimeve, seminareve, shkëmbimin e materialeve akademike dhe literaturës shkencore. <i>Evidenca 75. Katalogu i veprimtarive 2019 – 2022</i></p> <p>Fakulteti i Ekonomisë është aktiv në përmirësimin e kopentencave dhe përmes sigurimit të literaturës akademike nga McGrawHill Education (<i>Ev. 54</i>), si dhe përmes trainimeve profesionale në mbështetje dhe të programit të studimit të renditura në Aneksin 2 të RVB. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se në funksion të moduleve aplikative, KU IKT ka në dispozicion infrastrukturën dhe laboratorët kompjuterike ku stafi akademik, përdor mjete audio-vizive të mësimdhënies dhe studentët mund të mësojnë duke zgjidhur vetë raste e detyra praktike.</p> <p><i>Ev 26. Marreveshjet ne kuader te Erasmus+ 2016-2022</i></p> <p><i>Ev 27. Marreveshjet me universitetet 2016 – 2022</i></p> <p><i>Ev 29. Anetaresimi i IKT ne Cisco Academy.pdf</i></p> <p><i>Ev.54. Marreveshje CIT - McGrawHill Education</i></p> <p><i>Ev.60. Certifikatat e trajnimeve te stafit</i></p> <p><i>Ev 68. Evidenca te organizimit te tryezave te rrumbullakta me kompanite, bizneset.</i></p> <p><i>Ev 67. Evidenca mbi konferencat</i></p> <p><i>Ev 75. Katalogu i veprimtarive 2019 – 2022</i></p>

	<p><i>Ev 76. Katalogu i veprimtarive 2022 - 2023</i></p> <p><i>Ev 93. Fatura e blerjes së licensave të PC të fundit nga Microsoft</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik, i angazhuar në mësimdhënie në Programin e Studimit Master i Shkencave në Marketing Digjital është i kualifikuar sipas profilit të lëndës që zhvillon. Kompetencat dhe kualifikimi i stafit akademik dhe stafit ndihmes akademik jepen në mënyrë të detajuar dhe në CV-të e tyre <i>Ev.22. CV e stafit akademik te angazhuar ne programin e studimit.</i> Njësia bazë planifikon ngarkesën mësimore për të gjithë anëtarët e personelit akademik, mbështetur në normat e ngarkesës mësimore të përcaktuara nga udhëzimet e MASR, në shkallën e kualifikimit, të eksperiencës dhe fushën e kompetencës të çdo anëtari të personelit akademik, si dhe në numrin e grupeve mësimore për programet e studimit ku është i përfshirë.</p> <p>Punësimi i personelit akademik efektiv apo me kontratë bëhet konform bazës ligjore në fuqi, Ligj Nr 80/2015, Neni 64, pika 1, Neni 57, pika 2, si dhe procedurave përkatëse për rekrutimin e stafit akademik (<i>Evidenca 46, 47, 48</i>) e cila fillon me identifikimin e nevojave për staf, përcaktimin e kriterëve të punësimit të propozuara nga njësia bazë konform nevojave, miratimin nga titullari i institucionit dhe shpalljen e kërkesave për personel akademik .</p> <p>Nga shqyrtimi i CV-ve dhe dokumentacionit të personelit akademik, GVJ konstaton se fusha e ekspertizës së pedagogëve përputhet me syllabusin e lëndës në të cilën është titullar dhe mbështetin studentët përmes metodave interaktive të mësimdhënies të evidentuara dhe në Programet e Lëndëve përgjegjëse.</p> <p><i>Ev 21. Programet e lendeve 2022 - 2023</i></p> <p><i>Ev.22. CV e stafit akademik te angazhuar ne programin e studimit.</i></p> <p><i>Ev 23. CV e stafit akademik te Fakultetit te Ekonomise</i></p> <p><i>Ev 17. Manuali i Stafit Akademik Tetor 2021</i></p> <p><i>Ev 45. Permbledhje Aktiviteti Shkencor ne Fakultetin e Ekonomise - 5 vitet e fundit.</i></p> <p><i>Ev 46. Burimet Njerezore - Check Lista e dosjes personelit.</i></p> <p><i>Ev 47. Burimet Njerezore - Hapja e nje pozicioni pune</i></p> <p><i>Ev 48. Burimet Njerezore - Vleresimi i Kandidateve</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit,</p>	<p>Përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit të kurrikulës universitare dhe rritjes së cilësisë është pjesë e politikave dhe strategjisë së KU IKT. <i>Ev.1 Statuti i KU IKT; Ev.9. Rregullore</i></p>

<p>vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p><i>Institucionale e KU IKT.</i> Studentët bëhen pjesë e përmirësimit të cilësisë përmes përfaqësimit të tyre në organet dhe strukturat përkatëse të KU IKT-së, anketimit periodik, takimet e hapura dhe komunikimi me koordinatorin e programit të studimit. Departamenti i Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni vlerëson dhe adreson kërkesat dhe sugjerimet e studentëve për të rritur cilësinë e mësimdhënies. Anketimi i realizuar nga NJSBC çdo fund semestri është mënyra kryesore për tërheqjen e mendimit të studentëve. Mendimet dhe sugjerimet reflektohen në vazhdimësi me qëllim përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Gjithashtu, titullari i lëndës në përfundim të procesit mësimor, japin mendime në lidhje me zhvillimin e lëndës, si dhe propozojnë përmirësime në programin e lëndës.</p> <p><i>Ev.1 Statuti i KU IKT 2016 shqip</i></p> <p><i>Ev.1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar shqip</i></p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT shqip</i></p> <p><i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise</i></p> <p><i>Ev.12. Rregullore e departamentit Admin Biznesi dhe Tek Informacioni</i></p> <p><i>Ev 14. Manuali i Sigurimit te Cilesise - QAU Handbook</i></p> <p><i>Ev 17. Manuali i Stafit Akademik Tetor 2021</i></p> <p><i>Ev.33. Vlerësimi i programit te studimit Msc. ne Digjital Marketing nga studentët</i></p> <p><i>Ev 90. Procesverbale takimesh te NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>KU IKT është angazhuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies me ngritjen e strukturave përkatëse të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtorinë e Kurrikulave, të cilat janë përgjegjëse për respektimin e standardeve të përgatitjes së planeve mësimore, syllabuseve të lëndëve si dhe të gjithë dokumentacionit të programeve të studimit, si dhe për përmirësimin e cilësisë së stafit akademik, përmirësimin e infrastrukturës laboratorike e të mësimdhënies dhe përsosjen e metodave të mësimdhënies, elementë të cilët i nënshtrohen një vlerësimi periodik nga njësitë bazë dhe studentët. NJSC gëzon autonomi të plotë në veprimtarinë e saj dhe planifikon e organizon vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit. Për këtë qëllim ajo bashkëpunon me autoritetet dhe strukturat përkatëse të institucionit për përmirësimin e</p>




<p>Strukturat dhe njësité përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. Evidenca 14, 90</p> <p><i>Ev.8. Vlerësim i programit të studimit MSC. në Marketing Digjital prej Fakultetit dhe Departamentit</i></p> <p><i>Ev.10. Libri i Rregulloreve Institucionale</i></p> <p><i>Ev.14. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook</i></p> <p><i>Ev.33. Vlerësimi i programit të studimit Msc. në Digjital Marketing nga studentët</i></p> <p><i>Ev.90. Procesverbale takimesh të NJSBC</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Mësimdhënia/mësimnxënia rregullohet në Statut, Rregulloren e KU IKT dhe Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave në Marketing Digjital. Personeli akademik respekton dhe i përgjigjet në vijimësi diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit Marketing Digjital. Pjesa më e madhe e moduleve të programit përmbajnë detyrime për përgatitjen e detyrave të kursit në grup, të cilat i aftësojnë studentët për përthithjen dhe zbatimin e informacionit teorik si dhe aftësinë e të punuarit në grup. Përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit të kurrikulës universitare dhe rritjes së cilësisë është pjesë e politikave dhe strategjisë së KU IKT. KU IKT është angazhuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies me ngritjen e strukturave përkatëse të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtorinë e Kurrikulave, të cilat janë përgjegjëse për respektimin e standardeve të cilësisë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.2</p>	
<p>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve në KU IKT është përcaktuar në Rregulloren Institucionale dhe në Rregulloren e Programit të Studimit. Qëllimi është realizimi i kontrollit të dijeve për të arritur në një vlerësimi objektiv dhe të paanshëm të studentit. Kontrolli i dijeve është një nga veprimtaritë e procesit mësimor i cili ka për qëllim ti motivojë studentët për të studiuar. Në mënyrë që të shmanget tendenca që studenti të studiojë vetëm në periudhën e provimeve përdoret forma e kontrollit të vazhduar.</p> <p>Njohuritë e përfuara nga studentit kontrollohen përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimit në auditor, provimeve me shkrim, detyrave të kursit, që zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti përkatës dhe që janë të detyrueshme për zbatim si nga pedagogët ashtu dhe nga studentët. Raporti i vlerësimit të vazhduar gjatë vitit me raportin përfundimtar përcaktohet nga pedagogu i lëndës dhe miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit në fillim të cdo semestri. Në syllabusin e secilës lëndë të këtij programi studimi përshkruhet një seksion i veçantë lidhur me formën e kontrollit dhe vlerësimit të njohurive.</p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT shqip</i> <i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise</i> <i>Ev.12.Rregullore e departamentit Admin Biznesi dhe Tek Informacioni</i> <i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i> <i>Ev.19. Plani mesimor i programit MSC. Marketing Digjital</i> <i>Ev 21. Programet e lendeve 2022 - 2023</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e</p>	<p>Personeli akademik pjesë e programit Master i Shkencave në Marketing Digjital në fillim të çdo lënde/moduli informon studentët për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore në përputhje të plotë me Rregulloren Institucionale, Rregulloren e Fakultetit dhe atë të programit të studimit. Në programin e lëndës/modulit shprehen mënyrat e vlerësimit të saj, të cilat i bëhen të njohura studentit me fillimin e procesit mësimor. Kriteret e vlerësimit përcaktohen nga titullari i lëndës dhe i bëhen të ditura studentit që në fillim të procesit mësimor nëpërmjet sqarimit nga ana e</p>




<p>lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>pedagogut të syllabusit përkatës, i cili përmban të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe aftësive.</p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT shqip</i></p> <p><i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise</i></p> <p><i>Ev.12.Rregullore e departamentit Admin Biznesi dhe Tek Informacioni</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev.19. Plani mesimor i programit MSC. Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev 21. Programet e lëndëve 2022 - 2023</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Instrumente në kontrollin e vazhdueshëm, përpara provimit përfundimtar përfshinë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Raste studimore; • Punë në grupe; • Detyra Kursi; • Projekte Kërkimore; • Provime të ndërmjetme (testimeve gjatë semestrit); <p>Kontrolli përfundimtar i dijes së një lënde (provimi përfundimtar) bëhet me shkrim duke u mbështetur në programin mësimor. Pedagogu i lëndës i komunikon studentit, në orën e fundit të mësimt:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të drejtën e paraqitjes ose jo në provim; • nivelin e pikëve të fituara në format e tjera të kontrollit të vazhdueshëm; • kriteret e vlerësimit përfundimtar; <p>Rregulla apo specifika të provimeve, pesha (përqindja) e secilit provim apo detyre në vlerësimin përfundimtar, detyrat e kursit, projektet individuale, apo forma të tjera të vlerësimeve gjatë vitit, përcaktohen në syllabus-in e lëndës të hartuar nga pedagogu dhe u bëhet i ditur studentëve që ndjekin atë kurs në fillim të procesit mësimor.</p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSC. ne Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev.19. Plani mesimor i programit MSC. Marketing Digjital</i></p>





	<i>Ev 21. Programet e lëndëve 2022 - 2023</i>		
Konkluzione	<i>Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve në KU IKT është përcaktuar në Rregulloren Institucionale dhe në Rregulloren e Programit të Studimit. Njohuritë e përfuara nga studenti kontrollohen përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimit në auditor, provimeve me shkrim, detyrave të kursit, që zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti përkatës dhe që janë të detyrueshme për zbatim si nga pedagogët ashtu dhe nga studentët. Në syllabusin e secilës lëndë të këtij programi studimi përshkruhet një seksion i veçantë lidhur me formën e kontrollit dhe vlerësimit të njohurive.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Kontrolli i dijes në një lëndë në nivelin master në KU IKT bëhet në mënyrë të vazhdueshme, përgjatë kohës së zhvillimit të lëndës. Format kryesore të kontrollit të vazhduar për vlerësimin e nivelit të dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të lëndës janë: teste, rastet studimore, simulime, detyra e kursit, projektet e kursit, provimet e ndërmjetme dhe forma të tjera të përdorura nga pedagogët në varësi të lëndëve. Nga shqyrtimi i syllabuseve GVJ konstaton se në asnjë rast nuk kemi një rezultat përfundimtar të kontrollit të dijeve bazuar vetëm në rezultatin e provimit përfundimtar. Bazuar në Rregulloren Institucionale dhe Rregulloren e Programit të studimit Msc. Marketing Digjital, dhe programet e lëndëve vlerësimi organizohet në: Pjesëmarrja – 10% Detyra Kursi- 20-30%

	<p>Provim i Ndërmjetëm – 20-30%</p> <p>Provim Përfundimtar- 40%</p> <p>Studenti ka të drejtën e hyrjes në provim kur plotëson kushtet e përcaktuara në rregulloret e studimeve sipas procedurës për vlerësimin e dijeve, dhe i nënshtrohet provimit përfundimtar.</p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT shqip</i></p> <p><i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev.19. Plani mesimor i programit MSC. Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev 21. Programet e lëndëve 2022 - 2023</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Çdo pedagog në fillim të lëndës i njuh studentët me përmbajtjen e syllabusit, me informacionin e nevojshëm që përmban syllabusi: emërtimi dhe kreditet e lëndës, vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit, ngarkesa në orë në auditor si orë mësimore dhe jashtë tij, njohuritë dhe aftësitë që i jep studentit kjo lëndë, temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik, format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre, detyrimet e studentit për lëndën, format e vlerësimit të studentëve, si dhe literaturën e detyruar dhe te rekomanduar. Studentët e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing Digjital mund të informohen edhe në distance përmes sistemit UMS -University Management System për vlerësimin e njohurive. Vendosja e rezultateve në sistemin elektronik UMS lejon secilin student të shikojë vetëm vlerësimin e tij dhe askush tjetër nuk ka akses për të parë vlerësimet e tjetrit.</p> <p><i>Ev 21. Programet e lëndëve 2022 – 2023</i></p> <p><i>Ev.94. Foto evidenca te sistemit UMS</i></p> <p><i>Ev 95. Guida e Studentit</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Proçesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët në programin e studimit Master i Shkencave në Marketing Digjital bëhet në përputhje me përcaktimet në Rregulloren e KU IKT dhe Rregulloren e Programit të studimit. Në programin e lëndës shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me</p>




	<p>fillimin e procesit mësimor. Vlerësimi përfundimtar i studentëve bëhet brenda dy javëve nga data e dhënies së provimit. Pas këtij afati pedagogu dorëzon procesverbalet në sekretarinë mësimore.</p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT shqip</i></p> <p><i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev.15. Rregullore e Sekretarise cikli i dyte 2022-2023</i></p> <p><i>Ev 21. Programet e lëndëve 2022 - 2023</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Gjatë vlerësimit të gjithë elementëve të një moduli si: testi i ndërmjetëm, detyra e kursit, ose provimi final, stafi akademik bën komente gjatë korigjimit në tezë në rastin e provimeve me shkrim ose komente direkte në rastin detyrave/projekteve të kursit, të cilat ndihmojnë studentin në përmirësimi e njohurive si dhe sqarimin e paqartësive që mund të lindin gjatë këtij procesi. Lektorit bën me dije studentin për rezultatin e vlerësimit përpara plotësimit të dokumentacionit përkatës. Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij ose të paraqesë pretendimet e tij për rezultatin e marrë. Në kontaktet me pedagogët, studentët njihen me vërejtjet e pedagogëve gjatë korigjimit si edhe me pikët që do të mundësonin një zgjidhje të saktë. Gjithashtu për të rritur transparencën e procesit të vlerësimit studentit ka të drejtë të ankohet, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se numri i vogël i studentëve në këtë program studimi lehtëson ndjekjen individuale të tyre dhe ndihmon studentët të përmirësohen në aspekte të mësimnxënies.</p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT shqip</i></p> <p><i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev.15. Rregullore e Sekretarise cikli i dyte 2022-2023</i></p> <p><i>Ev 21. Programet e lëndëve 2022 - 2023</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik</p>	<p>Në Rregulloren e KU IKT dhe Kodin e Etikës janë të specifikuara qartë veprimet e ndaluara gjatë zhvillimit të</p>

<p>shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>provimit, përfshirë edhe kopjimin në provim dhe penalitetet për rastet e konstatimit të kopjimit ose plagjiaturës. Në provim nuk lejohet mbajtja dhe përdorimi i telefonave celularë apo mjeteve të dyshimta elektronike. Studenti që në provim përdor forma e mjete të palejueshme, përjashtohet nga provimi. Komisioni i provimit vë në dijeni drejtuesin e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, për të proceduar më tej në përputhje me Kodin e Etikës së KU IKT -së.</p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT</i></p> <p><i>Ev.10. Libri i Rregulloreve Institucionale- Kodi i Etikës</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev.16. Manual i Punimit te Tezes së Diplomës</i></p> <p><i>Ev.95. Guida e Studentit</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Proçesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët bëhet në përputhje me përcaktimet në Rregulloren e KU IKT dhe Rregulloren e programit të studimit. Në programin e lëndës shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor. Gjatë procesit të kontrollit stafi shënon pikët për çdo pyetje si dhe tregohet i kujdesshëm në ndarjen e pikëve të tezës. Tezat hartohen në mënyrë që të përfshijnë të gjithë informacionet e marra gjatë zhvillimit të lëndës/modulit.</p> <p>Përmes sistemit online UMS studenti informohet brenda afateve të përcaktuara të rregullores për rezultatet e provimit. Gjithashtu stafi akademik ka për detyrë të mos kërkojë dhe të mos pranojë në asnjë formë privilegje, përfitime, ndërhyrje, favorizime, pagesa apo dhurime, nga studentë apo persona të tjerë, që kanë për qëllim marrjen e rezultateve favorizuese, të pamërituara prej tyre apo favore e përfitime të tjera, të cilat anëtari i personelit mund t'i ketë për shkak të detyrës.</p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT</i></p> <p><i>Ev.10. Libri i Rregulloreve Institucionale- Kodi i Etikës</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev 21. Programet e lëndëve 2022 - 2023</i></p>

	<i>Ev.94. Foto evidenca te sistemit UMS</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	<p>GVJ konstatoi se institucioni ka dokumentacion të plotë që siguron garantimin e të drejtave të studentëve për tu njohur me vlerësimin, dhe kërkuar rishikim të vlerësimit bazuar në rregulloren dhe procedurat përkatëse.</p> <p>Studenti ka të drejtë të ankimojë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës. Ai mund t'i drejtojë një kërkesë me shkrim përgjegjësit të Departamentit dhe Dekanit ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Dekanati në bashkëpunim me Përgjegjësin e Departamentit ngre një komision i cili bën shqyrtimin e kërkesës dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë. Vlerësimi i komisionit mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar.</p> <p>Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës si dhe vendimi i marrë dokumentohet dhe arkivohet. Vlerësimi përfundimtar pasqyrohet në një procesverbal të ri të firmosur nga komisioni i cili i bashkëlidhet atij të mëparshmit si dhe pasqyrohet në sistemin elektronik UMS.</p>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	<p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev.15. Rregullore e Sekretarise cikli i dyte 2022-2023</i></p> <p><i>Ev.95. Guida e Studentit</i></p>
Konkluzione	<p><i>Proçesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët në programin e studimit Master i Shkencave në Marketing Digjital bëhet në përputhje me përcaktimet në Rregulloren e KU IKT dhe Rregulloren e Programit të studimit. Në programet e lëndëve shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor. GVJ konstatoi se institucioni ka dokumentacion të plotë që siguron garantimin e të drejtave të studentëve për tu njohur me vlerësimin, dhe kërkuar rishikim të vlerësimit.</i></p>


Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Marketing Digjital ka objektiva të caktuara për formimin e studentëve, të cilat përbëhen nga bashkësia e dijeve, aftësimeve e kompetencave profesionale në marketing, që studentët duhet të fitojnë në përfundim tij. Programi ofron njohuritë teorike dhe praktike të fushës së marketingut digjital duke u përshatur vazhdimisht me ndryshimet në mjedis. Studentët në përfundim për programit të studimit synohet të jetë pajisur me njohuri të përgjithshme mbi marketingun digjital; planifikimin e marketingut digjital; krijimin e strategjisë së marketingut digjital dhe studimin e tregut e sjelljes së konsumatorit.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Në planin mësimor të programit të studimit është respektuar ndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese dhe GVJ vlerëson se programi i studimit Master i Shkencave në Marketing Digjital i ofruar në gjuhën angleze garanton formimin dhe kualifikim e studentëve në fushën e marketingut të krahasueshme me diplomat që lëshojnë strukturat analoge universitare brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Nga shqyrtimi i kujdesshën i Planit mësimor dhe Programeve të Lëndëve, <i>GVJ rekomandon që lënda e formimit bazë “Financial Reporting Standarts” të zhvendoset në lëndët ndërdisiplinore të programit dhe Lëndët “Advanced Research Methods” dhe Communication Skills” të vendosen si lëndë të formimit bazë për këtë program studimit.</i></p> <p><i>Gjithashtu, dinamika e ndryshimeve teknologjike të kohëve të fundit sidomos përdorimi i Inteligjencës Artificiale (AI) e bën të nevojshme përditësimin e programit me tematikat si Strategjitë e Marketingut dhe Zbatimi i AI, Etika në marketing dhe AI; Përdorimi i Machine learning në marketing; Etj.</i></p>


	<p>Në funksion të programit të studimit dhe zhvillimin e aftësive kërkimore e teknologjike shërben dhe Qendra e Kërkimit Inovator dhe Zhvillimit, si një strukturë e veçantë që bashkërendon aktivitetet dhe stafet e njësive bazë për kërkim të aplikuar dhe punë eksperimentale. CIT HUB është konceptuar si një hapësirë ku studentët e stafi mund të ndërveprojnë, krijojnë ide të reja e zhvillojnë ato së bashku.</p> <p><i>Evidenca 4 Strategjia e RDC (Kërkim, Zhvillim dhe Krijimtari)</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev 21. Programet e lëndëve 2022 - 2023</i></p> <p><i>Evidenca 31 Raporti CIRD Ekonomi 2021-2022</i></p> <p><i>Ev. 75-76 Katalogu i veprimtarive 2020-2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Në fillim të çdo lënde/moduli, konkretisht në javën e parë të mësimit studentët informohen nga titullari i lëndës/modulit mbi programin e plotë të lëndës, objektivat, kompetencat dhe aftësitë që pritet të fitojë studenti gjatë zhvillimit të lëndës. . Në fund të modulit gjithashtu këto elementë shqyrtohen dhe analizohen përsëri për të vënë në dukje arritjet e studentëve dhe ku ata duhet të punojnë më shumë.</p> <p>Në javën e fundit të semestrit pedagogët realizojnë seanca konsultuese ku orientojnë studentët në lidhje me çështjet ku do të përqëndrohet përgatitja e studentëve për provimin përfundimtar. Gjatë seancës trajtohen konceptet kryesore, struktura e përgjithshme e tezës dhe udhëzime të tjera lidhur me natyrën e pyetjeve që do të përfshihen në provimin përfundimtar.</p> <p>KU IKT tregon vemendje lidhur me bashkëveprimin me studentët, si një proces periodik e i përhershëm që zhvillohet në të gjitha lëndët. Nga takimi me studentët, GVJ kuptoi se ata ndihen të lirë dhe të motivuar për të pyetur për çdo paqartësi lidhur me orët e leksionit/seminarit apo të kërkojnë këshillime për çdo ide të tyre për inovacion apo zhvillim të zgjidhjes së problemit.</p>

	<p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSC ne Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev 19. Plani mesimor i programit MSC. Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev 21. Programet e lëndëve 2022 - 2023</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Puna mësimore me studentët përfshin një larmi formash të mësimit dhe të kontrollit të dijeve. Këto forma parashikohen në programet e lëndëve dhe në rregulloren mësimore të programit të studimit. Format kryesore të punës mësimore janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> format e mësimit teorik e praktik, ku përfshihen: leksionet, seminarët, ushtrimet, konsultimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit, projekt – diplomat, etj.; <input type="checkbox"/> format e kontrollit të dijeve, ku përfshihen: bashkëbisedimet, mbrojtje e detyrave dhe/ose projekteve të kursit, mbrojtje e praktikave profesionale, provime të ndërmjetme, provimet e lëndës, provimet e formimit, mbrojtje e temave e diplomave, etj. <p>Nga takimi i GVJ me studentët dhe stafin akademik u konstatua se në çdo lëndë u jepet mundësi studentëve të zhvillojnë njohuritë e marra në projektet dhe rastet studimore. Përmes tyre studentëve u krijohet mundësi të përsosin të menduarin kritik dhe analizën në funksion të nevojave të tregut të punës. Detyrat e kursit u japin mundësinë studentëve të analizojnë një rast real me të dhëna të ofruara nga pedagogu apo dhe të dhëna të cilat mund të sigurohen nga vetë studentët, sipas udhëzimeve të pedagogut.</p> <p>Shpërndarja e ngarkesës së këtij programi studimi mes teorisë dhe praktikës është e balancuar 50% me 50%.</p> <p>Gjithashtu, për zhvillimin e njohurive dhe praktikave të studentëve shërben dhe Qendra e Inovacionit, Kërkimit dhe Zhvillimit (CIRD), panairët e punës, marrëveshjet me institucionet dhe bizneset, bashkëpunimet Erasmus, konferencat ndërkombëtare, dhe rrjeti Alumni. Të gjithë elementët e sipërpërmendur, i japin mundësi njësisë kryesore dhe bazë për</p>

	<p>të përmirësuar në vazhdimësi kompetencat e programit të studimit.</p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev 19. Plani mesimor i programit MSC. Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev 21. Programet e lëndëve 2022 – 2023</i></p> <p><i>Ev..26. Marreveshjet ne kuader te Erasmus+ 2016-2022</i></p> <p><i>Ev. 28. Marreveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione te tjera 2016 - 2022</i></p> <p><i>Ev. 31 Raporti CIRD Ekonomi 2021-2022</i></p> <p><i>Ev. 75-76 Katalogu i veprimtarive 2020-2022</i></p> <p><i>Ev. 81. Strategjia e Angazhimit te ALUMNI.</i></p> <p><i>Ev. 61. Certifikata trajnimesh te studenteve te IKT</i></p> <p><i>Ev. 68. Evidenca te organizimit te tryezave te rrumbullakta me kompanite, bizneset</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Nga njësia përgjegjëse e programit të studimit planifikohen orë të hapura dhe diskutimet mbi zhvillimet aktuale të teknologjisë e biznesit. Nga takimet në institucion, GVJ u njoh me aktivitetet e mbajtura si trajnime, konferenca studentore, leksione me të ftuar të industrisë dhe tryeza të rrumbullakëta. Përshkrimi i këtyre aktiviteteve është evidentuar në katalogun e veprimtarive 2020-2022. .</p> <p>GVJ vlerëson dhe inkurajon bashkëpunimet e KU IKT me Universitete e Institucione kombëtare dhe ndërkombëtare për adoptimin e zhvillimeve të reja të shkencës dhe ndërkombëtarizimin e programit të studimit.</p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev 19. Plani mesimor i programit MSC. Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev 21. Programet e lëndëve 2022 – 2023</i></p> <p><i>Ev..26. Marreveshjet ne kuader te Erasmus+ 2016-2022</i></p> <p><i>Ev. 28. Marreveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione te tjera 2016 - 2022</i></p>

	<p><i>Ev. 31 Raporti CIRD Ekonomi 2021-2022</i></p> <p><i>Ev. 68. Evidenca te organizimit te tryezave te rrumbullakta me kompanite, bizneset</i></p> <p><i>Ev. 61. Certifikata trajnimesh te studenteve te IKT</i></p> <p><i>Ev. 75-76 Katalogu i veprimtarive 2020-2022</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Institucioni ndjek një politikë të mbështetjes së ideve inovative dhe i promovon ato tek studentët. Në funksion të menaxhimit dhe përmirësimit të burimeve dhe infrastrukturës së kërkimit shkencor ka ngritur Qendren e Inovacionit, Kërkimit dhe Zhvillimit (CIRD) dhe mbështet financiarisht me grante për kërkimin shkencor për kërkuesit edhe studentët.</p> <p>KU IKT e ka pjesë të strategjisë kërkimore përfshirjen e studentëve në kërkime shkencore. Nga takimi me stafin, GVJ u njoh me angazhimin dhe nxitjen e studentëve në kërkim shkencor, në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare, dhe përfshirjen në projekte ndërkombëtare Erasmus. Konkretisht dy studente nga programi i studimit Master i Shkencave në Marketing Digjital janë angazhuar në një projekt European si pjesë e grupit të implementimit të projektit. Në ankesin 2 të RVB janë pasqyruar të gjithë aktivitetet studentore për nxitjen dhe zhvillimin e ideve notavore si HACKTECH, Stock Market Learning, konferenca studentore dhe projekte kërkim-zhvillimi.</p> <p><i>Aneksi 2 i RVB</i></p> <p><i>Ev 4. Strategjia e RDC (Kërkimit, Zhvillimit dhe Kretivitetit) 2014-2024.</i></p> <p><i>Ev. 31 Raporti CIRD Ekonomi 2021-2022</i></p> <p><i>Ev. 75-76 Katalogu i veprimtarive 2020-2022</i></p> <p><i>Ev. 61. Certifikata trajnimesh te studenteve te IKT</i></p> <p><i>Ev. 68. Evidenca te organizimit te tryezave te rrumbullakta me kompanite, bizneset</i></p> <p><i>Ev. 80. Revista Shkencore CIT Review Nentor 2021</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në planin mësimor të programit të studimit është respektuar ndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese dhe GVJ vlerëson</i></p>

	<p><i>se programi i studimit Master i Shkencave në Marketing Digjital i ofruar në gjuhën angleze garanton formimin dhe kualifikim e studentëve në fushën e marketingut të krahasueshme me diplomat që lëshojnë strukturat analoge universitare brenda dhe jashtë vendit.</i></p> <p><i>Nga shqyrtimi i Planit mësimor dhe Programeve të Lëndeve, GVJ rekomandon që lënda e formimit bazë "Financial Reporting Standarts" të zhvendoset në lëndët ndërdisiplinore të programit dhe Lëndët "Advanced Research Methods" dhe Communication Skills" të vendosen si lëndë të formimit bazë për këtë program studimit.</i></p> <p><i>Gjithashtu, dinamika e ndryshimeve teknologjike të kohëve të fundit sidomos përdorimi i Inteligjencës Artificiale (AI) e bën të nevojshme përditësimin e programit me tematikat si Strategjitë e Marketingut dhe Zbatimi i AI.</i></p> <p><i>Në funksion të zhvillimit të aftësive profesionale e shkencore tek studentët GVJ vlerëson dhe Qendrën e Kërkimit Inovator dhe Zhvillimit, si një strukturë e veçantë që bashkërendon aktivitetet dhe stafet e njëjësive bazë për kërkim të aplikuar dhe punë eksperimentale.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri I. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	KU IKT ka rregullore dhe procedura të miratuara për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Diploma lidhet ngushtë me tematikën që mbulon programi i studimit dhe është një punim i pavarur shkencor i studentit. Diploma zhvillohet në përputhje me kriteret dhe standartet e përcaktuara nga njësia dhe bëhen publike përmes Rregullores së Brendshme

	<p>të FE, Rregulloren e programit të studimit, Udhëzuesit të Diplomës.</p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT</i></p> <p><i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev.16. Manuali i Punimit të Tezes se Diplomes</i></p> <p><i>Ev.79. Model i percaktimit te temes se diplomes</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Gjatë takimit GVJ u informua se departamenti vë në dispozicion një grup pune të përbërë nga personeli i tij akademik me funksion koordinimin dhe mbështetjen e studentëve dhe pedagogeve për procesin e diplomimit. Studentëve ju mundësohet udhëzuesi për përgatitjen e Mikrotezës i cili përcakton rregullat e shkrimit, citimit dhe shkrimit të literaturës, përpunimit të tabelave dhe figurave, etj. Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen e temës sipas fushave të kërkimit që mbulon programi i studimit Master i Shkencave në Marketing Digjital. Gjithashtu studentët udhëzohen me seanca metodologjike sipas një kalendarit takimesh të përcaktuar nga pedagogët udhëheqës duke i ofruar udhëzime dhe materiale të nevojshme.</p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT</i></p> <p><i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev.16. Manuali i Punimit të Tezes se Diplomes</i></p> <p><i>Ev.79. Model i percaktimit te temes se diplomes</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të</p>	<p>Detyrimi përmbyllës i programit të studimit bëhet me punim diplome. Grupi i punës i përbërë nga koordinatori i programit dhe pedagogët udhëheqës për procesin e diplomimit orienton studentët në përcaktimin e temave të diplomave. Studentëve u vihet në dispozicion një listë me tema të sygjera të punimit të diplomës, të përgatitura nga stafi akademik në përputhje me fushat akademike dhe kërkimore të programit të studimit në Master i Shkencave në Marketing Digjital. Procedurat e</p>

<p>rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>mbrojtjes së diplomës përfshin një paraqitje të përmbledhjes së punimit të diplomës, dhe në vlerësimin e saj merren në konsideratë njohuritë dhe arritjet akademike të studentit gjatë ciklit të studimeve, vlerësimi nga udhëheqësi i mikrotezës, dhe vlerësimi i jurisë.</p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT</i> <i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise</i> <i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i> <i>Ev.16. Manuali i Punimit të Tezes se Diplomes</i> <i>Ev.79. Model i percaktimit te temes se diplomes</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>GVJ u njoh me procedurën e diplomimit të studentëve nga takimi me përgjegjësin e njësisë dhe stafin akademik. Studenti propozon pedagogun udhëheqës pasi ka marrë paraprakisht dhe aprovimin e këtij të fundit. Departamenti përmes koordinatorit të programit të studimit shqyrton propozimet e studentëve dhe temën dhe garanton që udhëheqësi të jetë në përputhje me fushën e programit të studimit. Përgjegjësi i departamentit miraton listën e temave dhe udhëheqësve shkencor. Studentët asistohen për përcaktimin e temave të diplomës dhe udhëzime të tjera mbi përmbajtjen e saj.</p> <p>Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë së saj akademike.</p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT</i> <i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise</i> <i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i> <i>Ev.16. Manuali i Punimit të Tezes se Diplomes</i> <i>Ev.79. Model i percaktimit te temes se diplomes</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo</p>	<p>KU IKT vë në dispozicion të studentëve 5 laboratorë dhe pajisjet që ata disponojnë për kryerjen e mbledhjes së të dhënave, analizave, si dhe asistencë në përgatitjen e prezantimit të punimeve. Tashmë në dispozicion të programit MSH Marketing Digjital është dhe Qendra e Inovacionit, Kërkimit</p>

<p>jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>dhe Zhvillimit (CIRD) për kryerjen e kërkimeve, simulive, demonstrimeve apo analizave të të dhënave për stafin dhe studentët.</p> <p>Gjithashtu, Hub-et digjitale të krijuara nga ky institucion ofrojnë një hapësirë shtesë për studentët. Kështu, HUB innovation centre në CIT me nën programe si ITI Incubator & CITI Accelerator CITI Coëorking CITI Masterclass, CITI Entrepreneurs Club. CITI Mentor & Trainers Club. CITI Investors vë në dukje kapacitete laboratorike.</p> <p>https://cit-hub.al/about-us/</p> <p><i>Ev 4. Strategjia e RDC (Kerkimit, Zhvillimit dhe Kretivitetit) 2014-2024.</i></p> <p><i>Ev. 31 Raporti CIRD Ekonomi 2021-2022</i></p> <p><i>Ev. 86. Raport Inventari i KU IKT, 31.12.2022</i></p> <p><i>Ev. 52. Te dhena mbi biblioteken OREILLY-TEXO per CIT</i></p> <p><i>Evidencë 40. Planimetritë</i></p> <p><i>Evidencë Aneksi 1 i RVB</i></p> <p><i>Tabela 16.2 RVB</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Sipas Rregullores Insitucionale mbi Punimin e Diplomës dhe Rregullores së Programit të Studimit, mbrojtja e diplomës bëhet me gojë dhe studenti vlerësohet me notë sipas komisionit të vlerësimit për mbrojtjen e diplomave. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 3 anëtare dhe vlerësimi është unanimit, por i bazuar dhe në vlerësimin e udhëheqësit. Mesatarja e vlerësimeve të anëtarëve të komisionit të provimit konvertohet në notë.</p> <p>Në përfundim të mbrojtjes së punimeve të diplomave, kryetari i komisionit, në prani të anëtarëve, i komunikon çdo studentit notën me të cilën është vlerësuar punimi i tij. Në rast se studenti vlerësohet me notë negative në mbrojtjen që i bën punimit të tij, ai mund të ri-mbrojë të njëjtin punim ose të mbrojë një punim të ri, në një afat kohor i cili përcaktohet në rregulloren e programit të studimit, pa tejkaluar afatin maksimal të përcaktuar në kornizën ligjore në fuqi.</p>

	<p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT</i></p> <p><i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Diplomat për ciklin të dytë shoqërohen me suplementin e diplomës i cili hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës europiane të arsimit të lartë. Përmbajtja dhe forma e diplomës është e përcaktuar në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Diploma për të diplomuarit e parë të programit të studimit MSH në Marketing Digjital do të regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe regjistrin shtetëror të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve të Arsimit. Në përfundim të studimeve studenti ka të drejtë të kërkojë të marrë një kopje zyrtare të syllabuseve të programit të studimit të zhvilluar.</p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT</i></p> <p><i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se dokumentacioni i studentit ruhet në sekretarinë mësimore. GVJ vizitoi nga afër arkivin e sekretarisë mësimore ku verifikoi dosje të studentit, regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe vlerësoi angazhimin e institucionit në këtë drejtim. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacioni të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Në përmbushje të detyrimeve institucionale, informacioni mbi studentët paraqitet rast pas rasti dhe jepet për palët e interesuara apo institucionet përkatëse në përputhje me parashikime ligjore dhe përcaktimet në aktet e brendshme rregullatore.</p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT</i></p> <p><i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev.15. Rregullore e Sekretarise cikli i dyte 2022-2023</i></p>

Konkluzione	<i>GVJ konstaton se KU IKT ka rregullore dhe procedura të miratuara për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e zhvillimit dhe mbrojtjes së diplomës.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	<p>Nga vizita në IAL dhe shqyrtimi i dokumentacionit, klasat dhe laboratorët, janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e praktikës mësimore. CIT ka në funksion të mësimdhënies 5 laboratorë, prej të cilëve 2 laboratorë janë në përdorim nga studentët e programit të studimit Msc në Marketing Digjital të pajisura secili me 45 poste+1 videoprojektor dhe programe të certifikuara nga Microsoft. Përpos laboratoreve kompjuterike, Hub-et digjitale të krijuara nga ky institucion ofrojnë një hapësirë shtesë për studentët. HUB innovation centre në CIT me nën programe si ITI Incubator & CITI Accelerator CITI Coworking CITI Masterclass, CITI Entrepreneurs Club. CITI Mentor & Trainers Club. CITI Investors, janë element që vënë në dukje kapacitetet laboratorike.</p> <p><i>Evidencë Aneksi 1 Tabela 16.2</i></p> <p><i>Evidencë 40. Planimetritë</i></p> <p><i>Evidencë 86. Raport Inventari i KU IKT, 31.12.2022</i></p>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim	<p>KU IKT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me shumë struktura shtetërore dhe private. Në çdo marrëveshje bëhen të qarta format e bashkëpunimit dhe përgjegjësitë e secilës pale si dhe përcaktohen përgjegjësitë e punëdhënësve për realizimin praktikës profesionale nga studentët. Praktikrat janë të rëndësishme jo vetëm për zhvillimin e shprehive praktike, por edhe për të rritur bashkëpunimin në fushën e kërkimit shkencor.</p>

(KOP)

[Signature]

<p>përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Bashkëveprimi në rritje midis strukturave të KU-IKT dhe industrisë vërtetohet dhe nga aktivitetet e ndërmarra, pjesë e të cilave kanë qenë dhe studentët.</p> <p><i>Ev. 28. Marreveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione te tjera 2016 - 2022</i></p> <p><i>Ev.30. Raporti Institucional Vjetor i KU IKT per vitin akademik 2021-2022 shqip</i></p> <p><i>Ev. 31 Raporti CIRD Ekonomi 2021-2022</i></p> <p><i>Ev. 68. Evidenca te organizimit te tryezave te rrumbullakta me kompanite, bizneset</i></p> <p><i>Ev. 61. Certifikata trajnimesh te studenteve te IKT</i></p> <p><i>Ev. 75-76 Katalogu i veprimtarive 2020-2022</i></p> <p><i>Ev. 86. Raport Inventari i KU IKT, 31.12.2022</i></p> <p><i>Ev. Aneksi 1 RVB</i></p> <p><i>Ev. Aneksi 2 RVB</i></p>
<p>Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Program i studimit “Master i shkencave në Marketing Digjital” zhvillohet në përputhje me Strategjinë Kombëtare duke respektuar vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018. “Për Elementët e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Për më tepër, i është dhënë një hapësirë më e madhe në planin mësimor, veprimtarive praktike duke iu përgjigjur në këtë mënyrë standardeve ligjore të udhëzimit Nr. 41. Praktika mësimore vlerësohet me 12 ECTS dhe u jep mundësi studentëve të hetojnë terrenin dhe të përfitojnë nga të dhënat konkrete për të hartuar punimin e tyre të diplomës, duke integruar teorinë, kërkimin shkencor dhe praktikën. Marrëveshjet e praktikave janë ngritur në nivel Universiteti. Studentët kryejnë praktika profesionale të mbikëqyrura nga profesionistë të fushës në institucionet publike e private të paraqitura në evidencën 28.</p> <p><i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev 19. Plani mesimor i programit MSC. Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev. 28. Marreveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione te tjera 2016 - 2022</i></p>

4.1.3

	<p><i>Ev.30. Raporti Institucional Vjetor i KU IKT per vitin akademik 2021-2022 shqip</i></p> <p><i>Ev. 68. Evidenca te organizimit te tryezave te rrumbullakta me kompanite, bizneset</i></p> <p><i>Ev. 61. Certifikata trajnimesh te studenteve te IKT</i></p> <p><i>Ev. 75-76 Katalogu i veprimtarive 2020-2022</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Program i studimit "Master i shkencave në Marketing Digjital" zhvillohet në përputhje me Strategjinë Kombëtare duke respektuar vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018. "Për Elementët e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë". Praktika mësimore vlerësohet me 12 ECTS dhe u jep mundësi studentëve të hetojnë terrenin dhe të përfitojnë nga të dhënat konkrete për të hartuar punimin e tyre të diplomës, duke integruar teorinë, kërkimin shkencor dhe praktikën.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të	Bazuar në dokumentacionin shoqërues të dosjes së vetëvlerësimit (RVB) dhe informacionin e marrë në takimet e realizuara gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se institucioni mban të dhëna të plota mbi personelin e angazhuar në këtë program studimi, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Referuar (*Referenca Tabela 6.1 - 6.2, Tabela përmbledhëse RVB*), të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë dy viteve akademike paraqiten si vijon:

Për vitin akademik **2021-2022** janë të angazhuar **8** pedagogë:

- 7 PAE, nga të cilët 2 të kategorisë “Prof.As” dhe 5 me gradën “Doktor”,
- 1 PAK, me gradën “Doktor”.

Mbulimi i programit në përqindje për këtë vit akademik është **87.5% nga PAE.**

Për vitin akademik **2022-2023** janë të angazhuar **13** pedagogë:

- 11 PAE , nga të cilët 1 i kategorisë “Prof.As” dhe 10 me gradën “Doktor”,
- 2 PAK, nga të cilët 1 i kategorisë “Profesor” dhe 1 me gradën “Doktor”.

Mbulimi i programit në përqindje për këtë vit akademik është **85% nga PAE.**

Njësia bazë, Departamenti i Administrim Biznesit përgjegjës për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Nga vlerësimi i CV-ve të stafit të angazhuar në këtë program studimi vihet re cilësia e stafit akademik në tregues si :

1. Pjesëmarrja në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare;
2. Pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare;
3. Pjesëmarrja në mobilitete teaching;
4. Pjesëmarrja në trajnime të ndryshme që lidhen me tematikat që mbulojnë në këtë program studimi;
5. Eksperiencia jashtë auditorit për vite me rradhë në organizatat e biznesit mundëson përçim të elementëve praktikë te studentët;

Gjithashtu kryerja e një cikli studimesh jashtë vendit për një pjesë të stafit është një element shtesë për përmbushjen e cilësisë së stafit të angazhuar në këtë program studimi. GVJ vlerëson që të gjithë këto tregues influencojnë pozitivisht në cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në departamentin përgjegjës për ofrimin e programit të studimit.

	<p><i>Evidencë 22. CV e stafit akademik te angazhuar ne programin e studimit.</i></p> <p><i>Evidencë Tabela nr. 19: Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit (RVB)</i></p> <p><i>Tabela nr. 20: Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (RVB)</i></p>															
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit (<i>Referenca Tabela 12.1 - 122, Tabela përmbledhëse RVB</i>), u konstatua se ngarkesa mësimore e personelit akademik për dy vite akademike është si më poshtë vijon:</p> <table border="1" data-bbox="600 703 1374 922"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Total orësh</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2021-2022</td> <td>600</td> <td>540</td> <td>60</td> <td>90% / 10%</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>902</td> <td>782</td> <td>120</td> <td>86% / 14%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga tabela rezulton që për 2 vite akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar me <u>mbi</u> 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 ku citohet: “Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për cdo program studimi”, në përputhje me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit.</p> <p><i>Evidencë Tabela 4 Ngarkesa totale e stafit të angazhuar në programin e studimit Master Shkencor në m, Marketing Digjital</i></p>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2021-2022	600	540	60	90% / 10%	2022-2023	902	782	120	86% / 14%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)												
2021-2022	600	540	60	90% / 10%												
2022-2023	902	782	120	86% / 14%												
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Institucioni ka angazhuar staf akademik PAE dhe PAK për të plotësuar kërkesat e programit, të cilët kanë përgatitjen profesionale në fusha të ndryshme dhe të angazhuar në mësimdhënie të lëndëve që përputhen me fushat e tyre të kërkimit shkencor. Nga analiza e CV të stafit, tabelave të ngarkesës si dhe moshës e personelit të angazhuar, GVJ vlerëson që ky kriter plotësohet. Nga takimi me stafin u evidentua ndjesia e përkatësisë me institucionin e cila lidhet dhe me angazhimin në punë dhe për rrjedhojë cilësinë.</p> <p><i>Evidencë 22. CV e stafit akademik te angazhuar ne programin e studimit.</i></p> <p><i>Evidencë Tabela nr. 19: Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit (RVB)</i></p>															




	<i>Tabela nr. 20: Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (RVB)</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>KU-IKT, në përputhje me aktet e veta rregullatore (<i>17. Manuali i Stafit Akademik Tetor 2021 eng</i>) ka të përcaktuara procedurat e rekrutimit të personelit akademik, jo akademik si dhe personelit ndihmës administrativ. Në bazë të dokumentacionit si edhe në vizitën që GVJ pati në IAL evidentohet rruga dhe procedurat që ndiqen për punësimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik. Departamenti bën planifikimin për staf akademik bazuar në nevojën dhe mbingarkesën e stafit aktual.</p> <p>Pasi kërkesa miratohet, nga Fakulteti ajo publikohet në faqen e internetit të institucionit. Çdo kandidaturë për pozicionet e hapura vlerësohet nga një Komision ad-hoc. Komisioni i Rekrutimit përbëhet kryesisht nga nga:Zv.Rektori, Drejtuesi i Zyrës së Burimeve Njerëzore, Dekani, Përgjegjësi i Departamentit përkatës dhe sipas rastit pedagogë, si dhe ekspertë të fushave përkatëse nga jashtë CIT dhe/ose studentë nga Qeveria Studentore.</p> <p><i>Evidencë 17. Manuali i Stafit Akademik Tetor 2021 eng</i></p> <p><i>Evidencë 10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i></p>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	<p>Për programin e studimit MSH Marketing Digjital, departamenti i AB&IT angazhon staf ndihmës, laborantë, 5 syresh, të vëna në dispozicion për nevojat e Fakultetit Ekonomik. Nga vizita në IAL u evidentuan dy laborator me poste kompjuterike (45 secila+1 video projektor) të cilat janë në dispozicion të studentëve nga ora 9-21. Stafit i angazhuar ka kualifikimin e nevojshëm dhe është në dispozicion të nevojave të studentëve.</p> <p><i>Vizita në IAL</i></p> <p><i>RVB Master Shkencor në Marketing Digjital (Tabela 16,2)</i></p>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore funksionon në nivel IAL-je. Zyra e Burimeve njerëzore, mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik dhe ndihmës akademik. Nga shqyrtimi i 4 dosjeve, 2 për vitin 2021-2022 dhe 2 për vitin 2023-2024, respektivisht nga një PAE/PAK nuk u vu re asnjë parregullsi. Po</p>

<p>përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>kështu, kjo zyrë menaxhonte edhe marrëdhëniet me pedagogët e huaj të ftuar si psh pajisjen e këtyre të fundit me lejeqëndrim.</p> <p><i>Evidencë Takimi me stafin e Burimeve Njerëzore</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>KU-IKT-FE-DA&IT ka vendosur marrëveshje e bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, si dhe përfaqësues të biznesit privat, sektorit publik, sektori financiar etj. IAL paraqet një listë shteruese jo vetëm të kontakteve të tyre por edhe objektivat specifike për secilën marrëveshje (<i>Tabela 5 RVB Master Shkencor Marketing Digjital</i>). Përsa i përket praktikës, IAL i pajis studentët me manualin e praktikës. Ky manual shërben për të informuar të gjithë palët e interesuara. Për mbikëqyrjen, udhëheqjen dhe keshillimin e studentëve në praktikën profesionale, departamenti vë në dispozicion pedagogë, të brendshëm apo jashtëm, me ekspertizën përkatëse për t'i ardhur në ndihmë studentëve. Në manual paraqitet forma e aplikimit të praktikës, raport vetëvlerësimi rreth praktikës i cili plotësohet nga studenti dhe të prezantohet si një intervistë nga mbikëqyrësi i studentit – përbën 30% e notës përfundimtare). Forma e vlerësimit nga pedagogu mbikëqyrës i praktikës (70% e notës përfundimtare).</p> <p>Po kështu IAL pajis studentët edhe me manualin e punimit të diplomës në të cilin paraqiten të gjithë elementët në lidhje me udhëheqjen dhe aspektet të përmbajtjes nga ana formale. Nga takimi me studentë u konfirmua se vlerësimi bëhej mbi bazën e kriterëve të paraqitura nga pedagogu udhëheqës.</p> <p><i>Evidencë 87. Manuali i Praktikes Mesimore Master FE shqip</i> <i>Evidenxe 16. Manuali i Punimit të Tezes se Diplomes shqip.pdf</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në</p>	<p>Marrëveshja me punëdhënësit pranë të cilëve studenti ndjek praktikën, parashikon që punëdhënësi të bëjë një vlerësim të ndjekjes dhe angazhimit së studentit. Ai vlerëson nëse studenti ka permbushur objektivat e synuar gjatë periudhës së praktikës mësimore. Vlerësimi i studentit gjatë praktikës është objekt analize edhe nga pedagogët përgjegjës të caktuar nga departamenti. Në fund të praktikës profesionale, studenti</p>

përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	përgatit një raport ku paraqet arritjet dhe njohuritë e fituara gjatë praktikës.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që personeli PAE/PAK dhe ai ndihmës përbush standardet sasiore dhe cilësore në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>IAL plotëson kushtet për të zhvilluar veprimtaritë mësimore në përputhje me aktet ligjore. Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit vlerësohet se KU-IKT, e zhvillon aktivitetin në një sipërfaqe totale prej 2715 m². Prej tyre, 2385 m² janë objekte në shërbim të procesit mësimor. Nga këto 854m² janë në dispozicion të Fakultetit Ekonomik. Nga 6 klasa me një sipërfaqje prej 331m², 3 klasa me sipërfaqe totale prej 168 m² janë në funksion të zhvillimit të leksioneve dhe seminareve në shërbim të programit të studimit Master Shkencor në Marketing Digjital (<i>Evidencë Tabela 16.2 RVB</i>). Plotësimin e standardeve ligjore e konfirmon edhe Raporti i Grupit të Punës për verifikimin e standardeve dhe normat e infrastrukturës Nr. Prot. 3381/7, datë 28.07.2020.</p> <p><i>Evidencë 40. Planimetritë</i> <i>Evidencë 41. Kontrata e Qirase</i></p>

	<p><i>Evidencë 42. Raporti i Grupit te Punes per Verifikimin e Standardeve dhe Normativave te Infrastruktures nga MASR</i></p> <p><i>Evidencë 43. Akti kunder Zjarrit Nr. Prot. C-10325.1, 24.05.2021.</i></p> <p><i>Evidencë 44. Akti Higjiene Sanitar 171, date 24.05.2021</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita në IAL dhe shqyrtimi i dokumentacionit, klasat dhe laboratorët, janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Fakulteti ekonomik dhe departamentet e tij, ndër të tjerë edhe Departamenti i Administrim Biznesi dhe Teknologjisë së Informacionit përdorin sallën e konferencave, e cila ka një sipërfaqe prej 200 m², me kapacitet 170-180 vende. Ndërkohë, në funksion të programit të studimit në shqyrtim, janë vënë në dispozicion 2 laboratore kompjuterike të pajisuara me 45 poste+1 videoprojektor. Laboratorët mund të aksesohen nga studentët në hapësirën kohore 9am-9pm.</p> <p><i>Evidencë Tabela 16.2 RVB</i></p> <p><i>Vizita ne IAL</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Si u përmend edhe më lart IAL disponon të gjitha aparaturat dhe mjetet e nevojshme për zhvillimin normal të mësimin në funksione të arritjes së objektivave të studimit. Përpos, pajisjes me kushtet bazë si auditore dhe laboratore kompjuterike, Hub-et digjitale të krijuara nga ky institucion ofrojnë një hapësirë shtesë për studentët. Kështu, HUB innovation centre në CIT me nën programe si ITI Incubator & CITI Accelerator CITI Coëorking CITI Masterclass, CITI Entrepreneurs Club. CITI Mentor & Trainers Club. CITI Investors, janë një tjetër element që vë në dukje disponibilitetin e kapaciteteve laboratorike.</p> <p>https://cit-hub.al/about-us/</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ vlerëson që vet natyra e IAL dhe fokusi i programit të studimit e bën shumë të nevojshëm praninë e laboratoreve. Si u theksua dhe më lart ky kriter plotësohet pasi nga 5 laboratorë në CIT, 2 laboratorë janë në përdorim nga studentët e programit të studimit Msc në Marketing Digjital.</p> <p><i>Evidencë Tabela 16.2 RVB</i></p> <p><i>Vizita ne IAL</i></p>

<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit vlerësohet se KU-IKT, garanton kapacitetet si dhe ka një sërë marrëveshesh me palët e treta për zhvillimin e praktikës mësimore (<i>Evidencë 27. Marrëveshjet me universitetet 2016 – 2022, Evidencë 28. Marrëveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione te tjera 2016 – 2022</i>). Në një raport gjithëpërfshirës të dorëzuar pranë ASCAL, IAL paraqet të gjithë bizneset, përfaqësues të sektorit bankar si dhe institucione të ndryshme ku studentët mund të zhvillojnë praktikën mësimore. Po kështu, Hub-et digjitale të krijuara nga ky institucion ofrojnë një hapësirë shtesë ku studentët mund të zhvillojnë praktikën.</p> <p><i>Evidencë 27. Marrëveshjet me universitetet 2016 – 2022,</i> <i>Evidencë 28. Marrëveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione te tjera 2016 – 2022</i> https://cit-hub.al/about-us/</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që IAL vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik. Si u përmend edhe më sipër CIT-HUB ofron mundësi shtesë për zhvillimin e praktikës mësimore në përputhje me natyrën e programit të studimit Marketing Digjital.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.3</p>	
<p>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në</p>	<p>Fakulteti Ekonomik, Departamenti i Administrimit të Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit, në të gjitha programet e studimit dhe konkretisht për programin e studimit në Msc</p>




<p>gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Marketing Digjital vë në dispozicion të studentëve literaturë të detyrueshme dhe të rekomanduar për secilën lëndë. Aktualisht, IAL vë në dispozicion për këtë program studimi, 76 tituj libra (kopje fizike) nga të cilat 41 tituj për programin në vlerësim. Po kështu nga marrëveshja me shtëpinë botuese McGraëHill Education, me të cilën IAL ka nënshkruar (marrëveshje e cila është e vlefshme deri në nëntor 2024) ofron mundësi për përditësim të vazhdueshëm të literaturës. Studentët që ndjekin programin e studimit Msc në Marketing Digjital kanë në dispozicion 346 tituj librash virtualisht nga shtëpia botuese McGraëHill dhe 598 libra nga O'Reilly's Virtual. Gjithashtu, për programin Master Shkencor në Marketing Dixhital, Fakulteti i Ekonomisë ofron një literaturë të pasur virtuale dhe fizike e cila përbëhet nga 5906 tituj.</p> <p><i>Evidencë 51. Te dhena mbështetese per biblioteken, blerjen e librave ne vitet e fundit.</i></p> <p><i>Evidencë 52. Te dhena mbi biblioteken OREILLY-TEXO per CIT</i></p> <p><i>Evidencë 54. Marreveshje CIT - McGraëHill Education (Eng).pdf</i></p> <p><i>Evidencë tabela 25 dhe 26 në aneksin 1 RVB,</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, kryesisht syllabuset e lëndëve, GVJ vlerëson që njësia përgjegjëse kujdeset që literatura të përditësohet pasi vet natyra e programit me ndryshime të theksuara e ka të nevojshëm këtë aspekt. Literatura virtuale dhe marrëveshjet e përmendura më sipër janë një element që siguron garantimin e këtij kriteri.</p> <p><i>Evidencë 21. Programet e lendeve 2021 – 2022</i></p> <p><i>Evidencë 21. Programet e lendeve 2022 - 2023.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 52. Te dhena mbi biblioteken OREILLY-TEXO per CIT</i></p> <p><i>Evidencë 54. Marreveshje CIT - McGraëHill Education (Eng).pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të</p>	<p>Nga vlerësimi i dokumentacionit GVJ, vlerëson që ky kriter plotësohet, studentët që ndjekin programin e studimit Marketing Digjital kanë mundësi shfrytësimi të bibliotekës dhe një hapësirë të dedikuar me titujt që lidhen me lëndët e programit të studimit. Studentët kanë mundësi të konsultojnë libra fizikisht por edhe virtualisht. Materialet e McGraëHill pajisin studentët me video,</p>




barabartë nga studentët e programit të studimit.	kuize si edhe elementë të tjerë praktikë që lidhen me lëndë specifike. <i>(Visita në Ial)</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nga vlerësimi i dokumentacionit GVJ, vlerëson që biblioteka fizike dhe virtuale janë të pajisura me një fond të pasur librash në të gjitha fushat e ekonomisë si dhe në fushat ku është përqendruar veprimtaria studimore e Fakultetit Ekonomik. Titujt janë zgjedhur në përputhje me nevojat dhe kërkesat e studentëve dhe pedagogëve. Në fushën e ekonomisë, biblioteka ofron një literaturë të gjerë e cila përfshin: - 1311 libra fizikë - 2855 libra (online) nga McGraëHill Education - 20261 libra (online) nga O'Reilly. Biblioteka ka hapësirën e saj Fizike dhe Virtuale, e cila është krijuar dhe përshtatur, bazuar në nevojat e studentëve dhe stafit akademik.
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Studentët e CIT kanë të siguruar aksesin në bibliotekën virtuale pa pagesë. Pasi kanë krijuar kredencialet e tyre në universitet ata kanë mundësi të hyjnë nga kompjuteri apo telefoni i tyre në çdo kohë <i>(Takimi me stafin)</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Nga vizita në IAL u evidentua se biblioteka ndodhet në katin e dytë dhe ka një sipërfaqe prej 90 m ² me një kapacitet prej 20 vendesh, nga të cilat 6 janë të pajisura me kompjuter. Orari i bibliotekës është i përshtatur për nevojat e studentëve. Gjatë javës biblioteka është e hapur në oraret, 09:00 - 13:00 dhe 14:00 - 21:00 ndërsa të shtunën 08:00 - 15:00. Fondi i librave është një 'fond i hapur', që do të thotë se studenti ka mundësinë të përzgjedhë vetë librat në raftë, të renditur sipas Sistemit Decimal (Vizita në IAL). Kjo e bën edhe më të lehtë përdorimin e librave dhe revistave. IAL ka vënë në dispozicion, marrëveshjet, fondin e librave fizike e virtuale, blerjet në 6 vitet e fundit si dhe fushën përkatëse. <i>Evidencë 51. Te dhena mbështetese per biblioteken, blerjen e librave ne vitet e fundit.</i>




	<p><i>Evidencë 52. Te dhena mbi biblioteken OREILLY-TEXO per CIT</i></p> <p><i>Evidencë 53. Marreveshja CIT - Agjencia e Abonimit te Shtypit 15.09.2021</i></p> <p><i>Evidencë 54. Marreveshje CIT - McGrawHill Education (Eng)</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Orari i bibliotekës është i përshtatur për nevojat e studentëve. Gjatë javës biblioteka është e hapur në oraret, 09:00 - 13:00 dhe 14:00 - 21:00 ndërsa të shtunën 08:00 - 15:00. Ky orar i jep mundësi studentëve të konsultojnë libra si gjatë procesit mësimor edhe jashtë orarit të tij.</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Nga vlerësimi i dokumentacionit, IAL bën në funksion të marrëveshjeve që ka me shtëpitë botuese të lartpërmendura një vlerësim të numrit të studentëve që aksesojnë online librat që lidhen me literaturën e tyre të rekomanduar dhe asaj të detyrueshme. IAL dokumenton gjithashtu edhe procesin e kërkesës vjetore që paraqet njësia bazë për libra. Po kështu akses online në libraritë virtuale i jep mundësinë stafit akademik të përditësojë literaturën sipas kërkesave ligjore por edhe në bazë të nevojave që ka secila lëndë.</p> <p><i>Evidencë 51. Te dhena mbështetese per biblioteken, blerjen e librave ne vitet e fundit.</i></p> <p><i>Evidencë 52. Te dhena mbi biblioteken OREILLY-TEXO per CIT</i></p> <p><i>Evidencë 53. Marreveshja CIT - Agjencia e Abonimit te Shtypit 15.09.2021</i></p> <p><i>Evidencë 54. Marreveshje CIT - McGrawHill Education (Eng)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerwson qw programi i studimit përmban literaturën e nevojshme, të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën dhe mjediset të posaçme për inovacionin. GVJ vlerëson gjithashtu si</i></p>

	<i>pozitive aksesin në biblioteka online dhe numrin e madh të titujve.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” që prej vitit 2016 është pajisur me sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit (UMS). Sistemi aksesohet në kohë reale nga studentët dhe palët e tjera të interesuara ngë universitet si sekretaria, stafi pedagogjik etj. Studentët në fillim të vitit pajisen me kredencialet dhe mund të aksesojnë nëpërmjet tyre, informacionet që lidhen me vlerësimet e lëndëve, mungesat etj. Studentët dhe stafi hyjnë në sistemin UMS përmes faqes së internetit në kategorinë My CIT: https://cit.edu.al/my-cit <i>Evidencë 83. Raport i gjeneruar prej sistemit UMS per programet e studimit, nr. e studenteve, kalueshmerine, ngeljen</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Në fillim të vitit akademik, pasi studentët regjistrohen në programin e studimit përkatës, stafi i IT-së vendos në shërbim të tyre një adresë të personalizuar me emrin dhe mbiemrin e studentit, në mënyrë që ai të identifikohet në sistemin online. E njëjta procedurë ndiqet edhe për stafin pedagogjik që fillon punën në IKT. Po kështu, ndërveprimi ndërmjet IAL dhe studentit bëhet përmes komunikimit me e-mail dhe studenti ka mundësinë të përdorë nëpërmjet mailit të tij: Bibliotekën online, literaturën mësimore dhe Klasën Virtuale në google classroom e cila është e integruar në UMS. Si u përmend edhe më lart, në këtë sistem kanë akses stafi akademik i cili publikon vlerësimet sipas lëndëve dhe grupeve po kështu edhe sekretaria. Sistemi përdoret edhe nga sekretaria për të gjeneruar informacione të ndryshme të kërkuara nga amministrimi i IAL.

	<p><i>Evidencë 83. Raport i gjeneruar prej sistemit UMS per programet e studimit, nr. e studenteve, kalueshmerine, ngeljen Vizita në IAL</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Të gjitha modulet e programit të studimit regjistrohen në UMS dhe në përputhje me syllabuset ndahet paraprakisht vlerësimi i studentëve. Në këto kushte të gjithë pedagogët dhe studentët kanë akses dhe marrin informacion për vlerësimin e vazhduar edhe atë përfundimtar.</p> <p><i>Evidencë 94. Foto evidenca te sistemit UMS.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Si u përmend më sipër, nga konsultimi i dokumentacionit, IAL integron platforma online si google classroom për të vendosur një komunikim interaktiv me studentet. Ndërkohë është përmendur gjerësisht më lart që nga vetë natyra e programit të studimit në shqyrtim përpos sistemit të informacionit të integruar, studentët marrin dhe shkëmbejnë informacion edhe nëpërmjet CIT-HUB. Po kështu website i IAL përditësohet në mënyrë të vazhdueshme duke iu ofruar studentëve dhe të interesuarve të informohen në kohë reale për ofertën akademike të KU-IKT, stafin pedagogjik, mundësitë e trajnimeve, praktikave, ato zhvilluese të lidhura ngushtë me teknologjinë nëpërmjet Hub-eve etj.</p> <p>https://sq.cit.edu.al/programet-e-cit/</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit aksesohet dhe monitorohet në kohë reale dhe gjeneron raporte të përmbledhura për organet drejtuese. Informacionet aksesohen në domaine të vecanta nga ana e studentëve, stafit akademik sekretarisë etj.</p> <p><i>Evidencë 83. Raport i gjeneruar prej sistemit UMS per programet e studimit, nr. e studenteve, kalueshmërinë, ngeljen Vizita në IAL</i></p> <p><i>Evidencë 94. Foto evidenca te sistemit UMS.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në</p>	<p>KU-IKT, ka të shfaqur informacione të detajuara në lidhje me programin e studimit (https://sq.cit.edu.al/programet-e-cit/) në gjuhën shqipe edhe atë angleze. Po kështu në faqen e internetit janë të publikuara edhe shumë informacione të tjera që lidhen</p>

faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	me jetën studentore, garantimin e cilësisë si dhe pjesëmarrjen në aktivitetet shkencore. https://sq.cit.edu.al/programet-e-cit/		
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që IAL i përmbush kriteret e këtij standardi pasi është pajisur me një system informacioni të aksesueshëm për të gjitha palët e interesuara si dhe ka integruar platform online për një komunikim me interaktive. Shkëmbimi i informacionit bëhet në kohë reale duke mundësuar një shërbim cilësor dhe transparent</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ vlerëson që IAL harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit Msc në Marketing Digjital. Burimet kryesore financiare bazohen në 1. Tarifat e studimit të paguara nga studentët; 2. Shërbime trajnuese; 3. Donacione të ndryshme dhe 4. Projektet. <i>Evidencë 55. Plani i financimit të Fakultetit të Ekonomisë dhe departamenteve 2019-2025.pdf</i>

<p>Kriteri 2.Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Në Evidencën 55. Plani i financimit të Fakultetit të Ekonomisë dhe departamenteve 2019-2025.pdf detajohen burimet e financimit të programit të studimit si dhe shpenzimet për pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore për stafin e angazhuar në këtë program studimi, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, shpenzime të tjera, investime, shpenzime për kërkimin shkencor si dhe shpenzimet për konferencat.</p> <p>Për vitin 2022-2023, 50% e të ardhurave të Fakultetit Ekonomik vijnë nga programet e studimit të Departamentit të Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni. Po kështu rreth 45% e shpenzimeve shkojnë për këtë njësi bazë në IAL. Plani i financimit për njësinë bazë BA&IT ku ofrohet programi i studimit MSc në Marketing Digjital është i paraqitur edhe për vitin 2021-2022.</p> <p><i>Evidencë 55. Plani i financimit të Fakultetit të Ekonomisë dhe departamenteve 2019-2025.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>KU-IKT kryen auditim periodik të jashtëm për të vlerësuar gjendjen e tij financiare.</p> <p><i>Evidence 56. Raport i Auditit te Jashtem per institucionin - i pavarur.PDF</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Në rregulloren financiare të institucionit paraqiten detyrat e zyrës së financës dhe politika financiar e IAL, në drejtim të raportimit, transparencës dhe informimit të palëve të interesit. Në fund të çdo viti, institucioni analizon dhe miraton Raportin Vjetor, një kopje e të cilit i dërgohet edhe MASR-it. Në këtë raport pasqyrohen zërat financiarë të cilët diskutohen në Senatin Akademi dhe në Bordin e Administrimit.</p> <p><i>Evidencë 70. Vendim BA nr. 1 - Struktura e Pagave 29.05.2020</i> <i>Evidencë 71. Vendim nr.3 BA per tarifat e studimit 2023-2024</i></p>

	<i>Evidencë 72. Vendim BA nr. 4 Rregullore Financiare 29.05.2020.</i>		
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Referuar dokumentacionit për të ardhurat dhe shpenzimet e Fakultetit Ekonomik, dëshmohet qëndrueshmëri financiare. Lloji i programeve të studimit, që ofron njësi bazë është një element pozitiv që mund të sigurojë qëndrueshmërinë edhe në të ardhmen. Programi i studimit në vlerësim Msc Marketing Digjital tregon një përpjekje të tillë. Nga takimi me titullarët por edhe me stafin e angazhuar në Msc Marketing Digjital, dëshmohet qëllimi i hapjes së tij, për të rekrutuar ata studentë që kanë interes në shkencat sociale por duan të përfshijnë një qasje teknologjike. Interesi i treguar në numrin e studentëve e konfirmon atë. Megjithatë duke pasur parasysh numrin në rënie të studentëve GVJ rekomandon një qasje me proaktive në drejtim të studentëve të huaj që mund të aksesojnë këtë program studimi. Një qasje ndaj ndërkombëtarizimit të programit të studimit mund të kontribuojnë në qëndrueshmërinë e programit të studimit në afatin e mesëm. <i>Evidencë 70. Vendim BA nr. 1 - Struktura e Pagave 29.05.2020</i> <i>Evidencë 55. Plani i financimit të Fakultetit të Ekonomisë dhe departamenteve 2019-2025.pdf</i>		
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që IAL garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. Po kështu në planin e financimit të FE detajohen detajohen burimet e financimit të programit të studimit, shpenzimet për kërkimin shkencor si dhe për konferencat. GVJ vëren gjithashtu që ka një shpërndarje të drejtë midis të ardhurave që siguron Departamenti i Administrimit Biznesi dhe Teknologji Informacioni me shpenzimet që parashikohen për të.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e hartuara që mbulojnë ciklin e dytë të studimeve universitare reflektohen në Rregulloren Institucionale të KU IKT; Rregulloren e Brendshme të FE ; Rregulloren e Departamentit dhe Rregulloren e programit të studimit. Theksojmë që të gjitha dokumentet e mësipërme janë hartuar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe aktet e tjera rregullatore në zbatim të tyre. Nëpërmjet tyre zbatohen politikat dhe procedurat që përfshijnë gjithë aktivitetin akademik të studentëve gjatë të gjithë ciklit të studimeve të studentëve. Në to janë të parashikuara procedurat e propozimit dhe miratimit të kuotave, të kriterëve të pranimit, procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve, rregullat e vlerësimit të njohurive të studentëve, rregullat e kalimit nga një vit në tjetrin, të transferimit të studentëve, të ndjekjes së programeve të ciklit të dytë.</p> <p><i>Ev.1 Statuti i KU IKT 2016 shqip</i> <i>Ev.1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar shqip</i> <i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT shqip</i> <i>Ev.13. Rregullore e programit MSc Marketing Digjital</i> <i>Ev.12. Rregullore e Departamentit Admin Biznesi dhe Tek Informacioni</i> <i>Ev.15. Rregullore e Sekretarise cikli i dyte 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe</p>	<p>Politikat dhe procedurat në lidhje me pranimin, përparimin e studentëve, frekuentimin dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese janë të rregulluara nëpërmjet Rregullores Institucionale të KU IKT; Rregullores se Brendshme të FE ; Rregulloren e Departamentit dhe Rregulloren e programit të</p>




<p>studentët e programit të studimit.</p>	<p>studimit. Pranimi i kandidatëve të rinj bëhet konform udhëzimeve të MAS, kuotave të propozuara nga njësia bazë (departamenti) dhe kritereve të përcaktuara nga njësia kryesore (fakulteti) e të miratuara në Senatin Akademik, ndërsa barazia dhe të drejtat e njëjta për studentët e programit të studimit garantohen nga rregulloret përkatëse. Bazuar në Kodin e Etikës KU IKT ndjek një proces transparent dhe jo diskriminues, duke mundësuar një konkurrencë të drejtë bazuar në vlerat individuale të gjithsecilit student.</p> <p><i>Ev.1 Statuti i KU IKT 2016 shqip</i> <i>Ev.1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar shqip</i> <i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT shqip</i> <i>Ev.10. Libri i Rregulloreve Institucionale</i> <i>Ev.13. Rregullore e programit MSc Marketing Digjital</i> <i>Ev.12. Rregullore e Departamentit Admin Biznesi dhe Tek Informacioni</i> <i>Ev.15. Rregullore e Sekretarise cikli i dyte 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Kriteret për përzgjedhjen e studentëve të ciklit të dytë hartohen nga departamentet, miratohen në dekanat dhe më pas në Senatin Akademik të KU IKT. Pranimi i kandidatëve bëhet me konkurrim të dosjeve ku rëndësi ka nota mesatare. Përzgjedhja e kandidatëve bazohet në parimet e barazisë, të drejtësisë, të paanësisë dhe të meritës. Përpara çdo viti akademik institucioni harton dhe publikon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve në përputhje me legjislacionin përkatës. Kriteret e pranimit shpallen në websitin e KU IKT. Përzgjedhja e kandidatëve për këtë program studimi bëhet përmes aplikimit nga ana e kandidatëve të interesuar, sipas kritereve të vendosura dhe brenda afatit të përcaktuar.</p> <p><i>Ev.1 Statuti i KU IKT 2016 shqip</i> <i>Ev.1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar shqip</i> <i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT shqip</i> <i>Ev.10. Libri i Rregulloreve Institucionale</i> <i>Ev.12. Rregullore e Departamentit Admin Biznesi dhe Tek Informacioni</i></p>

	<p><i>Ev.13. Rregullore e programit MSc Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev.15. Rregullore e Sekretarise cikli i dyte 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Për çdo vit akademik, kriteret e pranimit për programin Master Shkencor në Marketing Digjital propozohen në departamentin e Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni dhe miratohen në dekanatin e Fakultetit të Ekonomisë dhe në senatin akademik. Njohja e plotë dhe e pjeshme e krediteve të studentëve që vijnë me transferim nga programe të tjera studimi brenda ose dhe jashtë KU IKT u mundësohet studentëve sipas Rregullores së KU IKT. Për rastin e programit Master i Shkencave në Marketing Digjital ngrihet në fillim të çdo viti akademik një komision <i>ad-hoc</i> për ekuivalentimin dhe njohjen e lëndëve/krediteve në krye të së cilit qëndron Koordinatori i Programit. Ky komision shqyrton dokumentacionin e studentit dhe kryen ekuivalentimet përkatëse.</p> <p>Të gjitha strukturat e KU IKT kanë lidhje direkt me informimin dhe pranimin e studentëve të rinj, si zyra e pranimeve, sekretaria mësimore, zyra e karrierës dhe studentit kanë të publikuara oraret e pritjes së studentëve me qëllim plotësimin e nevojave të tyre. Të gjitha kriteret dhe procedurat e pranimit e transferimit janë lehtësisht të aksesueshme dhe të kuptueshme nga studentët në faqen web të KU IKT. https://cit.edu.al/admissions-3/</p> <p><i>Ev.1 Statuti i KU IKT 2016 shqip</i></p> <p><i>Ev.1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar shqip</i></p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT shqip</i></p> <p><i>Ev.10. Libri i Rregulloreve Institucionale</i></p> <p><i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise</i></p> <p><i>Ev.12. Rregullore e Departamentit Admin Biznesi dhe Tek Informacioni</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore e programit MSc Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev.15. Rregullore e Sekretarise cikli i dyte 2022-2023</i></p> <p><i>Ev 91. Fletepalosje informuese</i></p> <p><i>Ev.95. Guida e Studentit</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik KU IKT realizon një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi, për të gjithë të interesuarit që duan të vazhdojnë studimet e tyre ne “Master i</p>

<p>publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Shkencave në Marketing Digjital”, duke shpërndarë njëkohësisht broshura e fletëpalosje informuese. Gjatë takimit në institucion, GVJ u informua se përcjelljen e kërkesave e kriterëve të programit për publikun dhe të interesuarit, KU IKT e realizon edhe nëpërmjet aktiviteteve të tjera të realizuara në koordinim edhe me Zyrën e Pranimeve dhe Zyrën e Studentit dhe Karrierës. Disa nga format e promovimit përfshijnë; seminarët, konferencat, ditët e hapura dhe aktivitete të ndryshme sensibilizuese të cilat promovohen edhe në webfaqen e institucionit.</p> <p><i>Ev.57. CIT Prospektus - Programet Master - cikli i dyte 2020-2021</i></p> <p><i>Ev.58. CIT Prospectus 22-23</i></p> <p><i>Ev.91. Fletëpalosje informuese</i></p> <p><i>Ev.95. Guida e Studentit</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Pranimi i kandidatëve të rinj konform udhëzimeve të MAS, kuotave të propozuara nga njësia bazë dhe kriterëve të përcaktuara nga njësia kryesore e të miratuara në Senatit Akademik garanton në hyrje të drejta të barabarta për të gjithë kandidatët për studentë, ndërsa barazia dhe të drejtat e njëjta për studentët e programit të studimit garantohen nga rregulloret përkatëse. Bazuar në Kodin e Etikës, KU IKT angazhohet të krijojë një mjedis të barabartë për kandidatët me aftësi të kufizuara dhe pakica të marginalizuara. Gjithashtu institucioni ka marrë vendim për tarifën e shkollimit të veçanta për kategori të veçanta të studentëve.</p> <p><i>Ev.10. Libri i Rregulloreve Institucionale-Kodi i Etikës</i></p> <p><i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore e programit MSc Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev.71. Vendim nr.3 BA për tarifën e studimit 2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Duke iu referuar synimeve të institucionit për ndërkombëtarizim, procedurat dhe kriteret e pranimi lejojnë çdo student të interesuar për t’u bërë pjesë e këtij masteri shkencor. Ky master ofrohet në gjuhën angleze dhe pranon studentë shqiptarë të trojeve nga Kosova, nga Preshevë-</p>

	<p>Bujanovca, nga Republika e Maqedonisë Veriore, nga Mali i Zi si dhe shteteve të huaja në përputhje me procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Programit të Studimit. Pranimi i studentëve në programin “Master i Shkencave në Marketing” është rregulluar nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave, me anë të të cilit vendoset nota mesatare në hyrje për çdo vit akademik. Pranimi i kandidatëve bëhet me konkurrim të dosjeve ku rëndësi ka nota mesatare. Përzgjedhja e kandidatëve bazohet në parimet e barazisë, të drejtësisë, të paanësisë dhe të meritës.</p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT shqip</i> <i>Ev.10. Libri i Rregulloreve Institucionale</i> <i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise</i> <i>Ev.13. Rregullore e programit MSc.Marketing Digjital</i> <i>Ev.15. Rregullore e Sekretarise cikli i dyte 2022-2023</i> <i>Ev 57. CIT Prospektus - Programet Master - cikli i dyte 2020-2021</i> <i>Ev.58. CIT Prospectus 22-23</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>KU IKT u siguron studentëve mbështetje për të rritur pranimet dhe cilësinë në programin e studimit. Në përputhje me evidencën <i>71 Vendim nr.3 I Bordit të Administrimit per tarifat e studimit 2023-2024</i> studentëve me arritje të lartë akademike u akordohen bursa studimi dhe përjashtohen nga tarifa studimit sipas meritës së mesatares.</p> <p>Gjithashtu për kategori të veçanta të studentëve me aftësi ndryshe apo në nevojë aplikohen tarifa të reduktuara.</p> <p><i>Ev.13. Rregullore e programit MSc.Marketing Digjital</i> <i>Ev.15. Rregullore e Sekretarise cikli i dyte 2022-2023</i> <i>Ev 57. CIT Prospektus - Programet Master - cikli i dyte 2020-2021</i> <i>Ev.58. CIT Prospectus 22-23</i> <i>Ev 71. Vendim nr.3 BA per tarifat e studimit 2023-2024</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KU IKT ka hartuar politika dhe procedura të qarta për të trajtuar çështjet si pranimi i studentëve të rinj, transferimi i</i></p>




	<i>studentëve nga një program në tjetrin, njohja e dijeve, vlerësimi i studentëve dhe diplomimi. Pranimi i kandidatëve bëhet konform udhëzimeve të MAS, kuotave të propozuara nga njësia bazë dhe kriterëve të përcaktuara nga njësia kryesore e të miratuara në Senatin Akademik, ndërsa barazia dhe të drejtat e njëjta për studentët e programit të studimit garantoohen nga rregulloret institucionale e të programit të studimit</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin janë të përcaktuara në Rregulloren e KU IKT, Rregulloren e programit të studimit dhe Rregulloren e sekretarisë mësimore. Nëpërmjet zyrës së pranimeve, zyrës së këshillimit të karrierës dhe sekretarisë, institucioni vë në dispozicion dhe ofron informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe shtyrjes së studimeve në një vit tjetër akademik. Ndihmë në procesin e informimit të studentëve të ciklit të dytë japin dhe pedagogët e departamentit të Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni të cilët asistojnë dhe orientojnë studentët gjatë periudhës së studimeve në Master i shkencave në Marketing.</p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT</i> <i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Ev.13. Rregullore e programit MSc. Marketing Digjital</i> <i>Ev.15. Rregullore e Sekretarisë cikli i dyte 2022-2023</i> <i>Ev 57. CIT Prospektus - Programet Master - cikli i dyte 2020-2021</i></p>

	<p><i>Ev.58. CIT Prospectus 22-23</i></p> <p><i>Ev.95. Guida e Studentit</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme jepen në mënyrë të hollësishme në Rregulloren Institucionale. Departamenti i Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni në bashkëpunim edhe me koordinatorin e programit informon studentët mbi programin e studimit “Master i Shkencave në Marketing Digjital”, përmbajtjen dhe organizimin e tij, kohëzgjatjen e studimeve në këtë program dhe afatin e përfundimit, kalendarin akademik, fillimin dhe mbarimin e vitit akademik, njohjen e kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme që ata mund të kenë kryer, sezonet e provimeve etj Drejtuesi i Departamentit bashkë me stafin akademik të programit “Master i Shkencave në Marketing Digjital” bëjnë pritjen e studentëve dhe prezantimin e programit mësimor në javën orientuese. Gjatë javës së orientimit në hollin e institucionit vendosen vende pritje realizohen takime për shpjegimin e sistemit të studimeve, rregulloreve dhe procedurave administrative të KU IKT. https://cit.edu.al/cit-orientation-week-2023/</p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT</i></p> <p><i>Ev.11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise</i></p> <p><i>Ev.13. Rregullore e programit MSc. Marketing Digjital</i></p> <p><i>Ev.15. Rregullore e Sekretarise cikli i dyte 2022-2023</i></p> <p><i>Ev 57. CIT Prospektus - Programet Master - cikli i dyte 2020-2021</i></p> <p><i>Ev.58. CIT Prospectus 22-23</i></p> <p><i>Ev.76. Katalogu i veprimtarive 2022 – 2023</i></p> <p><i>Ev 91. Fletpalosje informuese</i></p> <p><i>Ev.95. Guida e Studentit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve janë të unifikuara në nivel Institucioni dhe paraqiten në Rregulloren e KU IKT. Studentët e Programit të studimit “Master i Shkencave në Marketing Digjital” marrin informacione të vazhdueshme nga pedagogët e lëndës, përmes syllabuseve të lëndëve mbi vlerësimet e zhvilluara gjatë</p>


	<p>semestrit, si: vlerësimi i provimit të ndërmjetëm, vlerësimi i aktivizimit në seminare, detyrat e kursit dhe vlerësimi përfundimtar.</p> <p>Njohuritë e përfituara nga studenti kontrollohen dhe vlerësohen me pikë përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimit në auditor, provimeve me shkrim, detyrave të kursit, që zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti i Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni dhe janë të detyrueshme për zbatim si nga pedagogët ashtu dhe nga studentët.</p> <p><i>Ev.13. Rregullore e programit MSc.Marketing Digjital</i> <i>Ev.15. Rregullore e Sekretarise cikli i dyte 2022-2023</i> <i>Ev 21. Programet e lendeve 2022 - 2023</i> <i>Ev 57. CIT Prospektus - Programet Master - cikli i dyte 2020-2021</i> <i>Ev.95. Guida e Studentit</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>KU IKT siguron dokumenta për studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programet e studimit. Departamenti i Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni përmes Koordinatorit të Programit dhe stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi informon studentët e ciklit të dytë “Master i Shkencave në Marketing Digjital” në lidhje procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit. Gjatë periudhës së përgatitjes së punimit të diplomës zhvillohen seancat përgatitore ku pedagogu udhëheq studentët për punimin e diplomës dhe përmbushjen e detyrimeve lidhur me diplomimin. Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik. Monitorimin e procedurave lidhur me mbrojtjen e diplomës e realizon koordinatori i Programit të Studimit në bashkëpunim me stafin akademik. Informacioni në lidhje me kriteret dhe procedurat e diplomimit jepet në takime me drejtuesin e njësisë bazë, pedagogët udhëheqës, dhe nga sekretaria mësimore e KU IKT.</p> <p><i>Ev.13. Rregullore e programit MSc.Marketing Digjital</i></p>

	<p><i>Ev.15. Rregullore e Sekretarise cikli i dyte 2022-2023</i></p> <p><i>Ev 21. Programet e lendeve 2022 - 2023</i></p> <p><i>Ev 57. CIT Prospektus - Programet Master - cikli i dyte 2020-2021</i></p> <p><i>Ev.95. Guida e Studentit</i></p> <p><i>Ev.79. Model i percaktimit te temes se diplomes.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Çdo fillim viti akademik KU IKT organizon takim informues me studentët, ku u jepen informacionet e nevojshme lidhur me organizimin dhe funksionimin e programeve të studimit. https://cit.edu.al/cit-orientation-week-2023/</p> <p>Në këtë drejtim Zyra e Pranimeve dhe Qendra e Karrierës dhe Studentit organizon takime informuese për studentët dhe aktivitete si Open Day Ditët e hapura për publikun. Departamenti i Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni informon studentët e Programit “Master i Shkencave në Marketing Digjital” më gjerësisht lidhur me programin që do të ndjekin, strukturën dhe përmbajtjen e tij, mundësitë që ofron ky program studimi, rregullat për frekuentimin dhe vlerësimin, praktikën mësimore, dhe diplomimin përmes koordinatorit të programit dhe pedagogëve të lëndës.</p> <p><i>Ev 57. CIT Prospektus - Programet Master - cikli i dyte 2020-2021</i></p> <p><i>Ev.95. Guida e Studentit</i></p> <p><i>Ev.76. Katalogu i veprimtarive 2022 – 2023</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KU IKT është i angazhuar në rritjen e transparencës dhe informimit të studentëve në lidhje me progresin e tyre akademik dhe procedurat për diplomim. Institucioni përmes organeve dhe rregulloreve përkatëse u mundëson informacion të plotë studentëve për planifikimin dhe ndjekjen e studimeve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit GVJ u informua se KU IKT ndjek një politikë të informimit të vazhdueshëm të studentëve nëpërmjet të gjitha formave të mundshme si njoftimet e ndryshme në faqen zyrtare web, njoftimet në ambientet e fakultetit, komunikimin direkt me strukturat përkatëse dhe pedagogët. Universiteti ka struktura të veçanta për pritjen, informimin dhe pranimin e studentëve si Zyrës së Pranimeve, Sekretarisë mësimore dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Studentit. Gjatë gjithë viteve të studimit , studentët janë në kontakt me këto struktura.</p> <p>Studentët informohen që në momentin e regjistrimit mbi organizimin, kohëzgjatjen dhe statusin e programit të studimit. Po kështu ata marrin informacion në javën e parë të fillimit të vitit të parë, ‘Java informuese” e organizuar nga Zyra e Pranimeve mbi programin e studimit.</p> <p>Gjithashtu koordinatori i programit të studimit është në kontakt dhe komunikim të vazhdueshëm me studentët për mënyrën e organizimit të procesit mësimor, rregullat e ndryshme dhe çdo informacion që kërkohet nga studentët mbi strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Departamenti i Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni është i angazhuar në çdo fillim semestri me anë të pedagogëve të departamentit dhe koordinatorit të programit, të sigurojë informacion në lidhje me lëndët/modulet, kreditet, syllabusin përkatës, ngarkesën mësimore, frekuentimin dhe orët në auditor, vlerësimin, etj.</p> <p><i>Ev.13. Rregullore e programit MSc.Marketing Digital</i> <i>Ev.15. Rregullore e Sekretarise cikli i dyte 2022-2023</i> <i>Ev 21. Programet e lendeve 2022 - 2023</i> <i>Ev 57. ÇIT Prospektus - Programet Master - cikli i dyte 2020-2021</i> <i>Ev 91. Fletepalosje informuese</i> <i>Ev.95. Guida e Studentit</i></p>

	<i>Ev.76. Katalogu i veprimtarive 2022 – 2023</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Me fillimin e semestrit, secili pedagog i programit Master i Shkencave në Marketing Digjital bën publik informacionin mbi modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, të pasqyruara në syllabusin e lëndës tek studentët. Gjithashtu në faqen web https://cit.edu.al/ studentëve u jepet informacion i nevojshëm për programin e studimit, qoftë nëpërmejt guidës për studentët e ciklit të dytë, planit mësimor, rregullores së programit të studimit. Për çdo informacion studentët mund të kontaktojnë direkt ose përmes emailit me Zyrën e Pranimeve, Sekretarinë mësimore, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Studentit si dhe pedagogët e lëndëve.</p> <p><i>Ev 21. Programet e lendeve 2022 - 2023</i></p> <p><i>Ev 57. CIT Prospektus - Programet Master - cikli i dyte 2020-2021</i></p> <p><i>Ev.75. Katalogu i Veprimtarive 2020-2022</i></p> <p><i>Ev.76. Katalogu i veprimtarive 2022 – 2023</i></p> <p><i>Ev 91. Fletepalosje informuese</i></p> <p><i>Ev.95. Guida e Studentit</i></p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>KU IKT ka ngritur Zyrë të Këshillimit të Karrierës dhe studentit me mision të orientojë, inkurajojë dhe mbështesë studentët dhe të diplomuarit me mundësi për zhvillim personal dhe profesional përmes informimit, këshillimit, trajnimit dhe udhëzimit në karrierë. Bashkëpunimet me industrinë, biznesin, dhe institucionet mbështeten në marrëveshje të institucionalizuara dhe bëhen publike në faqen e web përmes njoftimeve për punësime, internship-e, trajnime për studentët. KU IKT i ka dhënë prioritet organizimit të aktiviteteve të tilla si panaire të punës dhe leksione të hapura me aktorë nga industria si veprimtari që synojnë të orientojnë studentët rreth mundësive për praktikave profesionale në bashkëpunim me institucione partnere.</p> <p><i>Ev.28. Marrëveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione te tjera 2016 – 2022</i></p>

	<p><i>Ev 57. CIT Prospektus - Programet Master - cikli i dyte 2020-2021</i></p> <p><i>Ev.75. Katalogu i Veprimtarive 2020-2022</i></p> <p><i>Ev.76. Katalogu i veprimtarive 2022 – 2023</i></p> <p><i>Ev 91. Fletepalosje informuese</i></p> <p><i>Ev.95. Guida e Studentit</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Përmes sistemit UMS, emailit zyrtar dhe faqes web në hapësirën e dedikuar programit të studimit https://cit.edu.al/masters-of-science-in-digital-marketing/ jepet informacion për orarin e mësimor, orarin e provimeve, strukturën mësimore, bibliotekën, rregulloret dhe procedurat e ndryshme të institucionit. Studentët kanë mundësi të marrin informacion dhe nga Qendra e Karrierës dhe Studentit, sekretaria mesimore dhe departamenti. Departamenti i Administrimit Biznesi dhe Teknologji Informacioni gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në orientimin dhe këshillimin e studentëve të Programit të studimit Master i Shkencave në Marketing Digjital. Përmes koordinatorit të programit të studimit në fillim të çdo viti zhvillohen takime informuese mbi programin “Master i Shkencave në Marketing Digjital” dhe informohen studentët mbi ecurinë, infrastrukturën dhe shërbimet e tij.</p> <p><i>Ev 21. Programet e lëndëve 2022 – 2023</i></p> <p><i>Ev 57. CIT Prospektus - Programet Master - cikli i dyte 2020-2021</i></p> <p><i>Ev.94. Foto evidenca te sistemit UMS</i></p> <p><i>Ev 91. Fletepalosje informuese</i></p> <p><i>Ev.95. Guida e Studentit</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Informacioni për studentët e programit të studimit “Master i Shkencave në Marketing Digjital” mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit “UMS” i cili përdoret për çështjet akademike të studentëve. Kjo platformë është lehtësisht e aksesueshme prej tyre edhe në distancë nëpërmjet aksesit të krijuar nga përdorimi i “user name” dhe “password”, me të cilin studentët janë pajisur në momentin e regjistrimit në programin e studimit.</p> <p><i>Ev.94. Foto evidenca te sistemit UMS</i></p>

	<i>Ev.83. Raport i gjeneruar prej sistemit UMS per programet e studimit, nr. e studenteve, kalueshmerine, ngeljen</i> <i>Aneksi Nr 2 RVB -Tab 14.</i>			
Konkluzione	<i>KU IKT ndjek një politikë të informimit të vazhdueshëm të studentëve nëpërmjet të gjitha formave të mundshme si njoftimet e ndryshme në faqen zyrtare web, njoftimet në ambientet e fakultetit, komunikimin direkt me strukturat përkatëse dhe pedagogët. Universiteti ka struktura të veçanta për pritjen, informimin dhe pranimin e studentëve si Zyrës së Pranimeve, Sekretarisë mësimore dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Studentit. Gjatë gjithë viteve të studimit, studentët janë në kontakt me këto struktura për sigurimin e informacionit të nevojshëm.</i>			
Sbkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimin të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Informacioni lidhur me statistikat vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për programin e studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Marketing Digjital” menaxhohet nga Sekretaria Mësimore e KU IKT-së. Këto të dhëna ruhen në formë të shkruar (hard copy) dhe në formë elektronike në regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave sipas mënyrës së përcaktuar në udhëzimet përkatëse të MAS. Nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumni në mënyrë periodike mbahen kontakte të vazhdueshme me ish-studentë me qëllim jo vetëm ndarjen e eksperiencave dhe arritjeve profesionale por edhe krijimin e urave efektive lidhëse midis universitetit e tregut të punës. Programi i studimit është i ri dhe ende nuk ka studentë të diplomuar.</p> <p><i>Ev.15. Rregullore e Sekretarise cikli i dyte 2022-2023</i></p>




	<p><i>Ev.30. RaportI Institucional Vjetor i KU IKT per vitin akademik 2021-2022</i></p> <p><i>Ev.31. Raporti CIRD Ekonomi 2021-2022</i></p>												
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga takimi me sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se informacioni lidhur me ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre për programin e studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Marketing Digjital” , bazuar në (Ligjit të Arsimit të lartë nr.80/2015) mbahet nga Sekretaria mësimore. Statistikat për ecurinë e studentëve janë të pasqyruara përgjatë ketyre dy viteve të fundit akademike dhe përfshijnë të dhëna mbi numrin e studentëve sipas viteve të studimit, nota mesatare e hyrjes, studentë të transferuar sipas viteve akademike të programit.</p> <table border="1" data-bbox="600 846 1398 1106"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Numri i studentëve</th> <th>Nota mesatare në hyrje</th> <th>Studentë të transferuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2021-2022</td> <td>11</td> <td>6.1</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>9</td> <td>7.48</td> <td>0</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Ev.15. Rregullore e Sekretarise cikli i dyte 2022-2023</i></p> <p><i>Ev.30. RaportI Institucional Vjetor i KU IKT per vitin akademik 2021-2022</i></p> <p><i>Ev.31. Raporti CIRD Ekonomi 2021-2022</i></p> <p><i>Ev.94. Foto evidenca te sistemit UMS</i></p> <p><i>Ev. 83. Raport i gjeneruar prej sistemit UMS per programet e studimit, nr. e studenteve, kalueshmerine, ngeljen</i></p> <p><i>Aneksi Nr 2 RVB -Tab 14.</i></p>	Viti akademik	Numri i studentëve	Nota mesatare në hyrje	Studentë të transferuar	2021-2022	11	6.1	0	2022-2023	9	7.48	0
Viti akademik	Numri i studentëve	Nota mesatare në hyrje	Studentë të transferuar										
2021-2022	11	6.1	0										
2022-2023	9	7.48	0										
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sekretaria mësimore mban të dhënat për ecurinë akademike të studentëve përmes regjistrave themeltar. Këto të dhëna përputhen me dokumentacionin e disponueshëm (procesverbale provimesh, riprovimesh, etj) dhe janë të sigurtë dhe të verifikueshme nga personat e autorizuar. Sekretaria mësimore menaxhon të dhënat e studentëve për programin e studimit dhe informacioni mbahet në databazën e sekretarisë. Po ashtu, sekretaria përpilon regjistrat, të cilët janë specifik për çdo lëndë, si dokument zyrtar që evidenton dhe vërteton zhvillimin e orës së mësimit nga pedagogu dhe frekuentimin e orës së mësimit</p>												

	<p>nga studenti dhe evidenton kreditet që ai ka siguruar në atë lëndë si dhe zhvillimin e orëve dhe tematikave të parashikuara sipas syllabusit të lëndës. Vlerësimi i studentëve pasqyrohet në proces-verbale të cilat sekretaria mësimore i vë në dispozicion pedagogut të lëndës në sezonin e provimeve, të cilat depozitohen dhe ruhen sërish në sekretari. Të dhënat e studentëve janë të pasqyruara në Regjistrin themeltar, në Regjistrin e rezultatve akademike të studentit. Të dhënat statistikore mbi procesin mësimor të studentëve të përmendura me lart menaxhohen nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit duke ruajtur konfidencialitetin. Studentët lehtësisht mund të njihen me vlerësimet në lëndë përmes aksesit në platformën elektronike “UMS”.</p> <p><i>Ev.15. Rregullore e Sekretarise cikli i dyte 2022-2023</i></p> <p><i>Ev.30. RaportI Institucional Vjetor i KU IKT per vitin akademik 2021-2022</i></p> <p><i>Ev.31. Raporti CIRD Ekonomi 2021-2022</i></p> <p><i>Ev.94. Foto evidenca te sistemit UMS</i></p> <p><i>Ev.83. Raport i gjeneruar prej sistemit UMS per programet e studimit, nr. e studenteve, kalueshmerine, ngeljen</i></p> <p><i>Aneksi Nr 2 RVB -Tab 14.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>KU IKT mbikëqyr dhe dokumenton në mënyrë sistematike të dhëna analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Këto raporte janë pjesë e analizës vjetore që nis nga stafi akademik, departamentet, fakulteti dhe institucioni. Gjurmimi i punësimit të studentëve evidentohet përmes një regjistri përkatës që mbahet dhe përditësohet nga specialisti karrierës dhe alumni.</p> <p><i>Ev.30. RaportI Institucional Vjetor i KU IKT per vitin akademik 2021-2022</i></p> <p><i>Ev.31. Raporti CIRD Ekonomi 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike,</p>	<p><i>Ev.33. Vlerësimi i programit te studimit Msc. ne Digital Marketing nga studentët</i></p>

periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<i>Ev.34. Vlerësimi i stafit akademik prej strukturave përgjegjëse drejtuese.</i>		
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se KU IKT zbaton politika dhe praktika të mbledhjes dhe administrimit të të dhënave për të përmirësuar eksperiencën e studentëve dhe performancën e institucionit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht		Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Përfshirja e studentëve në një sërë strukturash vendimmarrëse si Senati Akademik, Këshilli i Fakultetit, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës, Këshilli i Etikës dhe në Këshillat e studentëve rregullohet nga Statuti i KU IKT dhe Rregullorja Institucionale. <i>Ev.1 Statuti i KU IKT 2016 shqip</i> <i>Ev.1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar</i> <i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale,	Bazuar në statutin, KU IKT mbështet krijimin e Këshillave dhe Qeverisë Studentore dhe financon aktivitetet e organizuara prej tyre. Studentët e programit Master i Shkencave në Marketing Digjital kanë mundësi që nëpërmjet përfaqësuesëve të tyre në organet drejtuese të shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet si për planet mësimore dhe programet e

<p>konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>studimeve, rregulloret e studimeve, apo çështje që lidhen me jetën sociale studentore dhe aktivitetet shkencore.</p> <p>Gjatë takimit me GVJ u pohua se rritja e përfshirjes së studentëve në kërkimin shkencor ka mundur pjesëmarrjen e tyre dhe në konferenca kombëtare e ndërkombëtare. (Ev. Studentët janë përfshirë gjithashtu në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit si dhe të vlerësimit institucional.</p> <p><i>Ev.1 Statuti i KU IKT 2016 shqip</i> <i>Ev.1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar</i> <i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT</i> <i>Ev 67. Evidenca mbi konferencat</i> <i>Ev. 75-76 Katalogu i veprimtarive 2020-2022</i> <i>Ev. 61. Certifikata trajnimesh të studenteve të IKT</i> <i>Ev. 80. Revista Shkencore CIT Review Nentor 2021</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Nga takimi i zhvilluar me NJSBC, GVJ u informua se NJSBC në fund të çdo semestri, organizon dhe ndjek zhvillimin e Anketimit Studentor për cilësinë e mësimdhënies, për çdo program studimi. Përfundimet e marra nga ky anketim janë objekt diskutimi dhe reflektimi në njësinë bazë dhe përfaqësojnë kontributin e studentëve gjatë procesit të rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit për të cilin është kryer anketimi. Të dhënat e këtyre raporteve gjithashtu përbëjnë një bazë për hartimin e raporteve të analizës mësimore në nivel departamenti dhe fakulteti. Gjithashtu, KU IKT i kushton vëmendje propozimve të studentëve në organet drejtuese si Senati Akademik, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës, Këshilli i Etikës. Këto praktika përfshinë studentët si kontribues në përmirësimin e programit të studimit.</p> <p><i>Ev.1 Statuti i KU IKT 2016 shqip</i> <i>Ev.1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar</i> <i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT</i> <i>Ev.14. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook</i></p>

	<p><i>Ev.33. Vlerësimi i programit të studimit Msc. në Digjital Marketing nga studentët</i></p> <p><i>Ev.35. Vlerësim i stafit akademik prej studentëve</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Rregullorja e KU IKT i garanton studentit të drejtën të ankimohet, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime drejtuesin e njësisë bazë, komisionin e provimit dhe vetë studentin. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos që studenti të rivlerësohet ose të rijapë provimin, me të njëjtin komision, të plotësuar edhe me anëtarë të tjerë. Gjithashtu në rregullore i garantohet e drejta e ankimimit studentit nëse nuk bie dakord me vendimmarrjen e komisionit të njohjes dhe ekuivalentimit të krediteve, gjatë procesit të transferimit të studimeve ose ndjekjes së një programi të dytë studimesh. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve gjatë plotësimit të pyetësorëve për lëndët, në fund të semestrit</p> <p><i>Ev.1 Statuti i KU IKT 2016 shqip</i></p> <p><i>Ev.1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar</i></p> <p><i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT</i></p> <p><i>Ev.35. Vlerësim i stafit akademik prej studentëve</i></p> <p><i>Ev.16 Prot, Bachelor and Master studies. Pyetësoret e semestrit të parë, datë 11.03.2022 (rezultatet)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se KU IKT përmes organeve përfaqësuese mbështet studentët të shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet si për planet mësimore dhe programet e studimeve, rregulloret e studimeve, apo çështje që lidhen me jetën sociale studentore dhe aktivitetet shkencore.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	KU IKT ka struktura të veçanta për pritjen, informimin dhe pranimin e studentëve. Zyra e Pranimeve, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Studentit dhe Sekretaria mësimore janë struktura ndihmuese për informimin e studentëve. Disa nga njësitë e informimit për shërbimet ndaj studentëve janë <i>Departamenti</i> , ku studenti merr informacione mbi organizimin e mësimin, aktivitete të ndryshme, diplomimin, procesin mësimor; <i>Sekretaria mësimore</i> ku studenti merr shërbime, informohet mbi ecurinë dhe progresin e tij në këtë program studimi; <i>Zyra e karrierës dhe Studentit</i> ku studentët marrin informacion mbi trajnimet, praktikat dhe ofertat e punësimit. Në Rregulloren Institucionale përcaktohen mënyrat e komunikimit të informacionit tek studentët në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloret e brendshme, vendimet e rëndësishme të marra nga Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Rektorati dhe Dekanati të lidhura me studentët. Gjatë gjithë periudhës së studimeve studentit i jepet mundësia të komunikojë me pedagogun, jo vetëm në auditor por edhe nëpërmjet postës elektronike dhe sistemit të menaxhimit të informacionit të brendshëm UMS. <i>Ev.1 Statuti i KU IKT 2016 shqip</i> <i>Ev.1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar</i> <i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT</i> <i>Ev.15. Rregullore e Sekretarise cikli i dyte 2022-2023</i> <i>Ev.94. Foto evidenca te sistemit UMS</i> <i>Ev.83. Raport i gjeneruar prej sistemit UMS per programet e studimit, nr. e studenteve, kalueshmerine, ngeljen</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e	Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Zyra ALUMN-it shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, me qëllim

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	KU IKT ka struktura të veçanta për pritjen, informimin dhe pranimin e studentëve. Zyra e Pranimeve, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Studentit dhe Sekretaria mësimore janë struktura ndihmuese për informimin e studentëve. Disa nga njësitë e informimit për shërbimet ndaj studentëve janë <i>Departamenti</i> , ku studenti merr informacione mbi organizimin e mësimin, aktivitete të ndryshme, diplomimin, procesin mësimor; <i>Sekretaria mësimore</i> ku studenti merr shërbime, informohet mbi ecurinë dhe progresin e tij në këtë program studimi; <i>Zyra e karrierës dhe Studentit</i> ku studentët marrin informacion mbi trajnimet, praktikat dhe ofertat e punësimit. Në Rregulloren Institucionale përcaktohen mënyrat e komunikimit të informacionit tek studentët në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloret e brendshme, vendimet e rëndësishme të marra nga Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Rektorati dhe Dekanati të lidhura me studentët. Gjatë gjithë periudhës së studimeve studentit i jepet mundësia të komunikojë me pedagogun, jo vetëm në auditor por edhe nëpërmjet postës elektronike dhe sistemit të menaxhimit të informacionit të brendshëm UMS. <i>Ev.1 Statuti i KU IKT 2016 shqip</i> <i>Ev.1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar</i> <i>Ev.9. Rregullore Institucionale e KU IKT</i> <i>Ev.15. Rregullore e Sekretarise cikli i dyte 2022-2023</i> <i>Ev.94. Foto evidenca te sistemit UMS</i> <i>Ev.83. Raport i gjeneruar prej sistemit UMS per programet e studimit, nr. e studenteve, kalueshmerine, ngeljen</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e	Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Zyra ALUMN-it shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, me qëllim

Handwritten mark

Handwritten signature

Handwritten signature

<p>këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>promovimin e studentëve dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit. Qendra e Karrierës është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi dhe asistencë për kryerjen e aplikimeve. Qendra e Karrierës orienton studentët në drejtim të njohjes të tregut të punës dhe procesit të punësimit si përgatitja e CV, shkrimi i letrës së interesit, planifikimi dhe ndjekja e intervistës të punës.</p> <p>Qendra Alumni mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash lidhur me punësimin e tyre, si rezultat i gjurmimit të përditësuar. KU IKT ka mbështetur aktivitete të përbashkëta me industrinë të zhvilluara nga Qendra e Karrierës në bashkëpunim me njësitë bazë.</p> <p><i>Ev.18. Manuali i Keshillimit te Karrierës</i> <i>Ev.20. Gjurmimi i studenteve ALUMNI prej institucionit</i> <i>Ev.36. Pyetesor me ALUMNI-t per programin e studimit dhe tregun e punes</i> <i>Ev 58. CIT Prospectus 22-23</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Qendra e Karrierës është një strukturë e ngritur e cila funksionon në bazë të statutit të KU IKT që ka si objektiv të punës së saj mbështetjen e studentëve përgjatë gjithë rrugëtimit të tyre akademik dhe më tej përgjatë viteve të punësimit.</p> <p>Qendra e Karrierës përmes njoftimeve në web dhe përmes materialeve informuese të afishuara në mjediset e universitetit njofton vazhdimisht studentët për mundësi për aplikime në lidhje me punësimin e tyre. Rrjeti “Alumni” synon mbështetjen e studentëve dhe të diplomuarve në KU IKT për të thelluar njohuritë e tyre profesionale në institucione brenda dhe jashtë vendit; ndihmon në rritjen e tyre në karrierë; përfshirjen në projekte dhe edukim të vazhduar.</p> <p><i>Ev.18. Manuali i Keshillimit te Karrierës</i> <i>Ev.20. Gjurmimi i studenteve ALUMNI prej institucionit</i> <i>Ev.36. Pyetesor me ALUMNI-t per programin e studimit dhe tregun e punes</i> <i>Ev 58. CIT Prospectus 22-23</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ gjatë takimi në institucion konstatoi angazhimin e KU IKT për të përmirësuar përvojën e studentëve dhe për të siguruar se</i></p>

	<i>ata kanë mundësi për të adresuar çdo problem ose ankimim gjatë rrugëtimit të tyre të arsimit. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Zyra ALUMN-it janë aktive dhe shërbejnë si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Në lidhje me kriterin, IAL harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. IAL mbështetet në disa strategji si "Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2017 - 2024, Strategjia e CIT 2020 – 2025, Strategjia e RDC (Kerkimit, Zhvillimit dhe Kretivitetit) 2014-2024. Kështu, KU-IKT e targeton cilësinë në mësimdhënie dhe kërkim duke u zotuar në arritjen e një sërë objektivash që sigurojnë diferencimin e saj në tregun universitar në Shqipëri nëpërmjet monitorimit të objektivave të mëposhtëm: Objektivi 1: Ofrimi i njohurive solide të nevojshme për të ndërtuar një bazë për arsim të integruar Objektivi 2 Ofrimi i njohurive të përditësuara, duke mundësuar edukimin e integruar Objektivi 3. Sigurimi i një shtrirjeje ndërkombëtare për programet akademike.

	<p>Objektivi 4: Rekrutimi i një stafi mësimor të dedikuar me cilësi të lartë</p> <p>Objektivi 5. Përmirësimi i vazhdueshëm i performancës së Institutit si një organizatë mësimdhënieje dhe mësimnxënieje dhe sigurimi i një shkalle të lartë kënaqësie nga studentët dhe stafi mësimdhënës me performancën e Institutit.</p> <p>Objektivi 1: Mbështetja adekuate e zhvillimit të të menduarit kritik dhe sjelljes etike tek nxënësit.</p> <p>Objektivi 2: Të mbështesë në mënyrë adekuate zhvillimin e aftësive analitike dhe të zgjidhjes së problemeve të studentët</p> <p>Objektivi 3: Të mbështesë në mënyrë adekuate zhvillimin e kreativitetit dhe inovacionit të nxënësit</p> <p>Vlen për t'u përmendur që IAL bën një gap analysis në lidhje me objektivat që ka vendosur si dhe arsyet e mos arritjes së tyre si dhe zotohet në strategjinë e saj të zhvillimit në drejtimet e mëposhtme</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Zhvillimi dhe avancimi i njohurive nëpërmjet veprimtarive mësimore dhe akademike të kryera brenda brenda dhe jashtë vendit; ○ Trajnimi i studiuësve të rinj në fushat e vlerësimit teorik të teknologjisë së informacionit dhe ekonomisë. ○ Zgjerimi i kualifikimeve profesionale dhe shkencore të të diplomuarve të saj në fushën e teknologjisë së informacionit dhe ekonomisë. ○ Kryerja e veprimtarive kërkimore-shkencore për zhvillimin e mëtejshëm të aplikacioneve dhe inovacioneve në fushën e teknologjia e informacionit dhe ekonomisë. ○ Krijimi i urave të bashkëpunimit me universitete të tjera të njohura ndërkombëtarisht. ○ Rritja e efikasitetit të qendrës kërkimore dhe ○ Miratimi i një strategjie përmirësimi të vazhdueshëm <p><i>Evidencë 2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2017 - 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017.</i></p>
--	--




	<p><i>Evidencë 3. Strategjia e CIT 2020 - 2025, miratuar me vendimin e Bordit te Administrimit nr.02, date 29.05.2020 (Eng).</i></p> <p><i>Evidencë 4. Strategjia e RDC (Kerkimit, Zhvillimit dhe Kretivitetit) 2014-2024.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 6. Miratimi i planit strategjik per LLL eng..</i></p> <p><i>Evidencë 8. Vleresim i programit te studimit MSc ne Marketing Digjital prej Fakultetit dhe Departamentit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 14. Manuali i Sigurimit te Cilesise - QAU Handbook.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>KU-IKT e ka të sanksionuar në Statut në nenin 35 dhe 36 Njësinë e Sigurimit të Cilësisë si dhe kompetencat e saj. NJSBC është organ kolegjal dhe përbëhet nga pesë anëtarë nga të cilët dy janë përfaqësues të personelit akademik të njëjësive kryesore (një për secilën njësi), 1 punonjës i administratës, 1 përfaqësues i Këshillit Studentor dhe 1(një) ekspert i jashtëm që drejton njësinë. Me propozim të rektorit, anëtarët e njësisë të cilësisë me mandat 4 vjeçar miratohen nga senati akademik. Kryetar i njësisë është një ekspert i jashtëm për procesin akademik propozohet nga Rektori dhe miratohet në senatin akademik.</p> <p>Zyra e Sigurimit të Cilësisë është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e këtij niveli duke përdorur një sërë mekanizmash si: - hartimit të politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të cilat miratohen në Senatin Akademik;-- vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore; -në fund të semestrit, para sezonit të provimeve, organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi; realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë;-- harton dhe i propozon Senatit standardet për sigurimin e cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë;--prezanton raportin vjetor të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së KU-IKT së në Senatin Akademik, i cili miraton raportin vjetor përfundimtar të vlerësimit të brendshëm të cilësisë. Vlerësimet periodike të studentëve për pedagogun, të cilat kryhen nëpërmjet plotësimit të një formulari në formë anonime. Duke ofruar sugjerime, studentët ndihmojnë jo vetëm në vlerësimin e cilësisë së punës së pedagogut, por edhe përfshihen në përmirësimin e programit të studimit.</p>

	<p>Paketa e vlerësimit të cilësisë e përbërë nga 1. Analiza SWOT, 2. Vlerësimi i programit të studimit Msc. në Marketing Digjital nga studentët , 3. Vlerësimi i stafit akademik prej strukturave përgjegjëse drejtuese. 4. Vlerësimi i stafit akademik prej studenteve, 5. Pyetësori me ALUMNI-t për programin e studimit dhe tregun e punës 6. Vetëvlerësimi i stafit akademik 7. Pyetësori mbi kënaqësinë e stafit në punë , shërbejnë për të krijuar një plan konkret monitorimi dhe vlerësimi si dhe një plan vjetor aktiviteteve. GVJ vlerëson që IAL realizon një sërë vlerësimesh për të siguruar cilësinë e programit të studimit duke përfshirë disa aktorë të cilët lidhen direkt ose indirekt me programin e studimit. Psh matja e kënaqësisë në punë është një tregues. GVJ rekomandon paraqitjen e masave ndaj rezultateve të vlerësimit. Si psh çfarë masash merren nëse stafi nuk është i kënaqur në punë, pra çfarë parashikohet në raste të tilla.</p> <p><i>Evidencë 33. Vlerësimi i programit të studimit Msc. në Digjital Marketing nga studentët eng..</i></p> <p><i>Evidencë 34. Vlerësimi i stafit akademik prej strukturave përgjegjëse drejtuese.</i></p> <p><i>Evidencë 35. Vlerësimi i stafit akademik prej studenteve (disa vlerësime) eng..</i></p> <p><i>Evidencë 36. Pyetësori me ALUMNI-t për programin e studimit dhe tregun e punës</i></p> <p><i>Evidencë 37. Shkresa nr 16 Prot, Bachelor and Master studies. Pyetësoret e semestrit të parë, date 11.03.2022</i></p> <p><i>Evidencë 38. Model "Vetëvlerësimi" i stafit akademik eng.</i></p> <p><i>Evidencë 39. Pyetësori mbi kënaqësinë e stafit në punë (Staff Satisfaction Survey)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Mbështetur në Statutin e KU-IKT, në librin e rregulloreve institucionale dhe organet e institucionit si: Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë; Guida e studentit; NJSBC, etj sanksionohet e drejta e studentëve për t'u përfaqësuar dhe patur rol në vendimarrje. Pjesëmarrja e studentëve në komisione, në Senat në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve është mundësi e drejtpërdrejtë për të ndikuar në rishikimin e përmirësimin e programeve, përfshi këtu edhe programin e studimit nën shqyrtim. Pjesë e rëndësishme e pjesëmarrjes së studentëve në vlerësimin e procesit akademik është dhe zhvillimi</p>

	<p>i procesit të vlerësimit të lëndës, që krijon mundësi e analizave të mëtejshme në terma të përmbajtjes së lëndës, por dhe mënyrës së zhvillimit të saj nga pedagogu, si dhe në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës. Ky element u vu re dhe nga takimi me studentët të cilët ishin pjesëmarrës aktivë në vlerësimet që realizonte IAL në nivel njësie bazë por edhe më gjerë.</p> <p><i>Evidencë 11. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë (Neni 37)</i></p> <p><i>Evidencë 95. Guida e Studentit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 33. Vlerësimi i programit të studimit Msc. në Digital Marketing nga studentët</i></p> <p><i>Evidencë 35. Vlerësimi i stafit akademik prej studentëve (disa vlerësime)</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ vlerëson praktikën e publikimit të analizave të realizuara në kuadër të NJSBC-së në faqen e Web-it të CIT. Në ëeb cdo individ ka akses në raportet e mëposhtme :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Manuali i QAU • Raporti i pyetësorëve • Anketa e ish studentëve 2020-2021 • Raporti i pyetësorëve 2020-2021 • Vlerësimi i Anëtarit të Fakultetit • Vlerësimi i Stafit Administrativ • Procesi i punësimit • Mirëseardhja e një të punësuarit të ri • Manuali i QAU • Raporti i pyetësorëve 2021-2022 <p>https://sq.cit.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-cilesise/</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatoi që stafi akademik vlerësohet në disa drejtime, në mësimdhënie, kërkim, kontribut administrativ, kontribut për komunitetin dhe në proceset akredituese të IAL. Në RVB e paraqitur nga IAL dokumentohet dhënia e një sërë vlerësimesh si vlerësimi nga bordi i administrimit, vlerësimi nga rektori, vlerësimi nga senati akademik etj. GVJ e vlerëson si një praktikë pozitive që çon në motivimin e stafit në punë dhe në kënaqësinë në punë duke ndikuar më pas në performancën akademike.</p>

	<i>A THANK YOU TO PROF. LLUKAN PUKA! - Canadian Institute of Technology (cit.edu.al)</i>		
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që IAL ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. Bërja publike për të gjithë palët e interesit për të rritur transparencën përbën një element pozitiv.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Si është evidentuar edhe më lart, në KU-IKT funksionon NJSBC në nivel IAL e cila është përgjegjëse për vlerësimin dhe monitorimin e vazhduar të programit të studimit. Si u përmend më lart, kjo zyrë menaxhon një paketë vlerësimi të shtrirë në disa drejtime që ka në fokus, pedagogët, lëndët, etj. Kjo strukturë bashkë me veprimtarinë e saj është rregulluar nga Statuti i KU-IKT, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë. NJSBC përpilon dhe harton raporte në lidhje me respektimin e standardeve dhe kriterëve të cilësisë.</p> <p><i>Evidencë 14. Manuali i Sigurimit te Cilesise - QAU Handbook.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 33. Vlerësimi i programit te studimit Msc. ne Digjital Marketing nga studentët</i></p> <p><i>Evidencë 35. Vleresim i stafit akademik prej studenteve (disa vleresime)</i></p> <p>https://sq.cit.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-cilesise/</p>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion	Strukturat e sigurimit të cilësisë Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të cilësisë dhe NJSBC funksionojnë në zbatim të ligjit

(Handwritten signatures)

<p>Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>për arsimin e lartë, statutin e KU-IKT dhe rregulloret përkatëse të harmonizuara me Manualin e Cilësisë. Më sipër GVJ ka detajuar dhe paketën e instrumentavë të përdorur nga IAL në funksion të vlerësimit dhe monitorimit të vazhduar të programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 14. Manuali i Sigurimit te Cilesise - QAU Handbook.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 33. Vlerësimi i programit te studimit Msc. ne Digjital Marketing nga studentët eng..</i></p> <p><i>Evidencë 35. Vleresim i stafit akademik prej studenteve (disa vleresime) eng..</i></p> <p><i>Evidencë 36. Pyetesor me ALUMNI-t per programin e studimit dhe tregun e punes eng</i></p> <p><i>Evidencë 37. Shkresa nr 16 Prot, Bachelor and Master studies. Pyetesoret e semestrit te pare, date 11.03.2022 (rezultatet) eng.</i></p> <p><i>Evidencë 38. Model "Vetëvlerësimi" i stafit akademik eng.</i></p> <p><i>Evidencë 39. Pyetesori mbi kenaqesine e stafit ne pune (Staff Satisfaction Survey).pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>IAL dhe programet e studimit që ajo ofron janë subjekt I disa vlerësimeve, vlerësimet nga njësia bazë, vlerësimet e brendshme institucionale në bashkëpunim me NJSBC-në, si dhe vlerësimet e jashtme në kuadër të ASCAL. Po kështu të gjithë llojet e vlerësimeve të përmendur më sipër sigurojnë treguesit e monitorimit të cilësisë.</p> <p><i>Evidencë 14. Manuali i Sigurimit te Cilesise - QAU Handbook</i></p> <p><i>Evidencë 33. Vlerësimi i programit te studimit Msc. ne Digjital Marketing nga studentët</i></p> <p><i>Evidencë 35. Vleresim i stafit akademik prej studenteve</i></p> <p><i>Evidencë 36. Pyetesor me ALUMNI-t per programin e studimit dhe tregun e punes</i></p> <p><i>Evidencë 90. Procesverbale takimesh te NJSBC</i></p> <p><i>RVB Master i Shkencor ne Marketing Digjital</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të</p>	<p>Si është përmendur më sipër, IAL ka hartuar një sërë strategjish me objektiva specifike të cilët synon të arrijë në fushën e</p>




<p>matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>mësimdhënies dhe kërkimit shkencor si dhe bashkëpunimin me komunitetin për ofrimin e zgjidhjeve inovative. Vlen të përmendim strategjitë CIT 2020-2025. Po kështu, IAL bën një analizë të arritjes së këtyre objektivave cdo vit për të parë hendeqet në arritjen e objektivave në formën e një gap analysis me argumentat shoqërues.</p> <p><i>Evidencë 2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2017 - 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017.</i></p> <p><i>Evidencë 3. Strategjia e CIT 2020 - 2025, miratuar me vendimin e Bordit të Administrimit nr.02, date 29.05.2020 (Eng).</i></p> <p><i>Evidencë 4. Strategjia e RDC (Kërkimit, Zhvillimit dhe Kreativitetit) 2014-2024.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Si u përmend edhe më sipër IAL disponon akte normative dhe rregullatore, dhe strategji sektoriale në nivel IAL-je dhe ka të operacionalizuar një paketë instrumentesh e cila shërben si bazë për vlerësimin e dhe monitorimin e vazhdueshëm të programit të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin</p>	<p>GVJ ka përshkruar më lart elementët e paketës së vlerësimit, të cilat janë të dokumentuara dhe i shërbejnë rritjes së cilësisë por edhe akreditimit të programit të studimit. Nëpërmjet pyetësorit të studentit mund të vlerësohet, niveli i njohurive të marra, cilësia e mësimdhënies, gjuhës, materialit, përfshirjes etj. Po kështu nëpërmjet intervistimit të Alumni sigurohet një vlerësim i punësimit të tyre. GVJ rekomandon që krahas vlerësimit të rekomandimit të CIT nga ana ALUMNI do të ishte e nevojshme përfshirja e një pyetje që lidhet direkt me programin e studimit,</p>

<p>e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>psh lëndë apo module të caktuara që ata gjejnë si të nevojshëm për programin e studimit Marketing Digjital.</p> <p><i>Evidencë 33. Vlerësimi i programit te studimit Msc. ne Digjital Marketing nga studentët</i></p> <p><i>Evidencë 35. Vleresim i stafit akademik prej studenteve</i></p> <p><i>Evidencë 36. Pyetesor me ALUMNI-t per programin e studimit dhe tregun e punes</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Në evidencat dhe dokumentat strategjike të cituar më sipër, IAL ka paraqitur në mënyrë specifike objektivat në lidhje me mësimdhënien dhe përmirësimin e saj (si indikator vlerësimi I programit nga brenda dhe jashtë nëpërmjet ASCAL, dhe në RVB gjithashtu citohet vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm si një metodologji e strukturuar për të marrë masa në lidhje me promovimin dhe adresimin e gjetjeve. Gap Analysis te SWOT vë në dukje arritjet por edhe pikat e dobëta dhe mundësitë në lidhje me IAL në përgjithësi. Nga ana tjetër vlerësimi që bën njësia bazë për punën e departamentit është një tjetër formë vlerësimi që vë në dukje arritjet dhe adresimin e mangësive. GVJ vlerëson dokumentimin shterues të aktivitetit kërkimor dhe pedagogjik të stafit të angazhuar në programin e studimit Msc Marketing Digjital.</p> <p><i>Evidencë 7. Studim i tregut per programin Msc. Marketing Digjital;</i></p> <p><i>Evidencë 8. Vleresim i programit te studimit MSc ne Marketing Digjital prej Fakultetit dhe Departamentit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të</p>	<p>Nga shqyrtimi i pyetësorit dedikuar studentëve, njësia bazë mund të mbledhë informacione në disa drejtime nëpërmjet fushave të mëposhtme</p> <ul style="list-style-type: none"> • Planprogrami shpjegon qartë pritshmëritë e kursit për studentët • Libri i kërkuar është i dobishëm • Materiali i kursit përveç tekstit shkollor është i dobishëm • Kursi më ndihmoi të përmirësoja njohuritë e mia për këtë temë




<p>provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e regulluara dhe të tjera.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Sasia e punës së kursit të kërkuar është e krahasueshme me atë të kurseve të tjera të mia • Planprogrami iu dorëzua studentëve në klasën e tij të parë • A ju duket kursi interesant dhe stimulues? • Mësuesi e fillon mësimin në kohë dhe e përfundon në kohë • Instruktori plotëson orët e humbura • Instruktori postoi orarin e tij/saj të zyrës dhe është i disponueshëm: gjatë këtyre orëve • Mësuesi është gjithmonë i përgatitur për klasë • Mësuesi e njeh mirë temën • Gjuha angleze e instruktorit ishte e qartë dhe e kuptueshme • Instruktori respekton planprogramin e kursit • Testet dhe provimet pasqyrojnë materialin e mësuar në klasë • Mësuesi i trajton studentët me respekt • Mësuesi është i pranueshëm për mendimet e studentëve • Mësuesi inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në klasë • Do të doja të merrja një kurs tjetër (nëse ka) me këtë instruktor <p><i>Evidencë 33. Vlerësimi i programit të studimit Msc. në Digjital Marketing nga studentët</i></p> <p><i>Evidencë 35. Vlerësim i stafit akademik prej studenteve</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në</p>	<p>GVJ vlerëson që ky kriter plotësohet, pasi IAL përdor një paketë me instrumenta vlerësimi, elementë që janë sqaruar më sipër, megjithatë GVJ rekomandon që përpos pyetësorëve një tjetër mënyrë për të mbledhur feedback nga studentët janë dhe focus grupet. Ky I fundit ndihmon për të siguruar një informacion më cilësor jo vetëm të studentët por edhe të aktorë të tjerë si psh Alumni. Zyra e Karrierës dhe Alumni e KU-IKT, mban kontakte të vazhdueshme me Alumni duke i angazhuar vazhdimisht në aktivitetet e organizuara nga universiteti, më konkretisht në Panairin e punës. Megjithatë këto panairë mund të përdoren përpos infodays edhe për të kërkuar sugjerime për programin e studimit.</p>

realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	<i>Evidencë 84. Analize e pyetesoreve gjate panairove 2021-2022.</i> <i>Evidencë 85. Analize e pyetesoreve në panairove, shkolla verore dhe aplikimet 2022-2023</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që IAL ka krijuar strukturat dhe ka vendosur objektiva të qartë për të garantuar në cilësinë e programit të studimit dhe rekomandojmë një zgjerim të aktiviteteve për të mbledhur sa më shumë gjetje në raport me studentin dhe përvetësimin e njohurive si dhe përdorimin e këtyre njohurive në tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Sic u theksua më lart, strukturat e ngritura dhe procedurat e zbatuara janë në përputhje me Kodin e Cilësisë në Republikën e Shqipërisë, si edhe me Manualin “ Manualin i Sigurimit të Cilesisë - QAU Handbook.pdf” në përputhje me <i>Statutin i KU-IKT</i> . NJSBC si dhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë mbështeten nga eksperti i jashtëm dhe nga ai ligjor në përmbushjen e detyrave dhe bazohen në respektimin e procedurave të sanksionuara në Manualin e Cilësisë. <i>Evidencë 14. Manuali i Sigurimit të Cilesisë - QAU Handbook</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë,	Komisioni i përhershëm i sigurimit të cilësisë dhe kurrikulave KPSSC dhe NJSBC kanë hartuar një Manual për organizimin dhe punën e Komisionit të Përhershëm për garantimin e standarteve

<p>individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>të cilësisë, si edhe njësimin e sigurimit të cilësisë (<i>videncë 14. Manuali i Sigurimit të Cilesise - QAU Handbook</i>). Ky manual është hartuar duke u bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë Nr. 80/2015, datë 22/07/2015 në nenin 103 dhe 104, kapitulli 7 dhe 8 Libri I Rregulloreve Të Funksionimit Të “Instituti Kanadez I Teknologjisë” (CIT)</p> <p><i>Evidencë 10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>KPSSC dhe NjSBC së bashku me Dekanin e Fakultetit dhe Drejtuesin e Departamentit janë përgjegjës për çeshtjet e cilësisë, duke monitoruar të gjitha proceset aktivitetet dhe veprimtaritë si akademike edhe të shërbimeve, falë mekanizmave të përmendura më lart.</p> <p><i>Evidencë 10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 14. Manuali i Sigurimit të Cilesise - QAU Handbook</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>IAL Përfshin aktorë të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit. Kjo evidentohet nga mekanizmat e përmendur më sipër si dhe vendimet e marra për krijimin e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm. Nga takimi me GVB u evidentua pjesëmarrja e një studenti në grup.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje</p>	<p>Si u analizua dhe më sipër, nga takimi i GVJ me zv dekanen dhe përgjegjësën e departamentit BA&IT u pranua se për të dizenuar programin e studimit MSc në Marketing Digjital, janë përdorur një sërë inputesh, së pari studentët të cilët kanë ndjekur programe studimi të ciklit të parë në CIT ofronin mendimet e para në lidhje me nevojën në vendin e tyre të punës të kompetencave dhe aftësive që lidhen me marketingun digjital. 70% e studentëve në këtë program studimi janë të punësuar kështu që ata përbëjnë partnerin e parë që është përfshirë në ndërtimin e programit të studimit. Së dyti, IAL ka zhvilluar një analizë shteruese të nevojës për programin e studimit në fjalë duke zhvilluar në të</p>




<p>me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>njëjtën kohë edhe një inventar të aktorëve potencialë që mund të kontribuojnë në të ardhmen në përmirësimin e programit të studimit. Së treti, praktikat mësimore shërbejnë si një urëlidhëse me biznesin dhe nevojat e tij. Përveç, studentëve dhe feedback-ut të tyre, studimi i tregut, kontaktet me alumnit, trendet e kohës, nevojat e biznesit, konferenca të organizuara me GIZ dhe Kooperacioni Zviceran kanë qënë inpute të tjera të rëndësishme për të konfiguruar programin e studimit. Gjithashtu orientimi apo qasja ndaj programeve të ngjashme në Evropë, Kanada e më gjerë sa i përket programeve të studimeve të ngjashme si School of Business and Innovation Gjermani, dhe Digital Marketing Communic Scientific Master Program në Kanada at St. Lawrence College.</p> <p><i>Evidencë 5. Studim i tregut dhe plani financiar për programin MSc. Marketing Digjital.</i></p> <p><i>Evidencë 7. Studim i tregut për programin Msc. Marketing Digjital - JANAR 2023.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që për programin e studimit Msc në Marketing Digjital, IAL përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të</p>	<p>Politikat dhe procedurat që lidhen me sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit përfshihen në Manualin e Sigurimit të Cilësisë, Statutin dhe librin e rregulloreve të IAL, përkatësisht në kapitujt 7 dhe 8. Po</p>

<p>Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>kështu, IAL publikon në faqen Web të gjitha raportet që lidhen me cilësinë për të gjithë palët e interesuara (https://sq.cit.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-cilesise/).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Raporti i pyetësorëve 2020-2021 • Vlerësimi i Anëtarit të Fakultetit • Vlerësimi i Stafit Administrativ • Procesi i punësimit • Mirëseardhja e një të punësuarit të ri • Manuali i QAU • Raporti i pyetësorëve 2021-2022 <p><i>Evidencë 10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i> <i>Evidencë 14. Manuali i Sigurimit te Cilesise - QAU Handbook</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>IAL publikon ,rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale, në faqen web mund të konsultohen raporte në mënyrë të përmbledhur për të mos cënuar etikën akademike.</p> <p>https://sq.cit.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-cilesise/.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Vlerësimet e kryera dhe rezultatet përkatëse për programin pasqyrohen në Raportin Vjetor të Departamentit BA&IT dhe shoqërohen me një plan veprimi. Duke u nisur nga ky plan veprimi dhe bazuar në një kalendar të brendshëm, Rektorati i kërkon Përgjegjësve të Departamenteve dhe Dekanëve që të hartojnë projekt-buxhetet e tyre me zërat përkatës duke përfshirë nevojat akademike dhe aktivitetet e departamentëve që synojnë rritjen dhe përmirësimin e cilësisë akademike.</p> <p><i>Evidencë 8. Vleresim i programit te studimit MSc ne Marketing Digjital prej Fakultetit dhe Departamentit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në</p>	<p>Nga takimi me stafin e angazhuar në zyrën e cilësisë u përmend krijimi i NJSBC-së në nivel fakulteti kur numri I studentëve të arrijë 1000. Tashmë është përmendur shpesh herë se IAL disponon një paketë me disa instrumenta dhe vlerëson vazhdimisht efektivitetin e tyre. Raportimi dhe përmirësimi I tyre në vazhdimësi është një sfidë për të gjithë IAL në Shqipëri dhe pse KU-IKT tregon që ka krijuar një institucionalizim të</p>

vijim të cilësisë së programit të studimit.	praktikave dhe procedurave në funksion të përmirësimit të cilësisë.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Duke iu referuar RVB/CIT por edhe nga sa u tha më sipër evidentohet që personeli akademik i KU-IKT është vazhdimisht i informuar mbi rezultatet e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë. Analizat e punës mësimore shkencore të zhvilluara periodikisht, analizat e pyetësorëve të pedagogëve dhe të programit u bëhen me dije përmes mbledhjeve përkatëse në nivel departamenti dhe fakulteti. Studentët janë gjithashtu pjesë e këtij procesi përmes përfaqësuesve të tyre në organet e KU-së, por edhe përmes diskutimeve e takimeve me ta nga zyra e këshillimit dhe strukturave të tjera në IAL.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që IAL po bën përpjekje të vazhdueshme për të bërë publike politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duke siguruar informacion transparente për të gjitha palët e interesuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Msc në "Marketing Digjital" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"

Pikat e forta dhe afirmime

1. Përvoja shumë vjeçare në tregun e arsimit të lartë të KU IKT lidhur me teknologjitë e informacionit mbështet konsolidimin e programit të studimit "Master në Marketing digjital" në përputhje të plotë me misionin dhe objektivat e përcaktuara në strategjinë e zhvillimit të programit.
2. Programi Master i Shkencave në Marketing Digjital është në përputhje me nevojat e tregut dhe me aktet ligjore në fuqi si dhe direktivat e BE për arsimin e lartë;
3. Ndërkombëtarizimi i vazhdueshëm i stafit të angazhuar në programin e studimit dhe pjesëmarrja në projekte/mobilitete trajnimi, i mundëson personelit akademik dhe studentëve të përfitojnë nga shkëmbimi dhe bashkëveprimi me kërkues shkencor nga BE-ja, përfshirë këtu pjesëmarrjen në trajnime dhe konferenca tematike.
4. Staf proaktiv dhe i angazhuar në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.
5. Godina, biblioteka, ambjentet mësimore janë të një standarti të lartë duke krijuar në këtë mënyrë një mjedis që mbështet arritjen e objektivave të programit të studimit.
6. Angazhimi i stafit PAE dhe PAK në mënyrë të vazhduar në organizimet shkencore të KU-IKT.
7. Studentët kanë mbështetjen, këshillimin dhe bashkëpunimin individual sipas nevojave të tyre nga departamenti dhe zyrat e shërbimit të KU IKT.
8. Edukim ndërdisiplinor dhe i integruar me module ndërdisiplinore në programin e studimit.
9. Marrëveshje bashkëpunimit me institucione private e publike që garantojnë dhe forcojnë marrëdhënien me tregun e punës.
10. Mundësi zhvillim kërkimi në funksion të programit të studimit përmes CIT HUB e cila shërben si një qendër inovacioni për promovimin e kreativitetit dhe sipërmarrjes.

Pika të dobëta

1. Mungesa e analizave për përfitimet konkrete të marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit mësimor (Standardi I.3, kriteri 4)
2. Mungesa e një analizë të mirëfilltë tregu për të evidentuar kompetenca në ndryshim e sipër për shkak të ndryshimeve dinamike teknologjike (Standardi II.4, kriteri 5)
3. Mungon përditësimi i syllabuseve, literaturës, lëndëve me nevojat e kohës dhe formave të kontrollit të studentëve (Standardi II.3, kriteri 4 & Standardi II.4, kriteri 5)



Rekomandime

- GVJ rekomandon që lëndë si Advanced Research Methods and communication skills bashkë me lëndën Economic and Legal Environment do të ishin më të përshtatshme të klasifikoheshin si lëndë të formimit bazë për këtë program studimi duke pasur parasysh që dy lëndët e përmendura më sipër përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme. Ndërsa lënda Financial Reporting Standarts mund të kalojë në kategorinë C, si lëndë ndërdisiplinore.
- Formatimin e syllabuseve të lëndëve sipas VKM nr 41
- Analizë e vazhdueshme e tregut me të dhëna primare nga biznesi për kompetenca të nevojitura duke pasur parasysh zhvillimin teknologjik sidomos në drejtim të AI.
- Zhvillimi i analizave periodike për përfitimet konkrete të marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit mësimor.



Evaluation's conclusions for the first cycle study program Ms in "Digital Marketing" provided by the Higher Education Institution "Canadian Institute of Technology"

Strengths and affirmations

1. Many years of extensive experience in the CIT higher education market related to information technologies support the consolidation of the "Master in Digital Marketing" study program in full alignment with the mission and objectives defined in the program's development strategy.
2. The Master of Science in Digital Marketing program aligns with market needs and current legislation, as well as European Union directives for higher education.
3. Continuous internationalization of the staff engaged in the study program and participation in training projects/mobilities enable academic personnel and students to benefit from exchanges and interactions with scientific researchers from the EU, including participation in thematic training and conferences.
4. Proactive and dedicated staff in national and international projects.
5. The buildings, library, and teaching spaces are of a high standard, thus creating an environment that supports the achievement of the study program's objectives.
6. Continuous engagement of non-academic and administrative staff in CIT scientific organizations.
7. Students receive individual support, guidance, and collaboration tailored to their needs from the department and CIT support offices.
8. Interdisciplinary and integrated education with interdisciplinary modules in the study program.
9. Collaboration agreements with private and public institutions that guarantee and strengthen connections with the job market.
10. Research and development opportunities within the framework of the study program through CIT HUB, which serves as an innovation center for promoting creativity and entrepreneurship.

Weaknesses

1. Lack of analysis for the concrete benefits of cooperation agreements in support of the implementation of the study program (Standard I.3, criterion 4).
2. Lack of a thorough market analysis to identify changing competencies due to dynamic technological changes (Standard II.3, criterion 5).
3. The syllabus, literature, and materials are not updated to meet current needs, and student assessment methods are lacking (Standard II.3, criterion 4 & Standard II.4, criterion 5).



Recommendation

1. GVJ recommends that subjects such as Advanced Research Methods and Communication Skills, along with the subject Economic and Legal Environment, would be more suitable to be classified as fundamental subjects for this study program, considering that the two subjects define the general education. Meanwhile, the subject Financial Reporting Standards may fall into category C as an interdisciplinary subject.
2. The formation of subject syllabi according to VKM (Council of Ministers' Decision) No. 41.
3. Continuous market analysis with primary data from businesses indicating the necessary competencies to be developed by the program, taking into account technological developments, especially in the field of AI.
4. Development of periodic analyses for the concrete benefits of cooperation agreements in support of the study program.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X